



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

RAPORTI VJETOR PËR ZBATIMIN E
STRATEGJISË PËR SUNDIMIN E LIGJIT

Prill 2024

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026 është dokumenti kryesor planifikues strategjik në sektorin e sundimit të ligjit me katër objektiva strategjike të përcaktuara dhe pesëmbëdhjetë objektiva tjera specifike. Strategjia ka Planin e Veprimit 2021-2023 që përmban gjithsej 464 aktivitete për periudhën 2021-2023. Ky Raport vjetor i zbatimit të Planit të Veprimit përfshin monitorimin e zbatimit të tërë aktivitetet të planifikuara për vitin 2023. Gjatë periudhës raportuese 2023, janë identifikuar 358 aktivitete, ndërsa 106 janë evidentuar si të përfunduara me sukses deri në fund të periudhës raportuese 2022. Në progresin për masat e politikave është reflektuar edhe progresi i evidentuar në raportin parapak të vitit 2022.

Nga Raporti monitorues, pa përfshirë aktivitetet e përfunduara në periudhën 2022, rezulton se 41.23% nga aktivitetet e periudhës 2023 janë zbatuar plotësisht, 34.36% janë zbatuar pjesërisht apo janë në zbatim e sipër si dhe 24.30% të aktiviteteve nuk janë zbatuar fare dhe nuk ka zhvillime lidhur me to. Ndërsa, në tërësi, duke llogaritur edhe aktivitetet e realizuara gjatë periudhës raportuese 2022, rezulton se 55% janë përbushur plotësisht, 26% janë zbatuar pjesërisht, dhe 19% nuk janë zbatuar fare. Aktivitete më së shumti të realizuara ka në Objektivën 4 ‘fuqizimi i luftës anti-korrupsion’ në raport me numrin e aktiviteteve të planifikuara, ndërsa numri më i madh i aktiviteteve të pa zbatuara në raport me aktivitetet e planifikuara është në Objektivën 2 ‘Fuqizimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë’.

Aktivitetet e realizuara përfshijnë 1) miratim të politikave ligjeve dhe akteve nënligjore të reja, 2) avancim të sistemit të raportimit të brendshëm në kuadër të gjyqësorit dhe prokurorisë, 3) ndërmarrja e një numri të madh të trajnimeve të specializuara veçanërisht nga Akademia e Drejtësisë por edhe odat e profesioneve të lira, 4) ngritje të transparencës duke ofruar qasje dhe publikuar një numër të konsiderueshëm të dokumenteve të brendshme, 5) avancimin e sistemit të dixhitalizimit dhe 6) ndërmarrja e aktiviteteve vetëdijësuese për qasjen në drejtësi apo edhe përdorimin e mekanizmave për zgjidhjen alternative të kontesteve. Pavarësisht zbatimit të aktiviteteve në vitin 2023, nevojitet punë e mëtejshme nga Ministria e Drejtësisë, gjyqësori, prokuroria dhe institucionet e tjera për të adresuar sfidat e vazhdueshme që kanë të bëjnë me: zhvillimin dhe harmonizimin e politikave dhe legjislacionit, efikasitetin, dixhitalizimin, vlerësimin e performancës, disiplinën, llogaridhënien, integritetin, zhvillimin profesional, efektivitetin e profesioneve të lira dhe përdorimin e mekanizmave ZAK, si dhe transparencën dhe funksionimin e institucioneve në përgjithësi.

Nga analiza buxhetore vërehet se nga kosto e planifikuar e aktiviteteve të vitit 2023, vetëm 32% e buxhetit është shpenzuar që korrespondon me aktivitetet e zbatuara dhe që nënkupton se aktivitetet më së shumti të kushtueshme ende nuk janë zbatuar. Strategjia ka edhe treguesit e ndikimit dhe treguesit e rezultateve në nivel të objektivave. Sipas vlerës së arritur të këtyre treguesve deri në vitin 2023, trendi duket se është pjesërisht pozitiv, apo vetëm në disa prej treguesve, mund të arrihen caqet e synuara të Strategjisë të vitit 2023 dhe 2026.

Raporti i monitorimit identifikon edhe rreziqet relevante të cilat mund të pengojnë zbatimin e Strategjisë e që janë: mos-prioritizimi i zbatimit të aktiviteteve nga institucionet, mungesa e kapaciteteve, buxhetit apo bashkëpunimit ndër-institucional, si dhe rreziqet që ndërlidhen me rishikimin afatmesëm të planifikuar me kohë të Strategjisë. Po ashtu, një sfidë tjetër lidhur me aktivitetet e përbushura të natyrës periodike, është vazhdueshmëria e përbushjes së tyre edhe pas përfundimit të periudhës raportuese. Si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve, Raporti paraqet edhe hapat specifik për adresimin e tyre. Rishikimi afatmesëm i Strategjisë parashihet të bëhet në vitin 2024, ndërsa këtij rishikimi dhe hartimit të Planit të ri të Veprimit të Strategjisë 2024-2026 i parashihet ti paraprajnë analizat specifike të sektorit, të cilat parashihet të hartohen me mbështetje të partnerëve zhvillimorë të Kosovës.

I. HYRJE

Strategjia për Sundimin e Ligjit (2021-2026) dhe Plani i Veprimit të saj (2021-2023) janë miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në Gusht të vitit 2021. Kjo Strategji është dokumenti kryesor planifikues në fushën e sundimit të ligjit e cili synon arritjen e katër objektivave strategjike: 1) fuqizimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial; 2) fuqizimin e drejtësisë penale; 3) fuqizimin e qasjes në drejtësi; dhe 4) fuqizimin e luftës anti-korrupsion. Këto katër objektiva ndahen tutje në pesëmbëdhjetë objektiva specifike në të cilat bazohet Plani i Veprimit i Strategjisë për Sundimin e Ligjit, i ndarë gjithsej në pesëmbëdhjetë kapituj sipas objektivave specifike.

Pavarësisht miratimit të Strategjisë në Gusht të vitit 2021, zbatimi i Strategjisë dhe monitorimi i saj kanë filluar zyrtarisht vetëm pas zotimit të të gjitha institucioneve të përfshira, në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Strategjisë të mbajtur në Janar të vitit 2023. Deri në Qershor të vitit 2023 nga 374 aktivitetet e planifikuara: 112 janë zbatuar plotësisht, 179 pjesërisht ose janë në zbatim e sipër dhe 73 nuk janë zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim lidhur me to. Gjithashtu, duhet të ceket se 2 aktivitete të Ministrisë së Drejtësisë si dhe 4 aktivitete të Këshillit Prokurorial të Kosovës, nuk kanë mundur të vlerësohen pasi nuk kanë gjetur zbatim gjatë periudhës raportuese.

Gjatë periudhës së dytë të vitit, Korrik – Dhjetor 2023, institucionet kanë vazhduar me zbatimin e aktiviteteve, vlerësimi i të cilëve pasqyrohet në këtë Raport vjetor. Ky Raport pra përfshin monitorimin e zbatimit të Strategjisë deri në fund të vitit 2023 si dhe refleton edhe aktivitetet e zbatuara me sukses deri në fund të periudhës raportuese të vitit 2022.

Monitorimi është bërë në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike¹ dhe Manualin për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit². Gjatë periudhës së monitorimit janë mbajtur takime veçmas në mes të Sekretariatit të Strategjisë dhe të gjitha institucioneve të përfshira në zbatim ku janë diskutuar dhe validuar të gjeturat. Këto të gjetura janë reflektuar në këtë Raport, i cili është diskutuar e votuar tutje në organet monitoruese të Strategjisë – Organin Koordinues Ndër-institucional dhe Komitetin Drejtues.

II. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Në kuadër të katër objektivave të përcaktuara të Strategjisë dhe të përmendura në hyrje të këtij Raporti, janë planifikuar gjithsej 464 aktivitete në Planin e Veprimit të Strategjisë deri në fund të vitit 2023, ku 106 prej tyre janë zbatuar në periudhën raportuese 2022.

Vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve sipas këtij Raporti është ndarë në katër kategori: 1) të zbatuara plotësisht në periudhën raportuese 2023; 2) të zbatuara plotësisht në periudhën raportuese 2022; 3) të zbatuara pjesërisht ose në zbatim e sipër; 3) të pazbatuara. Deri në fund të vitit 2023 nga gjithësej 464 aktivitetet, 151 aktivitete janë zbatuar plotësisht gjatë periudhës raportuese 2023, 106 aktivitete janë zbatuar gjatë periudhës raportuese 2022, 121 aktivitete janë zbatuar pjesërisht ose janë në zbatim e sipër dhe 87 nuk janë zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim lidhur me to.

¹ Udhëzimi Administrativ nr. 07/2018. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18813>

² Manuali i vitit 2019. I qasshëm në: <https://krveministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/MANUAL-PER-PLANIFIKIMIN-HARTIMIN-DHE-MONITORIMIN-E-DOKUMENTEVE-STRATEGJIKE-DHE-PLANEVE-TE-TYRE-TE-VEPRIMIT.pdf>




Figura 1 - Zbatimi i përgjithshëm i aktiviteteve për periudhën 2023




Figura 2 - Zbatimi i aktiviteteve të viteve deri në fund të vitit 2023 sipas objektivave

Në bazë të objektivave, rezulton se, në Objektivin 4 ka më së shumti aktivitete të zbatuara në raport me numrin e aktiviteteve për atë objektive, kurse Objektivi 3 ka numrin më të madh të aktiviteteve të zbatuara

pjesërisht ose në zbatim e sipër, si dhe numrin më të madh sa i përket aktiviteteve të pazbatuara duke konsideruar edhe aktivitetet e përmbushura në vitin 2022.

Tabela në vijim paraqet zbatimin e aktiviteteve me përqindje sipas institucioneve që i kanë udhëhequr ato.

Institucioni	Numri i aktiviteteve	Përqindja e zbatimit të plotë	Përqindja e aktiviteteve në zbatim e sipër	Përqindja e aktiviteteve të pazbatuara
Ministria e Drejtësisë	158	48%	35%	18%
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	93	52%	26%	23%
Këshilli Prokurorial i Kosovës	73	57%	28%	15%
Kuvendi i Kosovës	4	25%	25%	50%
Presidenca	1	100%	0%	0%
Akademia e Drejtësisë	48	65%	23%	13%
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës	32	50%	19%	31%
Shërbimi Korrektues i Kosovës	18	74%	26%	0%
Shërbimi Sprovues i Kosovës	10	73%	27%	0%
Oda e Avokatëve të Kosovës	10	20%	40%	40%
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	13	77%	15%	8%
Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	28	57.14%	14.29%	28.57%
Institucioni i Avokatit të Popullit	1	0%	0%	100%
Universiteti i Prishtinës	2	50%	0%	50%
Ministria e Tregtisë dhe Odat Ekonomike	2	50%	0%	50%
Total numri i aktiviteteve	493			

Figura 2 – Zbatimi i aktiviteteve të Strategjisë (2021-2022) sipas institucioneve

Gjatë vitit 2023 aktivitetet e planifikuara kanë rezultuar në produkte të rëndësishme duke filluar nga 1) miratimi i politikave ligjeve dhe akteve nënligjore të reja, 2) avancimi i sistemit të raportimit të brendshëm në kuadër të gjyqësorit dhe prokurorisë, 3) ndërmarrja e një numri të madh të trajnimeve të specializuara veçanërisht nga Akademia e Drejtësisë por edhe odat e profesioneve të lira, 4) ngritja e transparencës duke ofruar qasje dhe publikuar një numër të konsiderueshëm të dokumenteve të brendshme, dhe 5) ndërmarrja e aktiviteteve vetëdijësuese për qasjen në drejtësi apo edhe përdorimin e mekanizmave për zgjidhjen alternative të kontesteve.

Figurat në vijim paraqesin buxhetin e shpenzuar deri në fund të vitit 2023 për realizimin e aktiviteteve të Strategjisë, në raport me koston e vlerësuar të këtyre aktiviteteve në kohën e miratimit të Strategjisë.




Figura 4: Krahasimi i raportit indikativ në mes të shpenzimeve dhe buxhetit për vitin 2023 të Strategjisë së Sektorit të Sundimit të Ligjit nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe Donatorëve

Objektivat strategjike	Buxheti (RKS + Donatorët) 2023	Shpenzimet (RKS + Donatorët) 2023
1. Forcimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial	1,188,883.40	3,165,524.50
2. Fuqizimi i sistemit të drejtësisë penale	6,876,014.86	425,208.52
3. Fuqizimi i qasjes në drejtësi	1,100,861.28	421,178.45
4. Fuqizimi i luftës anti-korrupsion	247,152.00	320,294.43
Σ	9,412,911.54	4,332,205.90

Figura 5: Buxheti kundrejt shpenzimeve indikative për vitin 2023 i Planit të Veprimit për periudhën 2021-2023 të Strategjisë së Sektorit të Sundimit të Ligjit, EUR

Përveç treguesve të produkteve sipas aktiviteteve të shtjelluara më lartë, Strategjia ka të përcaktuara edhe treguesit e ndikimit dhe treguesit e rezultateve në nivel të objektivave. Këta tregues janë zhvilluar sipas metodologjisë së *World Justice Project* (WJP) dhe *European Commission for the Efficiency of Justice* (CEPEJ). Për të vlerësuar arritjen e këtyre treguesve në këtë Raport vjetor, sa i përket WJP, është marrë për bazë raporti i fundit për Kosovën për vitin 2023³. Ndërsa, sa i përket indikatorëve të CEPEJ, informatat e përdorura janë ato të cilat janë ofruar nga koordinatori kombëtar për CEPEJ në kuadër të MD-së për

³ WJP. Të dhënat statistikore për Kosovën. Viti 2022. Të qasshme në: <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2022/Kosovo/>

Projektin Rajonal “Dashboard Project” bazuar në të dhënat e institucioneve përkatëse për vitin 2022, duke përfshirë KGJK-në.⁴ Gjithashtu, treguesit tjerë të zhvilluar të Strategjisë bazohen në të dhënat statistikore të publikuara nga KGJK në Raportin Statistikor Vjetor të vitit 2022, që analizon të dhënat në gjyqësor për vitin 2022⁵, por edhe të dhënat nga platforma e hapur e gjyqësorit.⁶

Pavarësisht një numri të madh të aktiviteteve të zbatuara plotësisht dhe buxhetit të shpenzuar, nga analiza e bërë vlerësohet se trendi i arritjes së caqeve të synuara, gjegjësisht synimit afatmesëm për vitin 2023 të përcaktuar në Strategjinë e Sundimit të Ligjit, është pjesërisht pozitiv, ndërsa në një pjesë të konsiderueshme të treguesve trendi nuk është ai i duhuri duke sjell madje edhe regres. Në krahasim me raportimin për periudhën 2022, vërehet një trend i rritjes së aktiviteteve të përmbushura dhe atyre të pa zbatuara, ndërkaq numri i aktiviteteve në zbatim e sipër është zvogëluar. Gjatë periudhës 2023 nuk është shënuar ndonjë trend i ngritjes apo i rënies në vlerësim në raport me periudhën e vlerësimit 2022, nga treguesit e metodologjisë së WJP, ku në makro-indikatorin e Strategjisë, Kosova sërish shënon me rezultat të përgjithshëm 0.56, rezultat i njejtë me atë të vitit 2022.⁷ Indikatorët e CEPEJ tregojnë rezultat negativ në disa aspekte (p.sh koha më e gjatë dispozicion për zgjidhjen e rasteve në shkallën e parë) dhe rezultat pozitiv në disa aspekte tjera (p.sh. kohëzgjatje më e vogël për zgjidhjen e rasteve në shkallën e dytë).

Gjithsesi, është e ditur se asnjë tregues nuk mund të mbulojë tërësinë e objektivave të politikës apo reformës që synohet. Këta tregues duhet të analizohen në raport edhe me tregues tjerë, rrethana e faktorë, që kur të analizohen në tërësi mund të japin një pasqyrë më të saktë të suksesit.

Janë disa faktorë që vlerësohet e kanë ngadalësuar progresin sa i përket treguesve: së pari pandemia COVID-19 e cila për një kohë ka paralizuar punën në gjyqësor dhe prokurori gjatë vitit 2020, aspektet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, pastaj numri i madh i kontesteve civile si rrjedhojë e kontratave kolektive të pazbatuara në sektor të caktuar, fokusi i Strategjisë në ndryshime ligjore të cilat kanë qenë të domosdoshme por rezultati i të cilave pritet të vërehet gjatë zbatimit që mund të merr kohë pak më të gjatë për të ndikuar treguesit e lartpërmendur, por edhe faktorë tjerë që së paku indirekt kanë pasur mundësi të ndikojnë. Kjo sjell nevojën pa dyshim që aktivitetet e Planit të Veprimit të Strategjisë të rishikohen dhe reflektojnë aktivitete edhe më konkrete që kontribuojnë në arritjen e objektivave. Kjo duhet të bëhet gjatë rishikimit afatmesëm të Strategjisë dhe hartimit të Planit të ri të Veprimit 2024-2026.

1. PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT 1: FORCIMI I SISTEMIT GJYQËSOR DHE PROKURORIAL

Numri më i madh i aktiviteteve në kuadër të objektivave janë të planifikuara në Objektivin 1, gjithsej 168 deri në vitin 2023, pra duke përfshirë edhe aktivitetet e realizuara në periudhën paraprake të raportimit. Nga këto aktivitete, siç u paraqit në Figurën 2 më lartë, 101 janë zbatuar plotësisht (59%), 46 janë zbatuar pjesërisht apo janë në zbatim e sipër (28%) dhe 23 aktivitete nuk janë zbatuar fare (14%). Si histori suksesi në kuptim të produkteve, këtu mund të përmenden: themelimi i degës së Gjykatës Themelore të Prishtinës në Fushë Kosovë me Ligin për Gjykatat, shtimi i numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj përmes rekrutimit, avancimi i SMIL në përputhje me të gjitha kërkesat e CEPEJ, caktimi automatik i lëndëve tek gjyqtarët, mbatja e trajnimeve të shumta nga AD, në veçanti në fushën e të drejtës komerciale, pastaj

⁴ CEPEJ. HFII: Towards a better evaluation of the results of judicial reform efforts in the Western Balkans

“DASHBOARD Western Balkans” Data collection: 2022. Part 2 (A) - Beneficiary fiche – Kosova. i qasshëm në: [1680ad53b0 \(coe.int\)](https://odp.gjyqesori-rks.org/)

⁵ KGJK. Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor 2023 - I qasshëm në: [1682 KGJK Raporti Statistikor Gjykatave Vjetori 2023.pdf \(gjyqesori-rks.org\)](https://odp.gjyqesori-rks.org/)

⁶ Të qasshme në: <https://odp.gjyqesori-rks.org/>

⁷ [WJP Rule of Law Index | Kosovo Insights \(worldjusticeproject.org\)](https://www.worldjusticeproject.org/)

miratimi i Koncept Dokumentit për Nëpunësit Civil në administratën e gjykatave dhe prokurorive, miratimi dhe hyrja në fuqi e Ligjit për Prokurorin e Shtetit etj.

Figura në vijim paraqet koston e planifikuar dhe shpenzimet deri tash sa i përket Objektivit 1.

Objektivi strategjik i Planit të Veprimit (2021-2023)	Buxheti (RKS + Donatorët) 2023	Shpenzimet (RKS + Donatorët) 2023
Objektivi strategjik 1: Forcimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial	1,188,883.40	3,165,524.50
Qëllimi specifik 1.1: Ngritja e llogaridhenies së Sistemit Gjyqësor dhe atij Prokurorial	249,795.86	223,790.70
Qëllimi specifik 1.2: Ngritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial	794,080.00	2,794,471.85
Qëllimi specifik 1.3: Ngritja e profesionalizmit dhe kompetencës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial	59,065.30	136,485.06
Qëllimi specifik 1.4: Përmirësimi i integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve	85,942.24	10,776.89

Figura 3 - Vlerësimi buxhetor kundrejt shpenzimeve indikative të objektivit strategjik 1 për vitin 2023, EUR

Sa i përket masave të politikave në kuadër të objektivave specifike të Objektivit Strategjik 1, vërehet se më së shumti aktivitete janë zbatuar plotësisht në raport me ato që kanë pasur numër të madh të aktiviteteve të planifikuara, në masat si në vijim: (1) sistem i avancuar dhe objektiv i vlerësimit të performancës që fokusohet në cilësinë dhe aftësitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, (2) Raportim me cilësi të lartë për të përmirësuar llogaridhënien, (3) ushtrim efektiv i mandateve gjyqësore dhe prokuroriale që sigurojnë llogaridhënie, dhe (4) rekrutimi, promovimi dhe transferimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës i bazuar në kompetencë. Kurse, më së paku zhvillim në masat e politikave (5) Akademia e Drejtësisë së Kosovës reaguese ndaj nevojave të sektorit të drejtësisë (6) Harmonizimi i trajnimeve të ofruara për zhvillim profesional me nevojat e sektorit të drejtësisë: (1) E- Drejtësia dhe ndërlidhshmëria e të dhënave, (2) Realizimi i kontroleve të pavarura dhe të vazhdueshme të integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës, (3) fuqizimi i kapaciteteve të njësive ekzistuese për verifikim në KGJK dhe KPK, dhe (4) Aftësimi i KGJK-së dhe KPK-së për ruajtjen e integritetit gjyqësor. Megjithatë, zbatimi i një numri të madh të aktiviteteve në masat e politikave të lartpërmendura të parashikuara në Planin e Veprimit, nuk nënkupton që reforma në këto masa është e plotë dhe nevojitet punë e mëtutjeshme përmes aranzhimeve ndërinstitucionale dhe gjatë procesit të rishikimit afatmesëm të Strategjisë.

Pavarësisht numrit të konsiderueshëm të aktiviteteve të zbatuara plotësisht, treguesit për arritjen e këtij objekti, veçanërisht ata sipas metodologjisë CEPEJ, pasqyrojnë rënie në raport me synimet e përcaktuara nga Strategjia në vitin 2023 dhe 2026.

↑ nënkupton zhvillim pozitiv

↓ nënkupton zhvillim negativ

Burimi i treguesit	Vlera bazë 2019	Vlera e arritur 2022	Synimi afatmesëm 2023	Vlera e arritur 2023	Synimi përfundimtar 2026	Burimi i treguesit	Vlera bazë 2019	Vlera e arritur 2022	Synimi afatmesëm 2023	Vlera e arritur 2023	Synimi përfundimtar 2026
1. WJP 'Indeksi i Sundimit të Ligjit'	0.54	0.56	0.59	0.56 ↑	0.64	15. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e	298	613	206	692↓	144

						parë penale' (në ditë) ⁸					
2. WJP 7.1 'Drejtësia civile është e qasshme dhe (financiarisht) e përballeshme'	0.6	0.61	0.62	0.62 ↑	0.64	16. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e dytë penale' (në ditë)	81	99	72	152↓	63
3. WJP 7.3 'Drejtësia civile është e lirë nga korrupsioni'	0.46	0.42	0.61	0.44 ↓	0.67	17. CEPEJ 'Shkalla e Spastrimit për shkallën e parë, për rastet civile/komerciale'	84.6%	53%	122%	61%↓	159%
4. WJP 7.4 'Drejtësia civile nuk ka ndikim jo të duhur qeveritar'	0.44	0.51	0.51	0.51 ↑	0.58	18. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e parë, në rastet civile/komerciale' (në ditë)	852	1339	536	1511↓	338
5. WJP 7.5 'Drejtësia civile nuk ka vonesa të paarsyeshme'	0.24	0.24	0.36	0.26 ↑	0.39	19. CEPEJ 'Shkalla e Spastrimit për shkallën e dytë, në rastet civile/komerciale'	123.11 %	66%	123%	95% ↓	123%
6. WJP 7.6 'Drejtësia civile zbatohet në mënyrë efektive'	0.42	0.48	0.52	0.49 ↑	0.53	20. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e dytë, në rastet civile/komerciale'	425	646	306	591↓	221
7. WJP 8.2 'Sistemi i gjyqimve penale është i saktë në kohë dhe efektiv'	0.34	0.33	0.50	0.33 ↓	0.53	21. CEPEJ 'Shkalla e Spastrimit për shkallën e parë, në rastet administrative'	93%	94%	132%	82%↓	171.6%
8. WJP 8.4 'Sistemi i drejtësisë penale është i paanshëm'	0.60	0.53	0.62	0.56 ↓	0.65	22. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e parë, për rastet administrative (në ditë)	787	798	460	967↓	323
9. WJP 8.5 'Sistemi i drejtësisë penale është i pakorruptuar'	0.50	0.49	0.61	0.48 ↓	0.68	23. CEPEJ 'Shkalla e Spastrimit për shkallën e dytë, për rastet administrative'	79.8%	74%	91%	101%↑	105%
10. WJP 8.6 'Drejtësia penale nuk ka ndikim jo të duhur qeveritar'	0.29	0.36	0.48	0.39 ↑ ^c	0.58	24. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e dytë, për rastet administrative (në ditë)	241	426	225	366↓	209
11. CEPEJ Rastet e pagjydhura penale (më të vjetra se 2 vite) në të gjitha gjykatat	13013	15672	6506	14862 ↓	0	25. CEPEJ '% e rasteve të pagjydhura më të vjetra se 24 muaj në GJTH të Prishtinës, për rastet penale'	53.18%	47%	26.90%	42.1%↑	0

⁸ Shih Përkufizimin e Kohës në Dispozicion (të llogaritur) në Fjalorin e CEPEJ (i qasshëm në: <https://rm.coe.int/cepej-glossary-albanian/1680a02c14>): Numri i lëndëve të pagjydhura në fund të një viti, i ndarë me numrin e lëndëve të zgjidhura brenda atij viti, shumëzuar me 365 (ditët e një viti): Koha e llogaritur për përfundimin e lëndëve të pagjydhura = (Numri i lëndëve të pagjydhura në fund të vitit / Numri i lëndëve të zgjidhura brenda vitit) × 365. Ky tregues vlerëson se sa ditë duhet të kërkohen për të zgjidhur lëndët e pagjydhura bazuar në kapacitetin aktual të gjykatës për të zgjidhur lëndët. Ajo përdoret si një parashikim i kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore. Ky tregues nuk është llogaritje e kohëzgjatjes së procedurave, por është vlerësim teorik i kohës së nevojshme për të proceduar lëndët e pagjydhura.

⁹ Shih Përkufizimin e Shkallës së Spastrimit në Fjalorin e CEPEJ: Raporti i përfutur nga pjesëtimi i numrit të lëndëve të zgjidhura me numrin e lëndëve të pranuar në një periudhë të caktuar, e shprehur si përqindje: Norma e zgjidhjes së lëndëve (%) = (Numri i lëndëve të zgjidhura në një periudhë kohore / Numri i lëndëve të pranuar në një periudhë kohore) × 100. Norma e zgjidhjes së lëndëve e barabartë me 100% tregon aftësinë e gjykatës ose të një sistemi gjyqësor për të zgjidhur aq lëndë sa është numri i lëndëve të pranuar brenda periudhës së caktuar kohore. Një normë e zgjidhjes së lëndëve mbi 100% tregon aftësinë e sistemit për të zgjidhur më shumë lëndë sesa ato të pranuar. Përfundimisht, një normë e zgjidhjes së lëndëve nën 100% shfaqet kur numri i lëndëve të pranuar është më i lartë se numri i lëndëve të zgjidhura. Në këtë rast numri i lëndëve të pagjydhura do të rritet. Në të vërtetë, norma e zgjidhjes së lëndëve tregon se si gjykata apo sistemi gjyqësor po përballet me rrjedhën e lëndëve të pranuar.

12. CEPEJ Rastet e pazgjidhura civile/komerciale (më të vjetra se 2 vite) në të gjitha gjykatat	17336	29093	10904	34460 ↓	6870	26. CEPEJ '% e rasteve të pazgjidhura më të vjetra se 24 muaj në GJTH të Prishtinës, për rastet civile kontestimore'	54.50%	43%	36.2%	31.5% ↑	23%
13. CEPEJ Rastet e pazgjidhura administrative (më të vjetra se 2 vite) në të gjitha gjykatat	2001	1830	1161	1610 ↑	813	27. CEPEJ '% e rasteve të pazgjidhura më të vjetra se 24 muaj në GJTH të Prishtinës, për rastet administrative	31.60%	22%	18.40%	22.4% ↑	12.9%
14. CEPEJ 'Shkalla e spastrimit për shkallen e parë, për rastet penale'	x	105%	Ngritur për 50%	100%	Ngritur për 100%	28. Numri i seancave të shtyra në Gjykata ¹⁰	x	16.9% GJTH	-25%	17.45%	-75%

Figura 4 - Treguesit e Objektivit 1

Lidhur me këtë, për aktivitetet që nuk janë zbatuar apo që janë zbatuar pjesërisht, sfidat apo mangësitë kanë pasur të bëjnë kryesisht me kapacitetet e institucioneve të përfshira për ti zbatuar aktivitetet me kohë, mu (p.sh. hartimi i programeve të trajnimit për komisionet e vlerësimit të performancës, apo analizave tjera dhe planifikimeve afatgjata), ngurrimit individual për zbatimin e disa aktiviteteve (p.sh. zbatimi i vazhdueshëm dhe konsistent i SMIL), priorizimi i aktiviteteve tjera, mos-marrja parasysh në mënyrë të plotë e të gjitha aktiviteteve relevante të Strategjisë (p.sh. rregulloret për rekrutim të prokurorëve, por edhe gjyqtarëve), mungesën e buxhetit, aktivitetet voluminoze që kërkojnë bashkëpunim ndërinsitucional (ligjet dhe dokumentet që rrjedhin nga reforma në drejtësi) dhe të tjera.

Si konkluzion, sa i përket këtij Objektivit, tash pas zbatimit të plotë të më shumë se gjysmës së aktiviteteve, fokusi gjatë vitit 2023 duhet të jetë që 63 aktivitetet e zbatuara pjesërisht apo të planifikuara, të zbatohen plotësisht. Këto duhet të priorizohen edhe në planifikimet e brendshme të institucioneve si KGJK, KPK dhe AD, të cilat e kanë numrin më të madh të këtyre aktiviteteve. Thënë këtë, historitë e suksesit duhet të përcjellen me aktivitete zbatuese konkrete që pritet të listohen në Planin e ri të Veprimit 2024-2026 të Strategjisë.

2. PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT 2: FUQIZIMI I SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE

Në kuadër të Objektivit 2 janë 82 aktivitete të planifikuara. Nga këto aktivitete, 39 (47.56%), kanë arritur të zbatohet plotësisht, ndërsa 23 janë duke u zbatuar pjesërisht (28.05%) dhe 20 (24.39%) mbesin të pazbatuara deri në fund të vitit 2023.

Historitë kryesore të suksesit në këtë objektiv kanë të bëjnë me konsolidimin e kornizës ligjore, gjegjësisht zhvillimi i strukturës së veçantë hierarkike brenda sektorit të prokurorisë përmes miratimit të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, miratimi i rregullores për veprimtarinë, organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës ku është themeluar një njësi e vecante për verifikim, miratimi në Kuvend i Ligjit për Prokurorinë Speciale ku është adresuar çështja që fokusi i PSRK-së të jetë në veprat e pastrimit të parave me vlerë më të madhe, miratimi në Kuvend i Ligjit për Sistemin Qëndror të Evidencës Penale, si dhe raportet dhe planet e punës të miratuara në kuadër të SHKK dhe SHSK.

¹⁰ Të dhëna të marra nga ODP

Kosto dhe shpenzimet deri në fund të vitit 2023 sa i përket aktiviteteve të Objektivit 2, janë të paraqitura në figurën e mëposhtme.

Objektivi strategjik i Planit të Veprimit (2021-2023)	Buxheti (RKS + Donatorët) 2023	Shpenzimet (RKS + Donatorët) 2023
Objektivi strategjik 2: Fuqizimi i sistemit të drejtësisë penale	6,876,014.86	425,208.52
Qëllimi specifik 2.1: Fuqizimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të	31,115.08	113,866.12
Qëllimi specifik 2.2: Ngritja e profesionalizmit në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit të	75,350.00	52,950.00
Qëllimi specifik 2.3: Fuqizimi i Sistemit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale	23,864.48	127,688.25
Qëllimi specifik 2.4: Forcimi i integritetit të Policisë së Kosovës	6,745,685.30	130,704.15

Figura 5 - Vlerësimi buxhetor kundrejt shpenzimeve indikative të objektivit strategjik 2 për vitin 2023, EUR

Rrjedhimisht, nga analiza e bërë për masat e politikave në kuadër të objektivave specifike të Objektivit Strategjik 2, rezulton se më së shumti aktivitete janë zbatuar plotësisht në raport me numrin e aktiviteteve të planifikuara, në kuadër të masave si në vijim: (1) zhvillimi i legjislacionit, (2) Fuqizimi i aftësive të planifikimit strategjik të SHSK-së dhe SHKK-së, dhe (3) Zhvillimi i politikave të SHKK-se dhe SHSK-se për burimet njerëzore dhe (4) Krijimi dhe zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm të vlerësimit të rrezikut dhe nevojave, dhe planifikimi individual të dënimit për të burgosurit e denuar dhe klientët e shërbimit sprovues për të ulur rrezikun e përsëritjes së veprave, kurse më sa paku të realizuara në masat e politikave: (1) Infrastruktura dhe administrata që fuqizon zyrtarët policor, (2) veting i përmirësuar dhe përputhshmëri me kodin e etikës, dhe (3) bashkëpunim i theksuar aktiv me prokurorinë për të përforcuar hetimet nga Policia.

Ngjashëm si në Objektivin 1, edhe në këtë Objektiv dhe siç mund të vërehet nga figura më poshtë, vlera e arritur e treguesve në vitin 2022 nuk pasqyron një trend pozitiv drejt arritjes së synimit afatmesëm të përcaktuar në vitin 2023.

↑ nënkupton zhvillim pozitiv

↓ nënkupton zhvillim negativ

Burimi i treguesit	Vlera bazë 2019	Vlera e arritur 2022	Synimi afatmesëm 2023	Vlera e arritur 2023	Synimi përfundimtar 2026	Burimi i treguesit	Vlera bazë 2019	Vlera e arritur 2022	Synimi afatmesëm 2023	Vlera e arritur 2023	Synimi përfundimtar 2026
1. CEPEJ Rastet e pazgjidhura penale (më të vjetra se 2 vite) në të gjitha gjykatat	13013	15672	6506	14862 ↓	0	9. WJP 8.2 'Sistemi i gjyqkimeve penale është i saktë në kohë dhe efektiv'	0.34	0.33	0.50	0.33 ↓	0.53
2. CEPEJ 'Shkalla e spastrimit për shkallen e parë, për rastet penale'	x	105%	Ngritur për 50%	100%	Ngritur për 100%	10. WJP 8.3 'Sistemi korrektues është efektiv në uljen e sjelljes kriminale'	0.60	0.58	0.62	0.56 ↓	0.64
3. CEPEJ 'Koha në dispozicion për	298	613	206	692 ↓	144	11. WJP 8.4 'Sistemi i drejtësisë	0.60	0.53	0.62	0.56 ↓	0.65

shkallën e parë penale' (në ditë)						penale është i paanshëm'					
4. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e dytë penale' (në ditë)	81	99	72	152↓	63	12. WJP 8.5 'Sistemi i drejtësisë penale është i pakorruptuar'	0.50	0.49	0.61	0.48↓	0.68
5. WJP 1 'Kufizimet në pushtetin e Qeverisë' Policia	0.52	0.56	0.55	0.56↑	0.62	13. WJP 8.5.1 'Policia, forcat e armatosura dhe prokurorët janë të lirë nga ndikimi jo i duhur'	0.50	0.49	0.61	0.48↓	0.68
6. WJP 2.3 'Zyrtarët qeveritarë në Polici dhe forcat e armatosura nuk e përdorin funksionin publik për përfitime personale'	0.64	0.62	0.71	0.61↓	0.77	14. WJP 8.6 'Drejtësia penale nuk ka ndikim jo të duhur qeveritar'	0.29	0.36	0.48	0.39↑	0.58
7. WJP 8 'Fuqizimi i sistemit të Drejtësisë Penale'	0.47	0.46	0.5	0.46↓	0.56	15. WJP 8.7.5 'Të drejtat e të burgosurve'	0.60	0.60	0.62	0.60	0.65
8. WJP 8.1 'Sistemi i hetimeve penale është efektiv'	0.35	0.32	0.47	0.33↓	0.49						

Figura 6 - Treguesit e Objektivit 2

Sa i përket sfidave, për këtë objektivë, ato janë hasur në bashkëpunim ndër-institucional (p.sh. grupi punues ndër-institucional për të ofruar interpretim të unifikuar të "dashjes"), vonesës në hartimin e politikave dhe ligjeve (p.sh. Koncept Dokumenti për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Ligji për Policinë, Ligji për Pensionimin e Zyrtarëve Policor apo planeve strategjike të SHKK dhe SHSK), kapaciteteve analitike (p.sh. zhvillimi i metodës të bazuar në Test për të vendosur mbi kërkesat për paraburgim), por edhe limiteve buxhetore si gjithmonë.

Fokusi gjatë vitit 2023 duhet të jetë në hartimin dhe miratimin e politikave dhe ligjeve të mbetura por edhe finalizimin e nismave tjera nga institucionet zbatuese. Ngjashëm si në objektivin 1, duhet të vendosen aktivitete të reja në Planin e ri të Veprimit të Strategjisë, ashtu që të punohet drejt arritjes së synimeve, së paku afatgjate, të Strategjisë sipas treguesve.

3. PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT 3: FUQIZIMI I QASJES NË DREJTËSI

Objektivi 3 ka numrin e dytë më të madh të aktiviteteve – gjithsej 151, nga të gjithë objektivat 69 (45.70%) është numri i aktiviteteve të zbatuara plotësisht, 47 (31.13%) pjesërisht apo në zbatim e sipër, dhe 35 (23.18%) në të cilat nuk ka asnjë zhvillim, në kuadër të këtij Objektivit.

Fuqizimi i ndihmës juridike falas, avancimi i saj në projekte ndëlidhur me institucionet e drejtësisë është një ndër historitë kryesore të suksesit të këtij objektivit, pastaj avancimi elektronik i institucioneve të drejtësisë të KGJK-së dhe KPK-së në lidhje me ofrimin sa më konkret të qasjes në drejtësi të qytetarëve, zhvillimi i programve trajnuese për ndërmjetësimin si metodë alternative për profesionet e lira, trajnimi i përkthyesve, përmbushja e iniciativave ligjore si Hartimi i Ligjit për Kontestet Administrative, Miratimi i plotësim-ndryshimit të Kodit Penal për të adresuar specifikisht kriminalizimin e keqtrajtimit në stacionet e policisë, në qendra korrektuese dhe në qendrat e ndalimit, mbështetja e viktimave të dhunës në baza

gjinore, avancimi i programeve të trajnimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me dhunën në familje, pastaj hartimi i Analizave në lidhje me të drejtën për gjykim të arsyeshëm përmes shtjerrjes së mjeteve juridike në organet ankimese, avancimet infrastrukturore në Polici sa i përket regjistrimeve elektronike të intervistave policore dhe vendosjes së kamerave në vendet e ndalimit, rekrutimi i përmbaruesve privat shtesë nga MD, avancimi i zyrtarëve të MD në njohjen e gjuhëve të huaja.

Sa i përket kostos së planifikuar dhe shpenzimeve në Objektivin 3, figura në vijim i paraqet ato.

Objektivi strategjik i Planit të Veprimit (2021-2023)	Buxheti (RKS + Donatorët) 2023	Shpenzimet (RKS + Donatorët) 2023
Objektivi strategjik 3: Fuqizimi i qasjes në drejtësi	1,100,861.28	421,178.45
Qëllimi specifik 3.1: Përmirësimi i qasjes në gjykata dhe prokurori	231,151.12	117,023.54
Qëllimi specifik 3.2: Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit të mjeteve juridike	283,592.24	132,997.95
Qëllimi specifik 3.3: Përmirësimi i Shërbimeve të Profesioneve të Lira	365,663.00	56,761.12
Qëllimi specifik 3.4: Rritja e rolit mbikëqyrës dhe avokues të organizatave të shoqërisë civile	87,634.26	50,249.72
Qëllimi specifik 3.5: Fuqizimi i rolit të Ministrisë së Drejtësisë në procesin e anëtarësimit në	132,820.66	64,146.12

Figura 7 - Vlerësimi buxhetor kundrejt shpenzimeve indikative të objektivit strategjik 3 për vitin 2023, EUR

Tutje, sa i përket masave të politikave në kuadër të objektivave specifike të Objektivit Strategjik 3, rezulton se më së shumti aktivitete janë zbatuar plotësisht në raport me ato që kanë pasur numër të madh të aktiviteteve të planifikuara, në masat si në vijim: (1) përmirësimi i sistemit të ndihmës juridike në Kosovë në pajtim me kërkesat e BE-së dhe KiE-së, (2) përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për të siguruar mjete juridike efektive me shikim në shërbimet ligjore dhe të drejtësisë të orientuara kah qytetari, dhe (3) zhvillimi i mëtejme dhe konsolidimi i ndërmjetësimit dhe procedurave të falimentimit. Në anën tjetër më së paku zhvillim në masat e politikave: (1) Bashkëpunim efektiv në mes të organeve jo gjyqësore dhe gjykatave dhe prokurorive, (2) përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve për të gjitha profesionet e lira ligjoredhe (3) rritja e kapacitetit të gjyqësorit të Kosovës për integrim në BE.

Për dallim nga objektivat tjerë, në këtë objektivë ka edhe një numër të madh të treguesve tani të arritur ose në trend më pozitiv me WJP në raport me numrin total të treguesve.

↑ nënkupton zhvillim pozitiv

↓ nënkupton zhvillim negativ

Burimi i treguesit	Vlera bazë 2019	Vlera e arritur 2022	Synimi afatmesëm 2023	Vlera e arritur 2023	Synimi përfundimtar 2026	Burimi i treguesit	Vlera bazë 2019	Vlera e arritur 2022	Synimi afatmesëm 2023	Vlera e arritur 2023	Synimi përfundimtar 2026
1. CEPEJ Rastet e pazgjidhura penale (më të	13013	15672	6506	14862 ↓	0	13. CEPEJ 'Shkalla e Spastrimit për shkallën e	79.8%	74%	91%	101% ↑	105%

vjetra se 2 vite) në të gjitha gjykatat						dytë, për rastet administrative						
2. CEPEJ Rastet e pazgjidhura civile/komerciale (më të vjetra se 2 vite) në të gjitha gjykatat	17336	29093	10904	34460 ↓	6870	14. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e dytë, për rastet administrative (në ditë)	241	426	225	366 ↓	209	
3. CEPEJ Rastet e pazgjidhura administrative (më të vjetra se 2 vite) në të gjitha gjykatat	2001	1830	1161	1610 ↑	813	15. WJP 1.5.3 'Liria e organizatave civile dhe politike është respektuar'	0.57	0.59	0.62	0.59 ↑	0.67	
4. CEPEJ 'Shkalla e spastrimit për shkallën e parë, për rastet penale'	x	105%	Ngritur për 50%	100%	Ngritur për 100%	16. WJP 3.3 'Pjesëmarrja civile'	0.57	0.59	0.58	0.58 ↑	0.64	
5. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e parë penale' (në ditë)	298	613	206	692 ↓	144	17. WJP 6.4 'Respektimi i gjykimit të drejtë në procedura administrative'	0.35	0.38	0.38	0.37 ↑	0.47	
6. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e dytë penale' (në ditë)	81	99	72	152 ↓	63	18. WJP 6.5 'Qeveria nuk shpronëson pa proces ligjor dhe kompensim adekuat'	0.55	0.58	0.58	0.58 ↑	0.61	
7. CEPEJ 'Shkalla e Spastrimit për shkallën e parë, për rastet civile/komerciale'	84.6%	53%	122%	61% ↓	159%	19. WJP 7.1 'Njerëzit mund t'i qasen dhe ta përballojnë financiarisht drejtësinë civile'	0.60	0.61	0.62	0.62 ↑	0.64	
8. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e parë, në rastet civile/komerciale' (në ditë)	852	1339	536	1511 ↓	338	20. WJP 7.1.1 'Qytetarët janë të vetëdijshëm për mjetet juridike në dispozicion'	0.60	0.61	0.62	0.62 ↑	0.64	
9. CEPEJ 'Shkalla e Spastrimit për shkallën e dytë, në rastet civile/komerciale'	123.11 %	66%	123%	95 ↓	123%	21. WJP 7.5.1 'Vonesat në zgjidhjen e kontesteve'	0.24	0.24	0.36	0.26 ↑	0.39	
10. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e dytë, në rastet civile/komerciale' (në ditë)	425	646	306	591 ↓	221	22. WJP 7.7 'Mekanizmat ZAK janë të qasshme, të paanshme dhe efektive'	0.62	0.62	0.71	0.64 ↑	0.74	
11. CEPEJ 'Shkalla e Spastrimit për shkallën e parë, në rastet administrative'	93%	94%	132%	82% ↓	171.6%	23. WJP 8.7 'Procesi i rregullt gjyqësor dhe të drejtat e akuzuarit'	0.47	0.60	0.64	0.60 ↑	0.65	
12. CEPEJ 'Koha në dispozicion për shkallën e parë, për rastet administrative (në ditë)	787	798	460	967 ↓	323	24. WJP 8.7.4 'Ndihma Juridike'	0.60	0.60	0.63	0.60	0.65	

Figura 8 - Treguesit e Objektivit 3

Ndërsa, vonesa ka pasur në çështje si caktimi i avokatëve për çështje të ndihmës juridike, sfida në krijimin e hartës për nevoja gjyqësore apo edhe zhvillimit të anketave të përdoruesve të gjykatave, rolit të OAK-së në ngritjen e vetëdijes së avokatëve për mundësitë që i ofron ndërmjetësimi, raportimet e mangëta të institucioneve në Kuvend lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, themelimi i njëjësive të përkthyesve në gjykata, mos miratimi i ligjit për tarifa dhe shpenzime gjyqësore, ngecjet në hartimin e Startegjisë për ndërmjetësim etj. të cilat janë në përgjithësi si rezultat i mos-prioritizimit të aktiviteteve, por edhe mungesës së kapaciteteve, pavarësisht një prezence të theksuar të projekteve të partnerëve zhvillimor të Kosovës lidhur me këtë objektivë.

Si konkluzion për këtë Objektivë, MD si institucion udhëheqës i politikave në sistemin e drejtësisë në Kosovë, duhet të finalizoj Rregulloren e brendshme dhe plotësimin e pozitave vakante, ndërsa institucionet tjera duhet fokusuar në zbatimin e aktiviteteve konkrete që janë tanimë në Planin e Veprimit të Strategjisë dhe që ndikojnë drejtpërdrejtë në qasje në drejtësi, por edhe në planifikim të aktiviteteve gjatë rishikimit afatmesëm të Strategjisë.

4. PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT 4: FUQIZIMI I LUFTËS ANTI-KORRUPSION

Në hyrje të këtij Kapitulli, u cek se Objektivi 4 ka numrin më të madh të aktiviteteve të zbatuara në raport me ato të planifikuara, gjithsej 47 nga 63 (74.60%). Ky Objektiv ka qenë i fokusuar në krijimin e kornizës së re ligjore për luftën anti-korrupsion, gjegjësisht ndryshimin e misionit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në parandalim të korrupsionit që është bërë me Ligj të ri i cili tutje ka specifikuar kompetencat e saj. Përveç kësaj, dhe përveç miratimit të Ligjit të ri për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, në fazat e mëhershme i përcjellur edhe me sistemin elektronik për deklarimin elektronik të pasurisë, Agjencia ka pasur suksese në miratimin e rregullores së brendshme e cila avancoi sistemin e vlerësimit antikorrupsion të legjislacionit, trajnimet e vazhdueshme të stafit dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera në ofrimin e trajnimeve për luftën anti korrupsion, Ngritja e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve policorë të Njësisë së Veçantë të Hetimeve për zhvillimin e hetimeve në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, Hartimi i përkufizimit të ri 'korrupsion i nivelit të lartë' i cili do përfshihet i uniformuar në Ligjin për PSRK-në, Kodin Penal dhe ligje të tjera relevante konsiderohen si historitë më të rëndësishme të suksesit sa i përket këtij Objektiv

Kostot e planifikuara dhe buxheti i shpenzuar deri në fund të vitit 2023 sa i përket këtij Objektiv paraqitet në figurën në vijim.

Objektivi strategjik i Planit të Veprimit (2021-2023)	Buxheti (RKS + Donatorët) 2023	Shpenzimet (RKS + Donatorët) 2023
Objektivi strategjik 4: Fuqizimi i luftës anti-korrupsion	247,152.00	320,294.43
Qëllimi specifik 4.1: Përmirësimi i kornizës institucionale për luftimin e korrupsionit	230,322.00	292,756.48
Qëllimi specifik 4.2: Përmirësimi i sistemit të deklarimit të pasurisë dhe rregullativës për pranimin e dhuratave	16,830.00	27,537.95

Figura 9 - Vlerësimi buxhetor kundrejt shpenzimeve indikative të objektivit strategjik 4 për vitin 2022, EUR

Konsolidimi i kornizës ligjore reflekton edhe në masën e politikave që është zbatuar më së shumti në kuadër të objektivave specifike të Objektivit Strategjik 4, pra në masën 'fuqizimi i kornizës ligjore', ndërsa më së paku zhvillime ka sa i përket masës së politikës 'trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve'.

Në raport edhe me treguesit, vërehet trend më pozitiv drejt arritjes së synimit afatmesëm të vitit 2023, me disa përjashtime.

↑ nënkupton zhvillim pozitiv

↓ nënkupton zhvillim negativ

Burimi i treguesit	Vlera bazë 2019	Vlera e arritur 2022	Synimi afatmesëm 2023	Vlera e arritur 2023	Synimi përfundimtar 2026	Burimi i treguesit	Vlera bazë 2019	Vlera e arritur 2022	Synimi afatmesëm 2023	Vlera e arritur 2023	Synimi përfundimtar 2026
1. WJP 2 'Mungesa e korrupsionit'	0.46	0.48	0.53	0.48 ↑	0.61	5. WJP 2.4 'Zyrtarët publik në degën legjislative nuk e përdorin funksionin	0.64	0.34	0.71	0.33 ↓	0.78

						publik për përfitime private'					
2. WJP 2.1 'Zyrtarët publik në degën ekzekutive nuk e përdorin funksionin publik për përfitime private'	0.45	0.48	0.47	0.48↑	0.54	6. WJP 6.1 'Ekzekutimi rregullativ'	0.36	0.38	0.6	0.38↑	0.63
3. WJP 2.2 'Zyrtarët publik në degën e gjyqësorit nuk e përdorin funksionin publik për përfitime private'	0.45	0.48	0.71	0.48↑	0.78	7. CEPEJ 226 'Numri i procedurave të inicuar / përfunduara / sanksionet e shqiptuara për shkelje të rregullave të konfliktit të interesit në lidhje me gjyqtarët dhe prokurorët'	2019: 9			2023: Për gjyqtarët: 0 të inicuar, 0 të përfunduara-0 sanksione. Për prokurorët-0 të inicuar, 0 të përfunduara-0 sanksione. ↓	
4. WJP 2.3 'Zyrtarët publik në polici & ushtri nuk e përdorin funksionin publik për përfitime private'	0.63	0.62	x	0.61↓	x	8. CEPEJ 202 'Numri i procedurave të inicuar kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkak të shkeljeve / mospërputhjeve në deklarimin e pasurisë'	2019: Për gjyqtarët: 6 të inicuar, 1 e përfunduar, 1 sanksion. Për prokurorët: 3 të inicuar, 3 të përfunduara, 0 sanksione.			2023: Për gjyqtarët: N/A të inicuar, N/A të përfunduara, N/A sanksione. ↓ Për prokurorët: N/A të inicuar, N/A të përfunduara, N/A sanksione. ↓	

/A/

Figura 10 - Treguesit e Objektivit 4

Sfidë e rëndësishme mbetet ngritja e vetëdijes për korrupsionin në sektorin privat dhe ndërmarrja e aktiviteteve të shumta për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në këtë sektor sipas kërkesave ligjore, për të cilën duhet të ketë bashkëpunim të theksuar në mes të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Inspektoratit të Punës.

III. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Kapitulli II më lartë paraqiti progresin e arritur deri tash në zbatimin e Strategjisë, në kuptim të zbatimit të aktiviteteve, buxhetit të shpenzuar, arritjes së treguesve sipas objektivave dhe sfidave e mangësive të hasura deri tash. Në këtë Kapitull paraqiten rreziqet kryesore që kanë penguar dhe mund të pengojnë zbatimin e mëtutjeshëm të Strategjisë.

Ato mund të grupohen si në vijim:

- **Mos-prioritizimi i zbatimit të aktiviteteve.** Siç është parë nga vlerësimi i zbatimit të Strategjisë deri tash, një numër i caktuar i aktiviteteve janë neglizhuar nga njësitë e institucioneve përkatëse që ka rezultuar në mos-zbatim të tyre apo vonesa të theksuara. **Hapi për adresim:** Çdo udhëheqës i institucionit së bashku me Zyrtarin Kryesor Administrativ dhe mbështetjen e Sekretariatit të Strategjisë mbledhin këto aktivitete në nivel institucional dhe i adresojnë ato urgjentisht tek njësitë përkatëse.

- **Mungesa e kapaciteteve.** Këtu vijnë në shprehje mungesa e stafit apo edhe aftësive specifike për zbatimin e aktiviteteve të caktuara të Strategjisë. **Hapi për adresim:** Çdo institucion zbatues merr masa për plotësimin e pozitave vakante që ndërlidhen drejtpërdrejtë me zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë, të cilat përcjellën edhe me trajnime relevante të stafit. Si rrjedhojë, është e rëndësishme që çdo institucion zbatues organizon takime të veçanta me partnerët zhvillimorë për të konkretizuar tutje mbështetjen e tyre në zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë.
- **Buxheti.** Për zbatimin e aktiviteteve të caktuara ka nevojë që buxheti të sigurohet. **Hapi për adresim:** Ministria e Financave dhe Kuvendi i Kosovës marrin parasysh kërkesat buxhetore të institucioneve për zbatimin e aktiviteteve që kanë ngecur deri tash në Strategji.
- **Bashkëpunimi ndër-institucional.** Mungesa e bashkëpunimit në mes akterëve kryesor të kësaj Strategjie mund të sjellë vonesa të mëtutjeshme në zbatimin e aktiviteteve. **Hapi për adresim:** MD, KGJK dhe KPK pa vonesë zbatojnë Dokumentin e Zotimeve të nënshkruar në muajin Mars 2023. KGJK dhe KPK mbajnë punëtori dhe mbledhje të përbashkëta për zbatimin e aktiviteteve të ndërlidhura të kësaj Strategjie. Institucionet rregullisht takohen dhe bëjnë planifikimet e duhura për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta.
- **Procesi i rishikimit afatmesëm të Strategjisë.** Sipas Kapitullit V të Strategjisë, rishikimi afatmesëm i Strategjisë parashihet të bëhet jo më larg se deri në mes të vitit 2024, kur edhe përgatitet Planit i ri i Veprimit të Strategjisë 2024-2026. Për këtë qëllim duhen kapacitete adekuate dhe përkushtim. **Hapi për adresim:** Planit të Veprimit i paraprijnë analizat relevante sipas objektivave të rishikuara të Strategjisë, analiza të cilat duhet të përfundohen në pjesën e parë të 2024. Zhvillimi i analizave dhe hartimi i Planit të ri të Veprimit mbështeten nga partnerët zhvillimorë.

Shtojca 1: Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit për vitin 2023

Udhëzim:

Ngjyra e gjelbërt tregon zbatimin e plotë të një aktiviteti

Ngjyra e portokalltë tregon zbatimin e pjesshëm apo se një aktivitet është në zbatim e sipër

Ngjyra e kuqe tregon se aktiviteti nuk është zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim lidhur me të

Ngjyra e kaltër tregon zbatimin e një aktiviteti i cili është raportuar si i përfunduar deri në fund të 2022

Kapitulli 1.1 - Ngritja e llogaridhënies së gjyqarëve dhe prokurorëve

	Veprimi	Afati i fundit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Progresi në zbatim
Masa e politikës: Fuqizimi i përbërjes së KGJK dhe KPK me pjesëmarrje aktive të anëtarëve jo gjyqarë dhe jo prokurorë dhe me konsideratë të duhur ndaj barazisë gjinore dhe etnike					50% zbatuar plotësisht
1	Plotësimi i përbërjes së KGJK-së me të gjithë anëtarët jo-gjyqësorë	2022	Kuvendi	Anëtarë i mbetur jo-gjyqësor i KGJK-së i emëruar nga Kuvendi	Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2022 ka zgjedhur një anëtar jo-gjyqësorë sipas Nenit 8(1.3) të Ligjit për KGJK-në, ndërsa mbetet të zgjedh edhe 1 anëtarë nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, sipas Nenit 8(1.4) të Ligjit për KGJK-në. Komisioni me datë 17.6.2022 ka marr vendim për rishpalljen e Konkursit për zgjedhjen e këtij/kësaj anëtar/i/e.
2	Ndryshimi i ligjit për KPK-në në mënyrë që numri i anëtarëve prokurorë në KPK të zvogëlohet	2022	MD, KPK	Ligji i miratuar	Projektligji me ndryshimet e bëra është aprovuar në qeveri dhe aktualisht gjendet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. (linku:https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=490)
3	Hartimi i procedurave të Kuvendit të Kosovës për përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve jo gjyqarë/jo prokurorë në KGJK dhe KPK	2022	Kuvendi	Procedura apo akti nënligjor i miratuar	Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar këtë aktivitet dhe konstaton se Ligji për KGJK-në, Rregullorja e Kuvendit dhe praktika e krijuar në Komision dhe Kuvend janë të mjaftueshme për zhvillimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve jo-gjyqësorë dhe jo-prokurorial në KGJK dhe KPK.
4	Zbatimi i masave të politikës nga KGJK dhe KPK për sigurimin e përfaqësimit gjinor dhe etnik	2022	KGJ, KPK, Kuvendi	Përbërja e KGJK dhe KPK ka përfaqësim të barabartë gjinor dhe përfaqësim proporcional etnik	<p>Përbërja aktuale e KGJK-së ka përfaqësim gjinor dhe etnik, në përputhje me Ligjin në fuqi. Në përbërjen e KGJK-së janë 12 anëtarë prej të cilëve 8 janë burra ndërsa 4 gra. Nga gjyqësori janë 7 gjyqtar në përbërje të KGJK-së, si në vijim: Gjykata Supreme 2 gjyqtar, 1 burrë dhe 1 grua; Gjykata e Apeli 2 gjyqtar, 1 burrë dhe 1 grua; Gjykata Themelore 3 gjyqtar, 2 burra dhe 1 grua.</p> <p>Nga Kuvendi i Kosovës janë 6 anëtarë në KGJK, si në vijim: Sipas Nenit 8 pika (1.2) të Ligjit për KGJK-në, (Dy anëtar meshkuj njeri gjyqtar tjetri jo gjyqtar); Sipas Nenit 8 pika (1.3) të Ligjit për KGJK-në, (Një anëtarë Femër); Sipas Nenit 8 pika (1.4) të Ligjit për KGJK-në, (Dy anëtar meshkuj njeri gjyqtar tjetri jo gjyqtar)</p> <p>Mbetet të zgjedhën: një anëtar - gjyqtar nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kosovë sipas Nenit 8 (1.2) të Ligjit për KGJK-në. Po ashtu zv.Kryesuesi i KGJK-së është grua.</p> <p>KGJK ka plotësuar kuotën gjinore. Përbërja aktuale e KPK-së ka përfaqësim gjinor dhe etnik, në përputhje me Ligjin në fuqi. Gjithashtu, Rregullorja Nr.06/2020 për Zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit parasheh që nëse ka aplikues nga komuniteti joshumicë ose nga gjinia e nën-përfaqësuar, KPK-ja do të angazhohet të sigurojë që në përbërjen e saj të ketë se paku 1 anëtar nga komuniteti joshumicë dhe së paku tre anëtarë të gjinisë së nën-përfaqësuar. Aktualisht, nga 9 anëtarët e KPK-së, 6 anëtarë janë burra dhe 3 anëtarë janë gra, ndërsa anëtarë nga komuniteti serb që ishte zgjedhur nga KPK ben pjesë ne grupin e prokuroreve të dorëhequr.</p>
Masa e politikës: Sistem i avancuar dhe objektiv i vlerësimit të performancës që fokusohet në cilësinë dhe aftësitë e gjyqarëve dhe prokurorëve					100% zbatuar plotësisht

5	Ndryshimi i Rregulloreve mbi vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, për t'u siguruar se kriteret kualitative, treguesit dhe procedurat për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve parashikohen në detaje me legjislacion	2021	KGJK	Rregulloret e ndryshuara	Rregullorja për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve është aprovuar në vitin 2021, ku janë përfshirë kriteret sipas këtij aktiviteti. ¹¹
6	Hartimi i rregullores për vlerësimin e përfundimtar të Kryetarëve të Gjykatave dhe gjyqtarëve që mbajnë pozita udhëheqëse	2021	KGJK	Rregullorja e miratuar	Rregullorja për Vlerësimin e performancës së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës është miratuar nga KGJK me datë 27.12.2022. ¹²
7	Analiza e nevojës për funksionimin e Njësive të Inspektimit Gjyqësor (NJIGJ) në KPK	2022	MD, KPK	Analiza e finalizuar	MD: Kjo çështje është e ndërlidhur me "Deklaratën e Perbashket të Zotimit". Ky aktivitet pritet të zhvendoset në KPK pas rishikimit të Planit të Veprimit të SSL. KPK: KPK e ka analizuar nevojën për funksionimin e kësaj Njësie dhe ka konstatuar se Komisioni për Administrimin e Prokurorëve e ka këtë funksion.
8	Miratimi i kornizës rregullative nga KGJK për të siguruar që funksionet e Njësive të Inspektimit Gjyqësor (NJIGJ) të parashihen me ligj, duke respektuar pavarësinë gjyqësore	2022	KGJK	Korniza rregullative në KGJK e miratuar	Rregullorja për Organizimin dhe funksionimin e NJIGJ është miratuar nga KGJK me datë 27.12.2022. ¹³
9	Rishikimi dhe ndryshimi i shablloneve aktuale të përdorura për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve në atë mënyrë që të shabllonet të reflektojnë plotësisht kriteret cilësore sipas legjislacionit të ndryshuar	2022	KGJK	Shabllonet e ndryshuar në përputhje me legjislacionin e ndryshuar	KGJK ka nxjerrur shabllonet e reja për vlerësimin e performancës që bazohen në Rregulloren për vlerësimin e performancës të vitit 2021.
10	Hartimi i manualeve udhëzues me shpjegime të hollësishme nga KGJK dhe KPK lidhur me tërë procesin e vlerësimit të performancës	2022	KGJK, KPK	Manualet e miratuara	KGJK ka nxjerrur Udhëzuesin për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, i cili bazohet në Rregulloren për vlerësimin e performancës të vitit 2021. ¹⁴ KPK ka nxjerrur Udhëzuesin për zbatimin e Rregullores për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, në Qershor të vitit 2021. ¹⁵
11	Komisionet e vlerësimit të performancës të bëjnë publikimin e rregullt të raporteve mbi numrin e gjyqtarëve që janë vlerësuar, rekomandimet e dhëna, dhe t'ua dorëzojnë ato palëve me kohë	2021 - 2023	KGJK	Raportet e Komisioneve publikohen dhe vlerësimet e performancës i dorëzohen palëve me kohë;	Raport vjetor i punës së Komisionit për Vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve për vitin 2023 është publikuar në uebfaqen e KGJK-së. ¹⁶
12	Komisionet e vlerësimit të performancës të bëjnë publikimin e rregullt të raporteve mbi numrin e prokurorëve që janë vlerësuar, rekomandimet e dhëna, dhe t'ua dorëzojnë ato palëve me kohë	2021 - 2023	KPK	Raportet e Komisioneve publikohen dhe vlerësimet e performancës i dorëzohen palëve me kohë;	Raport i mbi numrin e prokurorëve të vlerësuar deri në vitin 2022 është publikuar në web portalin e sistemit prokurorial dhe po ashtu për vlerësimin janë njoftuar palët me kohë. ¹⁷ KPK do të hartojë Raportin vjetor ku do të pasqyrohen të gjitha proceset e vlerësimit të performancës së prokurorëve gjatë vitit 2023. Në muajin dhjetor 2023 KPK ka miratuar Planin e Komisionit për vlerësimin e performancës që përfshin proceset dhe numrin e prokurorëve që do të vlerësohen gjatë vitit 2024.

¹¹ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/89895_Rregullore_Nr_01_2021_per_vleresimin_performances_se_gjyqtareve.pdf

¹² https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/2283_KGJK_Rregullore_Nr_13_2022_per_vleresimin_performances_te_kryetarëve_te_gjykatave_dhe_gjyqtarëve_mbikeqyrës.pdf

¹³ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/34512_KGJK_Rregullore_Nr_14_2022_per_organizimin_dhe_funksionimin_njesise_per_inspektim_gjyqësor.pdf

¹⁴ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/86049_Udhezuesi_per_Vleresimin_e_Performances_se_Gjyqtareve.pdf

¹⁵ <https://www.prokuroriars.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Legjislacioni/rregullore/Rregullore%20Nr.05.2020%20p%C3%ABr%20Vler%C3%ABsim%20e%20Performanc%C3%ABs%20s%C3%AB%20Prokuror%C3%A4ve.pdf>

¹⁶ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/75040_Raport_vjetor_i_KVPGJ_2023.pdf

¹⁷ <https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Vleresimet%20e%20performances%20se%20prokurorëve%20nga%20Komisioni%202014-2022.pdf>

13	Vlerësimi vjetor nga KGJK i numrit të kërkuar ligjërish të gjyqtarëve (1/3)	2021 - 2023	KGJK	Vlerësimet e rregullta vjetore	KGJK ka përfunduar këtë aktivitet duke vlerësuar 1/3 e gjyqtarëve të kërkuara me ligj. ¹⁸
14	KGJK ofron arsytetime të qarta për çdo vendim lidhur me avancimin e gjyqtarëve bazuar në vlerësimin e performancës	2021 - 2023	KGJK	Vendimet për avancim të gjyqtarëve përbajnë arsytetime mbi performancën e gjyqtarit	Vendimet e KGJK-së për avancim ofrojnë arsytetime të qarta bazuar në vlerësimin e performancës. Kjo çështje është adresuar edhe përmes rregullores për plotësim ndryshimin e rregullores nr.04/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.01/2014 për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. ¹⁹
15	KPK ofron arsytetime të qarta për çdo vendim lidhur me avancimin e prokurorëve bazuar në vlerësimin e performancës	2021 - 2023	KPK	Vendimet për avancim të prokurorëve përbajnë arsytetime mbi performancën e prokurorit	Gjatë vitit 2023, Raportet e Komisionit për Avancim dhe transferim janë prezantuar në takimet e Këshillit dhe këto raporte përbajnë në mënyrë të detajuar dhe të arsyetuar çdo propozim për avancim të prokurorëve, përfshirë vlerësimin e performancës së kandidatëve, dhe në bazë të këtyre raporteve merren vendimet nga ana e Këshillit për avancim. Vendimet për transferim dhe avancim gjithashtu publikohen, por edhe merren parasysht lëndët e mbetura nga ata prokurorë të cilët avancohen. Për me tepër, neni 12 paragrafi 1.2 i Rregullores për Transferimin dhe avancimin e prokurorëve e përcakton qartë si kriter të përgjithshëm për avancim vlerësimin e mjaftueshëm ose më të lartë të performancës. Andaj, prokurorët të cilët nuk kanë këtë nivel të vlerësimit, nuk e plotësojnë këtë kriter. Pra, gjithmonë merret parasysht vlerësimi i performancës gjatë shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve/prokurorëve që kanë aplikuar për avancim. Kandidatët njoftohen me rezultatet dhe u jepet afati për kundërshtim eventual drejtpërdrejt në KPK. Raporti i komisionit përmban arsytimit të detajuar lidhur me gjithë procesin përfshirë notën në vlerësim të performancës. Mirëpo, këto arsytetime dhe raporte nuk publikohen pasi që të dhënat që kanë të bëjnë me vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe nivelin me të cilin janë vlerësuar janë të mbyllura për publikun. ²⁰
16	Përforcimi i mekanizmit për analizimin e vlerësimeve të performancës me qëllim të identifikimit të nevojave specifike për trajnim të gjyqtarëve	2021	KGJK, AD	Rekomandimet e Komisionit për vlerësimin e performancës për trajnime të zbatuara në tërësi	KGJK ka miratuar Planin e veprimit për trajnime të gjyqtarëve për vitin 2024, ku ne rast se Komisioni për Vlerësimin e Performances identifikon nevojën specifike për trajnim të gjyqtarëve ky trajnim do të organizohet konform këtij plani. ²¹
17	Përforcimi i mekanizmit për analizimin e vlerësimeve të performancës me qëllim të identifikimit të nevojave specifike për trajnim të prokurorëve	2021	KPK, AD	Rekomandimet e Komisionit për vlerësimin e performancës për trajnime të zbatuara në tërësi	KPK harton dokumentin e politikave të trajnimit në të cilin Komisioni për Vlerësimin e Performances jep inputin e tij dhe pastaj ky dokument përcjellet tek Akademia e Drejtësisë. Për çdo vendim kur ndaj një prokurori është dhënë vlerësimi i pamjaftueshëm, i njejtë dërgohet për trajnim të detyrueshëm në Akademinë e Drejtësisë. Në vendim, janë të specifikuar fushat dhe modulet në të cilat prokurori duhet të trajnohet. Lidhur me këtë çështje KPK ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me Akademinë e Drejtësisë si dhe janë hartuar protokollat për zbatim të këtij Memoradumi të cilat veq kanë gjetur zbatim në një rast ku kemi derguar një prokurorë në trajnim të detyrueshëm me propozim të Komisionit për vlerësimin e performances.
18	Hartimi i programeve të trajnimit për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të performancës në bazë të nevojave	2021	AD, KGJK, KPK	Programi i miratuar	Programi i miratuar është përbushur në tërësi edhe përtej planifikimit. Meqë ka pasur edhe trajnime shtesë si rezultat i kërkesave të reja për risitë e Kodit të procedurës penale, në fushën e dhunës në familje, për hetimin dhe rikuperimin e asetëve etj. të cilat kryesisht janë mbështetur me donatorë dhe që të njejtat janë miratuar nga autoriteti kompetent i AD-së.
19	Ofrimi i trajnimeve për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të performancës	2021 - 2023	AD, KGJK, KPK	Trajnimet e mbajtura për anëtarët e komisioneve	Në bashkëpunim me Iniciativën e Chemonics për Sundim të Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI), financuar nga Mbretëria e Bashkuar është realizuar me 18 dhe 19 dhjetor trajnimi dy ditor veçmas, për anëtarët e Komisioneve të KGJK-së dhe KPK-së të cilët kanë mandatin për vlerësimin e performances së

¹⁸ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/75040_Raport_vjetor_i_KVPGJ_2023.pdf

¹⁹ <https://www.gjyqesori-rks.org/regullore/?r=M&legld=296>

²⁰ <https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/6.pdf>

[https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/34\(1\).pdf](https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/34(1).pdf)

[https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/23\(2\).pdf](https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/23(2).pdf)

²¹ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/21071_KGJK_Plani_veprimit_per_trajnimin_gjyqtareve_2024.pdf

					gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjatë këtyre trajnimeve janë trajtuar aspekte të rëndësishme të punës së këtyre komisioneve duke përfshirë indikatorët matës dhe problemet praktike në zbatim të rregulloreve për vlerësim të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Përveq anëtarëve të Komisioneve për vlerësimin e performancës, këtë trajnim e vijuan edhe Kryesuesi i KGJK-së dhe KPK-së, Kryetari i Gjykatës Supreme, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, Kryetarë të Gjykatave dhe Kryeprokurorë, Gjyqtarë nga Gjykata Supreme, Inspektorë të lartë Gjyqësorë, zyrtarë të statistikave, anëtarë të Komisioneve të përhershme në KPK, Udhëheqës të Departamenteve të Trajnimeve dhe të IT, si dhe zyrtarë ligjorë.
Masa e politikës: Raportim me cilësi të lartë për të përmirësuar llogaridhënien					86% zbatuar plotësisht
20	Kryetarët e Gjykatave zbatojnë udhëzimet dhe shabllonët për raportim nga kryetarët	2021	KGJK	Raportimi në Këshill bëhet në përputhje me udhëzimet dhe shabllonet	Raportimi i Kryetarëve gjatë vitit 2021 dhe në vazhdimësi po bëhet sipas udhëzimeve dhe shablloneve për raportim. Raportimi i Kryetarëve është transmetuar edhe online. Përtej shablloneve, Kryetarët përgjigjen drejtpërdrejtë edhe në pyetjet shpesh të parashtruara nga anëtarët e Këshillit.
21	Vendosja e udhëzimeve dhe shabllonëve për raportim nga kryeprokurorët	2021	KPK	Udhëzimet dhe shabllonet për raportim më të mirë janë hartuar, miratuar dhe ofruar për prokurorët	Janë krijuar format e reja të unifikuara si mekanizëm i raportimit të kryeprokurorëve të cilat janë vënë në funksion gjatë raportimit të kryeprokurorëve gjatë vitit 2021 dhe të cilët vazhdojnë të përdoren.
22	Publikimi i raporteve të detajuara mbi proceset e rekrutimit, të cilat përmbajnë informata të detajuara mbi gjithë procesin e rekrutimit dhe mbarëvajtjen e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	2021	KGJK	Raportet e rregullta të gjykatave janë dorëzuar me kohë; Publiku ka qasje në informata mbi proceset e rekrutimit, duke përfshirë shpalljen e vendeve të lira të punës, listën e aplikantëve dhe rezultatet e rekrutimit	KGJK ka shpallur konkurs për 47 pozita për gjyqtarë në nivel të Gjykatave themelore dhe Gjykatën Komerciale - dhomat e shkallës së parë, prej të cilave pesë (5) pozita të gjyqtarëve të rezervuara për komunitetin serb. Konkursi dhe procedurat tjera janë publikuar në uefaqen e KGJK-së. Linku më poshtë. KGJK ka publikuar te gjitha raportet e detajuar mbi procesin e rekrutimit. ²²
23	Publikimi i raporteve të detajuara mbi proceset e rekrutimit, të cilat përmbajnë informata të detajuara mbi gjithë procesin e rekrutimit dhe mbarëvajtjen e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	2021	KPK	Raportet e rregullta të prokurorëve janë dorëzuar me kohë; Publiku ka qasje në informata mbi proceset e rekrutimit, duke përfshirë shpalljen e vendeve të lira të punës, listën e aplikantëve dhe rezultatet e rekrutimit	Në periudhën raportuese nuk ka pasur procese të reja të rekrutimit.
24	Përgatitja dhe publikimi i raporteve tremujore nga të gjithë kryetarët e gjykatave dhe raportet vjetore të KGJK, të cilat përmbajnë edhe informata mbi procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve	2021	Kryetarët e Gjykatave, KGJK	Raportet tremujore të gjykatave janë dorëzuar me kohe dhe jane publike; Raportet vjetore përmbajnë informata të përmbledhura, por të qarta për procedurat disiplinore që janë zhvilluar kundër gjyqtarëve	Gjykata kanë dorëzuar dhe raportuar me kohë në Këshill për raportet e punës të njëjtat janë publike dhe mund të gjenden tek raporti i punës në rubrikën publikimet tek secila gjykatë. 1.Gjykata Supreme: https://supreme.gjyqesori-rks.org/publikimet/raporti-i-punes/ 2.Gjykata e Apelit: https://apeli.gjyqesori-rks.org/publikimet/raporti-i-punes/ 3.Gjykata Komerciale: https://komerciale.gjyqesori-rks.org/raporti-i-punes/ 4.Gjykata Themelore ne Prishtine: https://prishtine.gjyqesori-rks.org/publikimet/raporti-i-punes/ 5.Gjykata Themelore ne Mitrovicë: https://mitrovicë.gjyqesori-rks.org/publikimet/raporti-i-punes/ 6.Gjykata Themelore ne Peje: https://peje.gjyqesori-rks.org/publikimet/raporti-i-punes/ 7.Gjykata Themelore ne Prizren: https://prizren.gjyqesori-rks.org/publikimet/raporti-i-punes/ 8.Gjykata Themelore ne Ferizaj: https://ferizaj.gjyqesori-rks.org/publikimet/raporti-i-punes/?cYear=2023 9.Gjykata Themelore në Gjilan : https://gjilan.gjyqesori-rks.org/publikimet/raporti-i-punes/

²² <https://www.gjyqesori-rks.org/raportet/?cYear=2023>

					10:Gjykata Themelore ne Gjakove: https://gjakove.gjyqesori-rks.org/publikimet/raporti-i-punes/ KGJK publikon vendimet e anonimizuara për rastet disiplinore të gjyqtarëve dhe statistika tremujore për ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve ne nivel të Kosovës ²³
25	Përgatitja dhe publikimi i raporteve tremujore nga të gjithë kryeprokurorët dhe raportet vjetore të KPK, të cilat përmbajnë edhe informata mbi procedurat disiplinore kundër prokurorëve	2021	Kryeprokurorët, KPK	Raportet tremujore të prokurorive janë dorëzuar me kohe dhe janë publike; Raportet vjetore përmbajnë informata të përmbledhura, por të qarta për procedurat disiplinore që janë zhvilluar kundër prokurorëve	Kryeprokurorët raportojnë në baza 3 mujore në KPK përmes mekanizmit të harmonizuar të raportimit të Kryeprokurorëve në takime të hapura të Këshillit. Raportimet e kryeprokurorëve përmbajnë të dhëna edhe për rastet disiplinore që kryeprokurorët trajtojnë gjatë periudhës raportuese. Te gjitha raportet 3 mujore të mekanizmit të raportimit të kryeprokurorëve janë publikuar në uebportal. ²⁴ Po ashtu, në fund të vitit kryeprokurorët raportojnë për tërë vitin, raporte të cilat përfshihen në Raportin vjetor të Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të cilat bëhen publike dhe të qasshme në ueb portalin e sistemit prokurorial. Po ashtu, KPK në baza vjetore harton dhe publikon Raportin vjetor të punës së KPK i cili po ashtu është i qasshëm në ueb portal dhe i njëjti përfshinë dhe procedurat disiplinore ndaj prokurorëve. Për më tepër, sa i përket procedurave disiplinore ndaj prokurorëve KPK ka një pjesë të vecantë në uebportal të dedikuar vetëm për publikimin e të dhënave sa i përket këtyre procedurave. ²⁵
26	Diskutimi i rregullt i raporteve vjetore nga KGJK dhe KPK në Kuvendin e Kosovës	2021 - 2023	Kuvendi	Raportet e KGJK dhe KPK të diskutuara në Kuvend	Nuk janë diskutuar raportet e KGJK dhe KPK-së.
<i>Masa e politikës: Ushtrim efektiv i mandateve gjyqësore dhe prokuroriale që sigurojnë llogaridhënie</i>					70% zbatuar plotësisht
27	Hartimi i Kodit të Procedurës Penale dhe legjislacionit përcjellës për të lejuar mjetet juridike ndaj vendimit të prokurorit për pushim të ndjekjes penale	2021	MD	Kodi i miratuar	Kodi i Procedurës Penale është miratuar nga Kuvendi me datë 14.07.2022. ²⁶ Neni 156(8) shprehimisht parasheh të drejtën e të dëmtuarit ose viktimës për ankesë kundër aktvendimit për pushimin e hetimit në Prokurorinë e Apelit, përmes prokurorisë themelore.
28	Miratimi i udhëzimeve nga KGJK në mjediset ku zhvillohen seancat dëgjimore, për të siguruar mbajtjen e seancave gjyqësore në sallën e gjykimeve në vend të zyrave të gjyqtarëve, veçanërisht në rastet e profilit të lartë	2021	KGJK, Kryetarët e Gjykatave, Gjyqtarët	Seancat gjyqësore mbahen në sallë të gjykimeve	Te gjitha rastet e profileve të larta, seancat mbahen në sallë të gjykimeve. Ky fakt dëshmohej edhe përmes raportimeve të organizatave që mbulojnë dhe përcjellin gjykimet në këtë lëmi.
29	Plotësim-ndryshimi i Rregullores për Organizimin e brendshëm të Gjykatave për të siguruar harmonizimin e saj me Rregulloren e re për Avansim, përkritazi me kushtet që duhet plotësuar gjyqtari para avancimit/transferimit në mënyrë që të evitohet nevoja për rifillim të lëndës pas avancimit/transferimit	2022	KGJK	Rregullorja e miratuar	KGJK ka miratuar Udhëzuesin për mënyren e shpërndarjes automatike të lëndëve dhe implementuar në gjykata. Ketu është përfshirë edhe çështja e shpërndarjes së lëndëve pas avancimit të gjyqtarëve. KGJK ka miratuar Rregulloren Nr.04/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.01/2014 për procedurën e ngritjes në detyrë të Gjyqtarëve, KGJK gjatë intervistimit merr gjithmonë parasysh ngarkesën e gjyqtarëve.

²³ <https://www.gjyqesori-rks.org/vendimet-e-komisionit-disiplinor/?r=M&tabld=1>; <https://www.gjyqesori-rks.org/vendimet-e-komisionit-disiplinor/?r=M&tabld=0>

²⁴ <https://www.prokuroria-rks.org/kpk/dokumente-publikime/84/89/649/649/>

²⁵ <https://www.prokuroria-rks.org/disciplina-vlersimi/624/638/>

²⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>

30	KGJK siguron zbatimin e kritereve ligjore për transferimin dhe avancimin e gjyqtarëve dhe raportin mbi to, në mënyrë që të përmirësohen praktikatat e promovimeve të gjyqtarëve përmes transfereve	2021 - 2023	KGJK	Kritereve ligjore për transfer dhe avancim të gjyqtarëve respektohen plotësisht	KGJK ka zbatuar plotësisht kriteret për rastin e transferimit dhe avancimit të gjyqtarëve, të cilat janë adresuar përmes rregulloreve aktuale. Gjatë kësaj periudhë kohore KGJK duke u bazuar në kriteret përcaktuar me rregulloren për transferim ka transferuar 3 gjyqtar ndërsa kërkesa për transferim ju është refuzuar 11 gjyqtarëve. Gjatë kësaj periudhë kohore KGJK sipas konkursit të brendshëm të shpallur ka propozuar tek presidenti i Republikës së Kosovës kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, ka avancuar tre gjyqtar në Gjykatën e Apelit, Tre gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, tre gjyqtar në Departamentin Special dhe dy gjyqtar mbikëqyrës njeri në Gjykatën Themelore dega në Fushe Kosovës dhe një në degën e Garancisë.
31	KPK monitoron nga afër zbatimin e kritereve ligjore për transferimin dhe avancimin e prokurorëve dhe raportin mbi to, në mënyrë që të përmirësohen praktikatat e promovimeve të prokurorëve përmes transfereve	2021 - 2023	KPK	Kritereve ligjore për transfer dhe avancim të prokurorëve respektohen plotësisht	Duke u bazuar në Rregulloren Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e prokurorëve të Shtetit, në çdo rast KPK respekton dhe zbaton kriteret dhe procedurat për transferim dhe avancim të prokurorëve të shtetit. Kjo Rregullore që ka hyrë në fuqi gjatë vitit 2021, paraqet fuqizim të proceseve të avancimit dhe transferimit të prokurorëve. Për më tepër, KPK ka miratuar edhe Udhëzuesin për zbatimin e Rregullores për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit. ²⁷ KPK po ashtu është pjesë e grupeve punuese në kuadër të deklaratës së përbashkët për reformën në drejtësi ku objektive e veçante është edhe transferimi dhe avancimi i prokurorëve.
32	KGJK monitoron nga afër angazhimet e jashtme të gjyqtarëve si dhe kompensimet për t'u siguruar zbatimin e kriterit ligjor që të ardhurat e gjyqtarëve nga angazhimet e jashtme nuk tejkalojnë 25% të pagave të tyre bazë	2021 - 2023	KGJK, Kryetarët e Gjykatave	Raportet vjetore të monitorimit nga KGJK nuk regjistrojnë shkelje të këtij kriteri ligjor	KGJK monitoron rregullisht angazhimin e jashtëm të gjyqtarëve dhe aktualisht eidenton se janë 5 gjyqtarë me angazhime të jashtme, të cilët nuk e tejkalojnë 25% të pagave të tyre bazë. Kjo çështje pasqyrohet edhe në deklaratimet e pasurisë që bëjnë këta gjyqtarë.
33	KPK monitorojnë nga afër angazhimet e jashtme të prokurorëve si dhe kompensimet për t'u siguruar zbatimin e kriterit ligjor që të ardhurat e prokurorëve nga angazhimet e jashtme nuk tejkalojnë 25% të pagave të tyre bazë	2021 - 2023	KPK, Kryeprokurorët	Raportet vjetore të monitorimit nga KPK nuk regjistrojnë shkelje të këtij kriteri ligjor	Në të gjitha rastet KPK zbaton kriterin ligjor nga Ligji për Prokurorin e Shtetit, ku ndalohej që të ardhurat e prokurorëve nga angazhimet e jashtme të tejkalojnë 25% të pagës së tyre bazë. Kjo mund të verifikohet edhe nga deklarimi i pasurisë së prokurorëve. Prokurori me aprovimin e Kryeprokurorit të prokurorisë dhe Kryeprokurorët e prokurorisë me aprovim të Këshillit, vetëm jashtë orarit të punës, marrin pjesë në veprimtari të cilat janë në përputhje me Kodin e Etikës dhe sjelljen profesionale të prokurorëve. Gjatë vitit 2023, rreth 22 prokurorë kanë qene te angazhuar me veprimtari profesionale, perfshire ligjirimin ne Akademinë e Drejtësisë.
34	MD, KGJK dhe KPK kryejnë vlerësime të rregullta të efekteve të komizës normative që rregullon KGJK, KPK, gjykatat, prokuroritë mbi pavarësinë reale dhe të perceptuar të këtyre organeve nga çdo ndikim i padrejtë	2021-2023	MD, KGJK, KPK	Vlerësimet e bëra në baza vjetore	Me qëllim të harmonizimit dhe përditësimit të akteve nënligjore dhe përshtatjes me ndryshimet e reja eventuale ligjore dhe strukturore, Këshilli, përmes mekanizmave të vet, ka planifikuar të bëjë analizën e zbatimit të akteve nënligjore në fuqi. Si rezultat, Komisioni për Çështje Normative hartuar një pyetësor me pyetje lidhur me aktet nënligjore që janë në fuqi dhe ka zhvilluar vizita nëpër të gjitha prokuroritë e Republikës së Kosovës ku ka marrë përgjigjet nga Kryeprokurorët lidhur me këtë çështje. Si rezultat i këtyre vizitave, Komisioni ka hartuar raport me të gjetura dhe rekomandime.
35	KGJK kryen një shqyrtim sistematik dhe të pavarur të praktikave të punës së gjykatave në nivele të ndryshme për të identifikuar llojet e rreziqeve që ndikojnë në llogaridhënie, duke marrë në konsideratë kontekstet e ndryshme në të cilat punojnë gjykatat dhe variacionet e mundshme në sfidat specifike për shkak të nivelit të gjykatave dhe vendndodhjes së tyre	2021 - 2023	KGJK	Shqyrtimet sistematike të kryera	KGJK bazuar në legjislaicionin në fuqi dhe konform Planit të Punës, në vazhdimësi përmes Njësish për Inspektim Gjyqësor zhvillon procese audituese me të cilat adresohen çështjet me rëndësi. Gjatë kësaj periudhë kohore kjo Njese ka bere Inspektime me temat si ne vijim: Inspektimi, rastet "Kobra" Gjykata Themelore në Prizren, Raporti është përfunduar me 25.01.2023; ²⁸ Inspektimi, "Rishikimi i faktorit kohorë në dërgim/pranimin e lëndëve gjyqësore sipas kompetencës lëndore dhe territoriale", Raporti është përfunduar me 17.03.2023; Inspektimi, "Arsyet e parashkrimit të dënimit me burgim, dënimit me gjobë në penale dhe dënimit me gjobë në kundërvajtje", Raporti është përfunduar me 02.05.2023; Inspektimit – "Zvarritjet e drejtësisë për zbardhjen e krimit mbi adoleshentët; Inspektimi / Raporti inspektues " A. P. (italiani)".

²⁷ <https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Udhe%CC%88zues%20pe%CC%88r%20zbatimin%20e%20Rregullores%20pe%CC%88r%20Transferimin%20dhe%20Avancimin%20e%20Prokurore%CC%88ve%20te%CC%88%20Shtetit%2C%20nr.1104.2022.pdf>

²⁸ [35720_KGJK_Raport_INSPEKTIMI_RASTET_PENALE_KOBRA.pdf \(gjyqesori-rks.org\)](#)

36	KPK kryejnë një shqyrtim sistematik dhe të pavarur të praktikave të punës së prokurorive në nivele të ndryshme për të identifikuar llojet e rreziqeve që ndikojnë në llogaridhënie, duke marrë në konsideratë kontekstet e ndryshme në të cilat punojnë prokurorët dhe variacionet e mundshme në sfidat specifike për shkak të nivelit të prokurorive dhe vendndodhjes së tyre	2021 - 2023	KPK	Shqyrtimet sistematike te kryera	<p>Komisioni për administrimin e prokurorive është kompetent për shqyrtimin sistematik të praktikave të punës së të gjitha prokurorive. Gjatë vitit 2023 Komisioni ka mbajtur takime mujore, vizita neper prokurori dhe ka organizuar 2 punetori me perkraheje te projektit EUKOJUST. Në fillim të vitit 2023, Komisioni ka organizuar punëtori 2 ditore për hartimin e raportit vjetor të Komisionit 2022 dhe Planit të punës 2023. Këto 2 dokumente janë hartuar në bashkëpunim me njësitë relevante të Sekretariatit dhe prokurorive në mënyrë që të pasqyrohen nevojat e sistemit prokurorial.</p> <p>Me 14 mars 2023 Komisioni ka themeluar grupin punues për monitorimin e zbatimit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) në prokuroritë e Republikës së Kosovës përmes së cilit kemi caktuar zyrtarët që janë mbikëqyrës nëpër prokurori sipas regjioneve. Ky grup punues ka mbajtur takime online me të gjithë administratorët dhe ka realizuar vizita në Prokurorinë e Apelit, PTH Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren. Bazuar në këto janë përgatitur raportet për secilën prokurori që përmbajnë informatat lidhur me krahasimin e raportit manual me raportin e SMIL-it. Problemet apo sfidat që janë identifikuar nga mbikëqyrësit përkatës të prokurorive në kuadër të këtij grupi punues, i janë dërguar secilit administrator. Në korrik 2023 është mbajtur punetori për trajtimin e ketyre raporteve për SMIL, infrastrukturen e prokurorive, sigurine dhe burimet njerezore.</p> <p>Gjatë muajit shtator 2023 Komisioni ka mbajtur takim me Drejtorinë e Policisë Rajonale në Prishtinë me qëllim të avancimit të përdorimit të SMIL-it. Po ashtu, është mbajtur takim i përbashkët me Komisionin për Administrimin e Gjykatave. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i detajuar i sfidave që janë duke u shfaqur gjatë procesit të punës së prokurorëve dhe gjyqtarëve në SMIL dhe intensifikimi i angazhimit të përbashkët të këtyre dy komisioneve për lehtësimin e veprimtarisë së punës në këtë projekt madhor të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Me propozimin e Komisionit, KPK ka themeluar grupin e përdoruesve të SMIL-it që perbehet nga prokurorë të të gjitha niveleve të sistemit prokurorial. në KPK, si dhe aktivitetet e tij janë të përfshira në mënyrë specifike në Raportin vjetor të Këshillit.</p>
<i>Masa e politikës: Platformë e qëndrueshme disiplinore për sigurimin e llogaridhënies</i>					83% zbatuar plotësisht
37	KGJK krijon një mekanizëm përcjellës elektronik që regjistron ankesat për shkelje të rregullave disiplinore, veprimet e ndërmarra dhe progresin përgjatë fazës së hetimit	2022	KGJK	Mekanizmi i krijuar dhe funksional	Mekanizmi përcjellës elektronik për regjistrimin e ankesave për shkeljet disiplinore është krijuar dhe zyrtari përkatës në KGJK është duke u futur te dhënat e procedurës ku shënohen te gjitha hetimet disiplinore dhe sanksionet ndaj një gjyqtari. Për shkak konfidencialitetit, në këto të dhëna dhe regjistër ka qasje vetëm zyrtari përkatës i lartpërmendur.
38	Trajnime për Ligjin e ri për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve	2021	AD, KPK	Trajnimet për prokurorë të mbajtura	Akademia e Drejtësisë, gjatë vitit 2021, ka realizuar tre trajnime ²⁹ për Etkën profesionale dhe Ligjin për përgjegjësinë disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorë. Kanë marr pjesë 75 prokuror. Përfitues të këtyre trajnimeve kanë qenë prokuror nga zyra e Kryeprokurorit të shtetit, PSRK, Apelit dhe nivelit themelor.
39	KGJK ndërmerr fushatata të vazhdueshme mediale dhe informative për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për sistemin e ri ligjor të përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve	2021-2023	KGJK	Fushata mediale të realizuara, materiale informative të vendosura në kutitë e ankesave në ndërtesat e gjykatave Informata në gjuhën e rëndomtë janë vendosur në faqet përkatëse të internetit	Me qëllim të ngritjes se vetëdijimit të qytetarëve, KGJK me mbështetjen e Projektit për Drejtësi-USAID, ka shpërndarë në të gjitha gjykatat dhe degët poster informativ me informacion për procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve. Në këto postera janë përshkruar hapat konkretë për paraqitjen e një ankesë disiplinore kundër një gjyqtari dhe bazën ligjore pse qytetarët mund të bëjnë këtë ankesë. Posterët janë vendosur kryesisht në hyrje të objekteve të gjykatave, duke pasur parasysh që është pjesë e qasme nga qytetarët. Po ashtu permes linkut ne ueb faqe të KGJK-se mund te gjejne formën e ankesës dhe legjislacionin ne fuqi. ³⁰
40	KPK ndërmerr fushatata të vazhdueshme mediale dhe informative për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për sistemin e ri ligjor të përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve	2021-2023	KPK	Fushata mediale të realizuara , materiale informative të vendosura në kutitë e ankesave në ndërtesat e prokurorive Informata në gjuhën e rëndomtë janë vendosur në faqet përkatëse të internetit	Nuk ka pasur kampanja gjate periudhes raportuese

²⁹ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2021/Details/8285>

<https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2021/Details/8315>

³⁰ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lqsl/LIGJI_NR_06_L-057_P%C3%8BR_P%C3%8BRGJEGJ%C3%8BSIN%C3%8B_DISIPLINORE_T%C3%8B_GJYQTAR%C3%8BVE_DHE_PROKUROR%C3%8BVE.pdf

Rregullorja: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lqsl/6651_Rregullorja%2005-2019.pdf ; ankesa: <http://prishtine.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/sites/5/2019/06/Formolari-i-ankes%C3%ABs-p%C3%AB-gjyqtar-dhe-prokuror-n%C3%AB-2019.doc>

					Në ueportalin e sistemit prokurorial e kemi të publikuar ligjin për përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve dhe gjyqtarëve si dhe rregulloren përkatëse ku janë të përcaktuara qartë procedurat për parashkrimin e ankesave ndaj prokurorëve. ³¹
41	KGJK vlerëson efektivitetin e sistemit të ri të përgjegjësisë disiplinore së gjyqtarëve pas një periudhe zbatimi një vjeçar, dhe propozon masat korrigjuese për autoritetet përkatëse, sipas rasisit	2022	KGJK	Vlerësimi i realizuar; masat korrigjuese te propozuara	Ky aktivitet është përfunduar dhe janë dhëne sqarime edhe ne raportimin për vlerësimin 1 vjeçar.
42	KPK vlerëson efektivitetin e sistemit të ri të përgjegjësisë disiplinore së prokurorëve pas një periudhe zbatimi një vjeçar, dhe propozon masat korrigjuese për autoritetet përkatëse, sipas rasisit	2022	KPK	Vlerësimi i realizuar; masat korrigjuese te propozuara	KPK është pjesë e grupit punues të udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë, për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji dhe në atë grup është duke i ofruar vlerësimet e saj të bëra të sistemit disiplinor. Po ashtu, KPK eshte pjese e grupeve punuese per reformen ne drejtesi ne kuader te deklarates se perbashket ku nje nder grupet kryesore eshte ai per procedurat disiplinore.
Masa e politikës: Mekanizma efikas të informimit publik që japin qasje të shpejtë dhe të saktë në informata					62.5% zbatuar plotësisht
43	KGJK miraton udhëzime dhe procedura për trajtimin e kërkesave sa i përket qasjes në dokumente publike, përfshirë këtu vendimet gjyqësore dhe aktakuzat	2022	KGJK	Procedurat e qasjes së publikut në vendimet gjyqësore, aktakuzat, dhe dokumentet e tjera janë të qarta dhe publikisht të disponueshme	KGJK ka miratuar rregulloren për Qasje ne Dokumente publike me te cilën ka zgjidhur të gjitha dilemat sa i perket qasjes ne dokumete publike. KGJK ne rregullore ka adresuar te gjitha çështjet lidhur me këtë aktivitet. ³² Gjithashtu ka caktuar edhe zyrtaret kompetent qe merren me këtë çështje.
44	KPK miraton udhëzime dhe procedura për trajtimin e kërkesave sa i përket qasjes në dokumente publike, përfshirë këtu vendimet gjyqësore dhe aktakuzat	2022	KPK	Procedurat e qasjes së publikut në vendimet gjyqësore, aktakuzat, dhe dokumentet e tjera janë të qarta dhe publikisht të disponueshme	KPK-ja ka miratuar Rregulloren për Qasje në Dokumente Publike, e cila do të lehtësojë aspektin procedural të qasjes në dokumente publike të sistemit prokurorial. Miratimi I kësaj rregulloreje është bërë më datën 22.12.2023. ³³ KPK-ja është në proces të përgatitjes dhe hartimit të shtojcave për zbatimin e Rregullos nr.06.2023 për Qasje në Dokumente Publike, në kuadër të cilave hyjnë: vendimi për lejinim e qasjes në dokumente publike, vendimi për lejinim pjesërisht të qasjes në dokumente publike, vendimi për refuzimin e qasjes në dokumente publike dhe formularët e kërkesave për qasje në dokumente publike në tërë institucionet e sistemit prokurorial. KPK ka të publikuar formën e kërkesës për qasje në dokumente publike ³⁴ në ueb portal si dhe emrin e personit përgjegjës brenda sistemit prokurorial për qasje në dokument publike të cilit mund t'i drejtohen me kërkesat që palët mund të kenë. Qasja në Aktakuza është rregulluar me Nenin 237 të Kodit të ri të Procedurës Penale. ³⁵ Për më tepër, bazuar në vendimet e Agjencisë për informim dhe privatësi, KPK ka ofruar qasje në aktvendimet për hudhjen e kallëzimeve penale dhe aktvendimet për pushimin e hetimeve.

³¹ <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/16.pdf>

<https://prokuroria-rks.org/al/diplina-vlersimi/624/638/>

³² https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/43105_Rregullore_Nr_02_2023_per_qasje_ne_Dokumente_Publike.pdf

³³ [https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fprokuroria-rks.org%2Fassets%2Fcms%2Fuploads%2Ffiles%2FDrafti%2520i%2520Rregullores%2520p%2520p%2520Qasje%2520ne%2520Dokumente%2520Publike%2520t%2520%2520K%2520%2520shillit%2520Prokurorial%2520%2520Kosov%2520Kosov%2520dhe%2520Prokurorit%2520t%2520%2520Shtetit%2520t%2520%2520Republik%2520s%2520s%2520%2520Kosov%2520Kosov\(1\).docx&wdOrigin=BROWSELINK](https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fprokuroria-rks.org%2Fassets%2Fcms%2Fuploads%2Ffiles%2FDrafti%2520i%2520Rregullores%2520p%2520p%2520Qasje%2520ne%2520Dokumente%2520Publike%2520t%2520%2520K%2520%2520shillit%2520Prokurorial%2520%2520Kosov%2520Kosov%2520dhe%2520Prokurorit%2520t%2520%2520Shtetit%2520t%2520%2520Republik%2520s%2520s%2520%2520Kosov%2520Kosov(1).docx&wdOrigin=BROWSELINK)

³⁴ <https://prokuroria-rks.org/transparenca/188/191/>

³⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

45	Hartimi i udhëzimeve për procedurat për trajtimin e kërkesave sa i përket qasjes në dokumente publike	2022	KPK	Procedurat e qasjes së publikut në dokumentet relevante janë të qarta dhe publikisht të disponueshme	KPK-ja ka miratuar Rregulloren për Qasje në Dokumente Publike, e cila do të lehtësojë aspektin procedural të qasjes në dokumente publike të sistemit prokurorial. Miratimi I kësaj rregulloreje është bërë më datën 22.12.2023. ³⁶ KPK-ja është në proces të përgatitjes dhe hartimit të shtojcave për zbatimin e Rregullores nr.06.2023 për Qasje në Dokumente Publike, në kuadër të cilave hyjnë: vendimi për lejimin e qasjes në dokumente publike, vendimi për lejimin pjesërisht të qasjes në dokumente publike, vendimi për refuzimin e qasjes në dokumente publike dhe formularët e kërkesave për qasje në dokumente publike në tërë institucionet e sistemit prokurorial. KPK ka të publikuar formën e kërkesës për qasje në dokumente publike ³⁷ në ueb portal si dhe emrin e personit përgjegjës brenda sistemit prokurorial për qasje në dokument publike të cilit mund t'i drejtohen me kërkesat që palët mund të kenë. Qasja në Aktakuza është rregulluar me Nenin 237 të Kodit të ri të Procedurës Penale. ³⁸ Për më tepër, bazuar në vendimet e Agjencisë për informim dhe privatësi, KPK ka ofruar qasje në aktvendimet për hudhjen e kallëzimeve penale dhe aktvendimet për pushimin e hetimeve.
46	KGJK vlerëson kapacitetet e tyre të brendshme për të trajtuar kërkesat për qasje në dokumente publike në përputhje me legjislacionin përkatës për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave	2021	KGJK	Vlerësimet e kryera dhe rekomandimet për masat e nevojshme për rritje të kapacitetit të qarta	KGJK ka vlerësuar kapacitetet e brendshme duke i zgjedhur udhëheqësit e zyrave për informim në KGJK dhe gjykatat e Kosovës, të cilët me vendim të KGJK njëkohësisht janë caktuar zyrtar përgjegjës për qasje në dokumentet publike, gjithashtu ka caktuar edhe zyrtarët përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për mbrojtjen e të dhënave personale.
47	KPK vlerëson kapacitetet e tyre të brendshme për të trajtuar kërkesat për qasje në dokumente publike në përputhje me legjislacionin përkatës për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave	2021	KPK	Vlerësimet e kryera dhe rekomandimet për masat e nevojshme për rritje të kapacitetit të qarta	KPK ka bërë analizën dhe vlerëson se ka kapacitetet e nevojshme për të ofruar qasjen në dokumente publike. Gjithashtu, KPK ka të caktuar personin përgjegjës për qasje në dokumente publike.
48	KGJK ndërmerr masat e rekomanduara nga vlerësimi për të rritur kapacitetet për të përshpejtuar procesin e anonimizimit të vendimeve gjyqësore, me qëllim që të publikohen në internet	2023	KGJK	Kapacitetet e rritura, numri i rritur i vendimeve të publikuara në ueb faqet e gjykatave	Gjykatat kanë rritur kapacitetet me qëllim të rritjes së anonimizimit dhe publikimit të aktgjykimeve ku numri total ka arritur në 142359 aktgjykime të publikuara. Numri i aktgjykimeve të publikuara gjatë vitit 2023 është 40502 vendime, ndërsa gjatë periudhës 2022 35130 vendime. Gjatë vitit 2023 janë publikuar 5372 vendime me shume se gjatë vitit 2022.
49	KGJK vazhdon përditësimin e faqes së internetit me informata thelbësore për publikun, në të dy gjuhët zyrtare përfshirë këtu: vendimet e gjykatave që publikohen menjëherë pas marrjes së tyre; qasje në raporte analitike dhe gjithëpërfshirëse me informata lidhur me proceset e emërimeve, promovimeve, vlerësimeve, procedurave disiplinore, informatave relevante në lidhje me punën dhe aktivitetet e KGJK dhe planet e veprimit, rezultatet e konsultimeve të rregullta ndërmjet KGJK/KPK dhe gjykatave/prokurorive për aktivitetet përcjellëse të çështjeve të identifikuar	2021-2023	KGJK	Ueb faqet funksionale, përmbajnë informatat e këtuja në të dy gjuhët zyrtare dhe janë të lehta për t'u përdorur nga publiku	KGJK në vazhdimësi është duke bërë përditësimin e të dhënave në ueb faqen e saj ku përveç tjerash është duke bërë edhe publikimin e rregullt të vendimeve gjyqësore. Vendimet e Këshillit po publikohen në të dy gjuhët zyrtare dhe po bëhen përpjekje të vazhdueshme për publikimin e të gjitha të dhënave. KGJK ka themeluar zyrtar për informim per gjykata duke rekrutuar edhe udhëheqësit e ketyre zyreve.

³⁶ [https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fprokuroria-rks.org%2Fassets%2Fcms%2Fuploads%2Ffiles%2FDrafti%2520i%2520Rregullores%2520p%25C3%25ABr%2520Qasje%2520ne%2520Dokumente%2520Publike%2520t%25C3%25AB%2520K%25C3%25ABshillit%2520Prokurorial%2520t%25C3%25AB%2520Kosov%25C3%25ABs%2520dhe%2520Prokurorit%2520t%25C3%25AB%2520Shtetit%2520t%25C3%25AB%2520Republik%25C3%25ABs%2520s%25C3%25AB%2520Kosov%25C3%25ABs\(1\).docx&wdOrigin=BROWSELINK](https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fprokuroria-rks.org%2Fassets%2Fcms%2Fuploads%2Ffiles%2FDrafti%2520i%2520Rregullores%2520p%25C3%25ABr%2520Qasje%2520ne%2520Dokumente%2520Publike%2520t%25C3%25AB%2520K%25C3%25ABshillit%2520Prokurorial%2520t%25C3%25AB%2520Kosov%25C3%25ABs%2520dhe%2520Prokurorit%2520t%25C3%25AB%2520Shtetit%2520t%25C3%25AB%2520Republik%25C3%25ABs%2520s%25C3%25AB%2520Kosov%25C3%25ABs(1).docx&wdOrigin=BROWSELINK)

³⁷ <https://prokuroria-rks.org/transparenca/188/191/>

³⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

	përmes mekanizmave të ndryshëm të vlerësimit.				
50	KPK vazhdon përditësimin e faqes së internetit që përmban informata thelbësore për publikun, në të dy gjuhët zyrtare përfshirë këtu: vendimet e prokurorive publikohen menjëherë pas marrjes së tyre; qasje në raporte analitike dhe gjithëpërfshirëse me informata lidhur me proceset e emërimeve, promovimeve, vlerësimeve, procedurave disiplinore, informatave relevante në lidhje me punën dhe aktivitetet e KPK dhe planet e veprimit, përfshirë rezultatet e konsultimeve të rregullta ndërmjet KGJK/KPK dhe gjykatave/prokurorive për aktivitetet përcjellëse të çështjeve të identifikuar përmes mekanizmave të ndryshëm të vlerësimit	2021-2023	KPK	Ueb faqet funksionale, përmbajnë informatat e këtu në të dy gjuhët zyrtare dhe janë të lehta për t'u përdorur nga publiku	<p>KPK-ja me përkrahje nga UNDP, ka punuar në mënyrë intensive për për zhvillimin e uebportalit të ri, i cili pritet të lansohet në pjesën e parë të vitit 2024.</p> <p>Deri në funksionalizimin e plotë të ueb-portalit të ri, në ueb-portalin aktual gjatë kësaj periudhe janë publikuar të gjitha proceset e vlerësimit të performancës, disiplinimit, rekrutimit, transferimit dhe avancimit të prokurorëve, vendimet e KPK-së dhe PSH-së, raportet vjetore, planet e punës dhe raporte tjera analitike, buletinet mujore të KPK-së në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.³⁹ Takimet konsultuese me institucionet tjera publikohen gjithmonë përmes komunikatave, vendimeve të marra apo memorandumëve. Po ashtu në baza ditore bëhet përditësimi i ueb-portalit me informata të reja të cilat i shërbejnë ngritjes së transparencës dhe informimit të qytetarëve. Po ashtu, në baza ditore publikohet raporti 24 orësh i PSH ku paraqiten vendimet e prokurorive brenda 24 orëve sa i përket ngritjes së aktakuzave, pranimit e kallëzimeve penale, ndalimit, etj. Të gjitha draftet e akteve nënligjore publikohen për konsultim publik para vendosjes së tyre për votim në KPK.</p> <p>Më 4 shtator 2023 është lansuar edhe rrjeti social i Facebook-ut dhe kanali Youtube për sistemin prokurorial, të financuara nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, duke realizuar transmetimin live për publikun të takimeve të Këshillit</p> <p>Takimet konsultuese me institucionet tjera publikohen gjithmonë përmes komunikatave, vendimeve të marra apo memorandumëve.</p> <p>Të gjitha draftet e akteve nënligjore publikohen për konsultim publik para vendosjes së tyre për votim në KPK.⁴⁰</p>
51	KGJK siguron transmetim të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të tyre të rregullta	2021	KGJK	Mbledhjet transmetohen drejtpërdrejtë në ueb faqet e KGJK	KGJK me vendim ka paraparë transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të saj. Po ashtu edhe mbledhjet e Asamblesë së kryetarëve të gjykatave transmetohet drejtpërdrejtë. Ky aktivitet është duke u zbatuar në mënyrë të rregullt.
52	KPK siguron transmetim të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të tyre të rregullta	2021	KPK	Mbledhjet transmetohen drejtpërdrejtë në ueb faqet e KPK	<p>Ky aktivitet është paraparë edhe në planin Strategjik të Sistemit Prokurorial 2022-2024. Për ta realizuar këtë aktivitet KPK është në pritje të funksionalizimit të uebportalit të ri. Në faqen zyrtare në Facebook, KPK është duke transmetuar drejtpërdrejtë takimet.⁴¹</p> <p>Po ashtu, takimet e KPK-së janë publike dhe ofrohet mundësia e përcjelljes së tyre përmes platformës ZOOM ku linku u dërgohet të gjitha mediave, shoqërisë civile dhe personave tjerë që shprehin interesim, krahas partnerëve ndërkombëtar.</p>
53	Përmirësimi i bazës të të dhënave të publikuara në portalin aktual gjyqësor për të mundësuar të dhëna të lexueshme në sistemin OCR, që lejon gjenerimin e informatave bazuar në fjalë kyçe dhe kritere të identifikueshme	2021	KGJK	Portali i pajisur me informata për seanca gjyqësore, dhe motor kërkimi me karakteristikat e përmendura	KGJK në vazhdimësi ka përmirësuar portalin aktual gjyqësor duke bere te qasshem dhe te lehte gjenerimin e informatave bazuar në fjalë kyçe dhe kritere të identifikueshme. Kjo është bere fale zyrtareve te Departamentit te TIK ne KGJK. Po ashtu Zyra për informim në KGJK është kujdesur që të bej përmirësimin e qasjes së përdoruesve online lidhur me materialet promovionale, se si të përdoren mënyrat e kërkimit në portal (video, postera, broshura, etj.) & Rritja e përdorimit të shërbimeve online duke zbatuar fushata sensibilizuese për shërbimet që mund të qasen në distancë (video, postera, broshura, etj.):
54	Prokurori i Shtetit ofron qasje me kohë për palët e interesuara lidhur me vendimet për pushimin e ndjekjeve penale të rasteve të	2021 - 2023	Prokurori i Shtetit	Vendimet për pushim të ndjekjes penale u dërgohen me kohë palëve të interesuara	Në çdo rast kur pushohet ndjekja penale, palët njoftohen për Vendimin e prokurorit.

³⁹ <https://prokuroria-rks.org/kpk/dokumente-publikime/84/89/649/649/>

⁴⁰ <https://prokuroria-rks.org/degjim-publik>

⁴¹ <https://www.facebook.com/sistemiprokurorial>

	profilit të lartë, në pajtim me legjislacionin në fuqi				
55	KGJK, KPK dhe MD krijojnë një mekanizëm koordinimi dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile, OAK dhe akademinë, për të debatuar mbi praktikën, çështjet, masat për miratim dhe për t'i zbatuar ato	2021 - 2023	KGJK, KPK, MD, OShC, AD, OAK	Takimet e rregullta gjashtë mujore që mbahen me organizatat e shoqërisë civile, odën dhe akademinë	Organi koordinues ndër-institucional i Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe Komiteti Drejtues i Strategjisë shërbejnë për të diskutuar me shoqërinë civile, OAK dhe akademinë çështje të ndryshme për sundimin e ligjit që derivojnë nga kjo Strategji, dhe me gjerë. Po ashtu në kuadër të Deklaratës së përbashkët për reformën në drejtësi dhe planit të veprimit, janë krijuar grupi koordinues dhe grupet punuese bazuar në objektivat e planit të veprimit dhe qe paraqet një mekanizëm mjaft të konsoliduar të bashkëpunimit ndër-institucional.
56	KGJK, KPK dhe MD bashkëpunojnë për të hulumtuar rregullisht zhvillimin e perceptimit të publikut mbi sistemin e drejtësisë, përmes realizimit të anketave me publikun, bizneset dhe profesionistët tjerë	2023	KGJK, KPK, MD	Anketat e rregullta publike me publikun, bizneset dhe profesionistët e tjerë të realizuara dhe gjetjet e publikuara	Nuk ka pasur zhvillim.
57	KPK harton udhëzimet për prokuroritë dhe praninë individuale të prokurorëve në platformat e mediave sociale, për të udhëzuar se si prokuroritë mund të jenë të pranishme në platformat e mediave sociale (lloji i informatave që mund të ndahet publikisht) dhe sjellja e pranueshme publike në internet e prokurorëve	2022	KPK	Udhëzimet e miratuara	Ky aktivitet është paraparë në planin Strategjik të Sistemit Prokurorial 2022-2024. Ky aktivitet është prezantuar në takim koordinues me partnerë zhvillimor (Nëntor 2022) ku është kërkuar përkrahje nga donatorët për realizimin e tij. Ky aktivitet është planifikuar me projektin EUKOJUST. Gjatë periudhës raportuese nuk është ndërmarrë ndonjë aktivitet.
<i>Masa e politikës: Zbatim konsistent i Kodit të Etikës</i>					100% zbatuar plotësisht
58	Akademia e Drejtësisë përditëson programet e trajnimit për etikën për gjyqtarët dhe prokurorët dhe i ofron këto trajnime rregullisht, duke u përqendruar në trajnimet e përbashkëta	2021	AD, KGJK, KPK	Programet e përditësuara	Përveç trajnimeve për prokurorë, Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2021 ka realizuar një trajnim me temën 'Integriteti dhe sjelljet etike' ku kanë marrë pjesë 15 pjesëmarrës: bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor, ndihmës administrator, referentë, sekretarë juridike dhe asistent administrativ. Gjatë vitit 2022 është realizuar edhe një trajnim tjetër për atë temë, ku kanë marrë pjesë 17 pjesëmarrës: bashkëpunëtorë profesional, zyrtar ligjor, ndihmës administrator, referentë, zyrtarë të financave dhe zyrtarë të arkivës. Për periudhën 2021-2022 nuk janë realizuar trajnime për gjyqtarë për Etikën Gjyqësore. Këto trajnime i më parë i kanë vijuar gjithë gjyqtarët prandaj edhe KGJK ka vlerësuar se nuk janë të nevojshme të jenë pjesë përbërëse e Programit trajnues për vitin 2021

Kapitulli 1.2 - Ngritja e efikasitetit e sistemit gjyqësor e prokurorial

	Veprimi	Afati i fundit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Progresi në zbatim
Masa e politikës: Hartimi i një Plani Special për Gjykatën Themelore të Prishtinës					50% zbatuar plotësisht
1	Kryerja e një analize për kapacitetet dhe efikasitetin, duke përfshirë vlerësimin e ngarkesës me raste, lëndët e vjetra dhe shpërndarjen e drejtë të numrit të rasteve tek gjyqtarët, e Gjykatës Themelore në Prishtinë.	2022	KGJK	Analiza e përfunduar	Analiza është përfunduar dhe Raporti është miratuar nga Komisioni për Administrimin e Gjykatave 2. Plani për rishpërndarjen e lëndëve është përgatitur dhe është në proces të implementimit në gjykatë. Me këtë synohet që gjyqtarët të kenë perafersisht nnumër të njëjta të lendeve të vjetra, në mënyrë që të mund të adresohen sa më shpejt lëndët e vjetra dhe me prioritet.
2	Ndryshimi i Ligjit për Gjykatat në mënyrë që të themelohet dhe funksionalizohet një dege e Gjykatës Themelore të Prishtinës në Fushë Kosovë.	2022	MD	Dega e themeluar dhe funksionale	Ligji për Gjykatat është në fuqi dhe Dega e Gjykatës Themelore të Prishtinës në Fushë Kosovë është e rregulluar në këtë Ligin për Gjykatat. ⁴²
3	Ndryshimi i Ligjit për Gjykatat në mënyrë që të fshihen degët e Junikut dhe të Shtimes	2022	MD	Ligji i miratuar	Projektligji për Gjykatat Nr.06/L-054 është paraparë në planin legjislativ 2024 dhe afati për miratim është 28.6.2024 duke u bazuar edhe në "Deklaratën e Perbashket të zotimit".
4	Hartimi i Koncept Dokumentit për nëpunësit civil në administratën e gjykatave dhe prokurorive	2022	MD	Koncept Dokumenti i miratuar	Koncept dokumenti për nëpunësit civil në administratën e gjykatave dhe prokurorive është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 26.07.2023. ⁴³
5	Hartimi i planit një vjeçar dhe tre vjeçar që përmban nevojat për rekrutim dhe trajnim dhe përcakton politika rigorozë dhe transparente afatmesme dhe afatgjata në përcaktimin e numrit të gjyqtarëve, dhe stafit mbështetës për gjykata.	2022	KGJK	Planet e miratuara	Hartimi i planit një vjeçar dhe tre vjeçar që përmban nevojat për rekrutim dhe trajnim dhe përcakton politika rigorozë dhe transparente afatmesme dhe afatgjata në përcaktimin e numrit të gjyqtarëve, dhe stafit mbështetës për gjykata. Keshilli Gjyqësor i Kosovës në mbledhjen e 27 dhjetorit 2023 ka miratuar planin e punës 1 dhe 5 vjeçar, po ashtu në mbedhjen e është miratuar plani i trajnimeve. ⁴⁴

⁴² <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

⁴³ <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41727>

⁴⁴ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/63940_Vendimi_KGJK_se_Nr_553_2023_miratohet_plani_per_gjithshem_punesimit_per_vitin_2024.pdf

https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/70850_Vendimi_KGJK_se_Nr_554_2023_miratohet_Projekt_plani_punesimit_5_vjecar.pdf

https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/95497_Vendimi_KGJK_se_Nr_543_2023_%20Miratohet_plani_veprimit_per_trajnimin_gjyqtareve_2024.pdf

https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/21071_KGJK_Plani_veprimit_per_trajnimin_gjyqtareve_2024.pdf

6	Hartimi i planit një vjeçar dhe tre vjeçar që përmban nevojat për rekrutim dhe trajnim dhe përcakton politika rigoroze dhe transparente afatmesme dhe afatgjata në përcaktimin e numrit të prokurorëve dhe stafit mbështetës për prokurori.	2022	KPK	Planet e miratuara	<p>KPK çdo fund të vitit harton dhe miraton politikat e trajnimit të cilat i dorëzon në Akademinë e Drejtësisë në bazë të të cilave dizajnohen modulet e trajnimit. Per kete periudhe ky dokument është miratuar me datë 22 dhjetor 2023 dhe eshte derguar ne Akademinë e Drejtësisë.</p> <p>KPK gjithashtu përmes Komisionit për Administrimin e Prokurorive me përkrahje të NJSHPP gjate periudhes raportuese ka hartuar analizen me nevojat për numër të prokurorëve të rinj, e cila bazohet në ngarkesën me lëndë, pensionimet dhe lirimet tjera të pozitave të prokurorëve si dhe transferimet dhe avancimet. Kjo analize është dërguar në KPK dhe në bazë të se njëjtes është hapur konkursi për rekrutimin e prokurorëve të rinj.</p> <p>Për më tepër, në planifikimet buxhetore vjetore të Këshillit janë të përcaktuara qartë numri i pozitave të prokurorëve dhe stafit të cilat i kemi të lejuara me buxhet për t'i rekrutuar. Këshilli ka hartuar dhe dorëzuar Kërkesën tone buxhetore për vitin 2024 si dhe parashikimet për vitin 2025 – 2027 ku janë edhe planifikimet për pozitave të prokurorëve dhe staf.</p> <p>Përveç kësaj, Këshilli në baza vjetore harton dhe miraton Planin e Personelit ku janë të parapara të gjitha pozitave të cilat dhe numri i personelit që ka sistemi prokurorial si dhe ato që planifikohen të rekrutohen.</p>
7	Ofrimi i trajnimeve të specializuara për menaxhim dhe udhëheqje për kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët mbikëqyrës kandidatët në pozita drejtuese	2022	AD	2 trajnime të mbajtura brenda vitit	Përveq trajnimit të raportuar në gjashtëmujorin e parë është realizuar edhe një trajnim për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive në tetor me temë: Përmirësimi i efikasitetit të gjykatave në bazë të Instrumenteve dhe indikatorëve të CEPEJ-it për performancë duke i përdorur raportet statistikore të SMIL dhe tabelat. Përfutjes të trajnimit ishin Kryetarët e Gjykatave, Kryeprokurorët, zyrtarët e Departamenteve të IT dhe statistikave në Gjykata dhe Prokurori. ⁴⁵
8	Ofrimi i trajnimeve të specializuara për menaxhim dhe udhëheqje për kryeprokurorët dhe për kandidatët në pozita drejtuese	2022	AD	2 trajnime të mbajtura brenda vitit	Përveq trajnimit të raportuar në gjashtëmujorin e parë është realizuar edhe një trajnim për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive në tetor me temë: Përmirësimi i efikasitetit të gjykatave në bazë të Instrumenteve dhe indikatorëve të CEPEJ-it për performancë duke i përdorur raportet statistikore të SMIL dhe tabelat. Përfutjes të trajnimit ishin Kryetarët e Gjykatave, Kryeprokurorët, zyrtarët e Departamenteve të IT dhe statistikave në Gjykata dhe Prokurori. ⁴⁶
Masa e politikës: Përmirësimi i grumbullimit dhe analizës së të dhënave nga KGJK-ja dhe KPK-ja, gjykatat dhe prokuroritë					50% zbatuar plotësisht
9	Avansimi i modulit statistikor, në kuadër të SMIL, në përputhje me të gjitha kërkesat e CEPEJ	2022	KGJK	Moduli i ri statistikor i zhvilluar; Veçoritë e SMIL në përputhje me modulën e ri statistikor; SMIL mundëson mledhjen, përpunimin dhe publikimin e të gjitha të dhënave që kërkohet nga CEPEJ	Moduli statistikor i zhvilluar është në përputhje me kërkesat e CEPEJ. ⁴⁷
10	Përmirësimi i shablloneve të dokumenteve të planit vjetor të punës për të gjitha prokuroritë dhe sigurimi i transparencës	2021	Prokurori i Shtetit	Shabllonet e reja dhe koherente të planeve të punës të miratuara dhe publike	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në fillim të vitit 2023 e ka përgatitur Planin Vjetor të Punës, në bazë të këtij formati edhe prokuroritë e të gjitha niveleve i përgatisin planet e tyre vjetore të punës. ⁴⁸
11	Zbatimi i vazhdueshëm dhe konsistent i SMIL në mënyrë që raportet të ofrojnë përmbajtje sasiore dhe analitike dhe që publiku të ketë qasje në informata për rolin dhe veprimtarinë e gjykatave dhe prokurorive.	2021 - 2023	KGJK, Kryetarët e Gjykatave, Gjyqtarët, KPK, Kryeprokurorët, Prokurorët	Raportet e KGJK dhe KPK përmbajnë informata të bujshme statistikore dhe analitike	<p>KPK dhe KGJK kane nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për implementimin e Fazës Tranzitore (Fazës së katërt) të projektit Sistemi për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve në gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës e cila financohet nga Qeveria Norvegjeze.</p> <p>KGJK: SMIL është zhvilluar dhe implementuar nga të gjitha Gjykatat. KGJK në vazhdimësi është duke e avancuar atë në kuptim të rritjes së cilësisë së të dhënave që futen në sistem nga përdoruesit. Me rastin e krijimit të Gjykatës Komerciale, SMIL është zhvilluar dhe implementuar edhe në këtë gjykatë.⁴⁹</p>

⁴⁵ : https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/bultetor2023shq_.pdf

⁴⁶ : https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/bultetor2023shq_.pdf

⁴⁷ <https://www.gjyqesori-rks.org/2021/09/08/raportet-statistikore-te-avancuara-sipas-indikatoreve-te-cepej-vendosen-ne-sistemin-smil/>

⁴⁸ <https://shorturl.at/lshNQ>

⁴⁹ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/1682_KGJK_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Vjetori_2023.pdf

				<p>KPK: Implementimi dhe zbatimi i Projektit TIK/SMIL. SMIL është duke zbatuar në të gjitha prokuroritë themelore, Prokuroria Speciale, Prokuroria e Apelit ndërsa në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit nga viti 2023 kemi filluar vënien në zbatim të sistemit.</p> <p>. Deri më tani është implementuar shkëmbimi elektronik me sistemet: Të regjistrimit civil, regjistrimit të bizneseve, Policisë së Kosovës dhe gjykatat ndërsa në proces është Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komisioni për Administrimin e prokurorive ka themeluar Grupin Punues për monitorimin e zbatimit të Sistemit Elektronik për Menaxhimin e rasteve (SMIL) në prokuroritë e Republikës së Kosovës si dhe për ngritjen e nivelit të kualitetit të të dhënave në SMIL. Në gjashtëmujorin e parë janë bërë vizita si dhe janë përgatitur raporte për zbatimin e SMIL për të gjitha Prokurorit Themelore dhe Prokurorinë e Apelit. Është mbajtur punëtorja me temën Prezantimi i raporteve për monitorimin e zbatimit të SMIL. Kjo punëtori është organizuar nga Komisioni për Administrimin e Prokurorive në bashkëpunim me Projektin EUKOJUST dhe pjesëmarrës ishin: Administratorët, Udhëheqësit e shkrimes dhe trajnerët e TI. Janë përgatitur planet e veprimit për të gjeturat e identifikuar dhe në vazhdimësi janë duke u monitoruar aktivitetet. • Janë zhvilluar raportet që paraqesin punën prokurorëve për lëndët e pranuar, zgjidhura etj, dhe mënyrën e zgjidhjes. Po ashtu në bashkëpunim me përfaqësuesit e projektit CEPEJ, jemi duke punuar në dizajnimin e raporteve të reja që pasqyrojnë në tërësi procesin e punës në prokurori. <p>Janë mbajtur takimet të rregullta me Komisionin për Administrimin e Prokurorive dhe janë diskutuar të gjitha çështjet që ndërlidhen me SMIL, duke filluar nga zbatimit, kualitetit i shënimeve, raportet statistikore, avancimi i SMIL etj. Në vazhdimësi janë paraqitur raportet për aktivitet që janë realizuar në kuadër të SMIL.</p> <p>Në bashkëpunim me Projektin EUKOJUST është mbajtur punëtorja dy ditore me temën zbatimi i monitorimit të SMIL. Në këtë punëtori është prezantuar raporti për secilën prokurori lidhur me krahasimin e statistikave (manual – SMIL) si dhe problemet të cilat janë identifikuar.</p> <p>Gjatë gjithë kohës është bërë monitorimi i vazhdueshëm i kualitetit të të dhënave në SMIL, përpilimi i raporteve mbi të gjeturat, koordinimi me stafin për korrigjimin e gabimeve.</p> <p>Janë mbajtur takime me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe me KGJK për avancimin e shkëmbimit elektronik. Ndërsa është proces zhvillimi për ndërlidhjen e sistemit në mes të Doganës dhe Prokurorisë.</p>
12	Ngritja e kapaciteteve njerëzore të KGJK-së në lidhje me analizën e të dhënave të grumbulluara, që synon zhvillimin e politikave bazuar në të dhëna	2022	KGJK	<p>Numri i zyrtarëve për analizë të të dhënave është ngritur; Zyrtarët janë trajnuar për analizë të të dhënave</p> <p>KGJK është duke punuar në digjitalizimin e procesit të punës, me ç'rast është reduktuar koha e grumbullimit të të dhënave.</p> <p>Në bazë të kësaj është arritur përmirësimi dhe avancimi i llogaritjes së performancës për gjykatat dhe gjyqtarët, ndihmon në identifikimin e nevojave dhe në ri-alokimin e resurseve njerëzore bazuar në analiza dhe të gjetura. Mirëpo duke pasur parasysh nevojat e KGJK-së dhe gjykatave për analiza dhe statistika të avancuara të cilat do kalonin në një nivel tjetër punën e gjykatave nevojitet forcimi i njësitit me resurse njerëzore si në aspektin numerik ashtu edhe për trajnime</p> <p>Ngritja e kapaciteteve njerëzore të KGJK-së në lidhje me analizën e të dhënave të grumbulluara, që synon zhvillimin e politikave bazuar në të dhëna.</p>
Masa e politikës: Menaxhimi i përmirësuar i rasteve				50% zbatuar plotësisht
13	Zbatimi i rekomandimit të CEPEJ-së për menaxhimin e kohës në mënyrë që në një instancë gjyqësore rasti të zgjidhet brenda një periudhe dyvjeçare nga dita e paraqitjes së tij	2021 - 2023	KGJK	<p>Rastet në një instancë gjyqësore zgjidhen brenda dy vjetëve nga regjistrimi i tyre, përveç rasteve tejet komplekse</p> <p>KGJK në bazë të të dhënave të SMIL për kohëzgjatjen e kryerjes së lëndëve ka bërë raporte dhe ka adresuar të gjitha të gjeturat në takime të KGJK, takime në asamblenë e kryetarve të gjykatave dhe sipas nevojë me gjykatat individuale. Ky aktivitet është në proces e sipër</p>

14	Hartimi i planit për të adresuar vonesat në procedura dhe periudhat e pasivitetit të lëndës.	2021	KGJK, Kryetarët e Gjykatave	Plani i miratuar i cili adreson vonesat dhe periudhat e pasivitetit	Ky aktivitet është i zbatueshem. KGJK ne vazhdimësi publikon raportet statistikore 3,6,9 mujore dhe vjetore ne të cilat raportohet për mesataren e kohëzgjatjes.
15	Mundësimi dhe zbatimi konsistent i caktimit automatik të lëndëve tek gjyqtarët	2021	KGJK	Rastet caktohen menjëherë dhe automatikisht nga SMIL	Ky aktivitet është zbatuar dhe SMIL e mundëson këtë.
16	SMIL matë numrin e lëndëve të kthyer nga Apeli në rigjykim në Gjykata Themelore, në mënyrë të vazhdueshme dhe publikon këto të dhëna në raportet vjetore	2022 - 2023	KGJK	Numri i rasteve të kthyer në rigjykim është i ditur; Numri i rasteve të kthyer në rigjykim përfshihet në raportet vjetore të KGJK-së	Ky aktivitet është përfunduar, ne SMIL ku gjëndërohen te dhënat statistikore është përfshi edhe kolona ku tregon edhe numrin e çështjeve të kthyer ne rigjykim. Raporti vjetor permban edhe numrin e ketyre lendeve
17	KGJK ndërmer veprimet e nevojshme rregullative dhe zhvillon veçoritë teknike të SMIL për të detyruar gjyqtarët që në SMIL të fusin arsyen e vonesës dhe/apo të shtyerjes së seancës	2021	KGJK	Gjyqtari është i detyruar me akte dhe me veçoritë e SMIL që të fusë arsyen e vonesës/shtyerjes së seancës	Sipas Vendimit të KGJK-së, të gjithë gjyqtarët dhe stafi administrativ i gjykatave, janë të obliguar të përdorin SMIL-in përfshirë këtu edhe evidentuar edhe arsyet e vonesës/shtyerjes së seancave. Kjo çështje është diskutuar dhe adresuar edhe ne Asambleshën e Kryetarëve të Gjykatave, ku gjate raportimit të kryetarëve të gjykatave është konstatuar se ky aktivitet është duke u zbatuar nga të gjithë gjykatat. Po ashtu kryetarët janë zotuar se do të bëjnë përcjelljen e vazhdueshme se a po zbatohet ky aktivitet.
18	Kryetarët e gjykatave raportojnë në KGJK në baza tre mujore për arsyet e vonesave dhe/apo shtyerjeve të seancave	2021	Kryetarët e Gjykatave, KGJK	Raportet tremujore të Kryetarëve përmbajnë pjesë të veçantë në të cilën raportohet për arsyet e vonesave/shtyerjeve të seancave	Kryetarët e gjykatave raportojnë ne baza te rregullta ne KGJK, duke përfshirë raportimet tre mujore dhe vjetore, ku trajtohen edhe arsyet e shtyerjes se seancave gjyqësore
19	Ndryshimi i Rregullores për matjen e performancës së gjyqtarëve në mënyrë që njëra nga kriteret për matjen e performancës së Kryetarëve të Gjykatave të jetë edhe menaxhimi i tij me vonesat/shtyerjet si dhe raportimet për vonesat/shtyerjet e seancave	2022	KGJK	Rregullorja për matjen e performancës e ndryshuar	Rregullorja nr. 13/2022 për vlerësimin e performancës së Kryetarëve të Gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës është miratuar nga KGJK me datë 27.12.2022. ⁵⁰ Neni 10 (1.2.4) përfshin kriterin lidhur me efikasitetin e punës së gjykatës, gjegjësisht vlerësimin e Kryetarëve për seancat e shtyra dhe të anuluar dhe ndërmarrja e masave për evitimin e shtyerjeve dhe anulimin e seancave gjyqësore.
20	Hartimi i Koncept Dokumentit për Ekspertiza Gjyqësore dhe Prokuroriale	2022	MD, KGJK, KPK	Koncept Dokumenti i miratuar	Koncept Dokumenti është miratuar me datë 9 mars 2022. ⁵¹
<i>Masa e politikës: Harmonizimi i legjislacionit komercial</i>					0% zbatuar plotësisht
21	Themelimi i një grupi punues të vetëm për rishikimin e legjislacionit në fushën komerciale.	2022	MD, MTI	Komisioni i themeluar dhe funksional	Në zhvillim e sipër. Me datën 13.9.2023 është miratuar në Qeveri Projektligji për Falimentimin, kjo çështje është trajtuar edhe në procesin e hartimit të koncept dokumenteve përkatëse: Koncept Dokumenti për Gjykatën Administrative dhe të Punës dhe Koncept Dokumenti për Kodin e Procedurës Civile
22	Kryerja e vlerësimit të ndikimit legjislativ në kuadrin ligjor ekzistues.	2022	MD, MTI	Vlerësimi i kryer	Nuk ka zhvillime
23	Hartimi i Pakos së Ligeve komerciale.	2023	MD, MTI	Ligjet e hartuara dhe të procesuara për miratim në Kuvend	Projektligji për Falimentimin pas miratimit në Qeveri, është Proceduar në Kuvend. ⁵²
<i>Masa e politikës: Themelimi i Gjykatës Komerciale</i>					75% zbatuar plotësisht
24	Hartimi i Ligjit për Gjykatën Komerciale.	2021	MD	Ligji për Gjykatën Komerciale i miratuar	Ligji për Gjykatën Komerciale është miratuar në Janar 2022, dhe pas dekretimit është publikuar në Gazetë Zyrtare në Shkurt 2022. ⁵³

⁵⁰ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/2283_KGJK_Rregullore_Nr_13_2022_per_vleresimin_performances_te_kryetareve_te_gjykatave_dhe_gjyqtareve_mbikeqyres.pdf

⁵¹ https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/03/Koncept-Dokumentit-per-Ekspertet-Gjyqesore_AL.pdf

⁵² <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=497>

⁵³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53748>

25	Përshtatja dhe rirregullimi i buxhetit të Gjykatës Komeriale.	2021	KGJK	Buxheti i miratuar adreson nevojat infrastrukturore të Gjykatës së re Komeriale	Në vitin 2023 është ndarë buxheti për Gjykatën Komeriale edhe pse jo i mjaftueshëm. Këtë aktivitet KGJK e ka përfunduar me sukses sipas mundësive buxhetore
26	Trajnimi i gjyqtarëve në fusha të specializuara komerciale.	2021 - 2023	AD	9 trajnime të realizuara gjatë vitit.	Janë realizuar 10 trajnime në fushën komerciale në të cilat kanë përfituar gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të kësaj gjykate, me temat si në vijim: Implikimet në praktikë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare; ⁵⁴ Procedura përbarimorë-lejimi i përbarimit; ⁵⁵ Arbitrazhi; ⁵⁶ Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare; ⁵⁷ Kontratat për ndërtimin; Zbatimi dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtare, Direktivave dhe Rregulloreve të UE-së mbi çështjet komerciale dhe doganore. ⁵⁸ një me temë: Përmbledhje e specifikave të industrisë së TIK-ut licencimit dhe të drejtave të pronësisë; ⁵⁹ si dhe Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore dhe atyre të arbitrazhit. ⁶⁰
27	Trajnimi i stafit mbështetës në fusha të specializuara komerciale	2021 - 2023	AD	9 trajnime të realizuara gjatë vitit.	Janë realizuar 10 trajnime në fushën komerciale në të cilat kanë përfituar gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të kësaj gjykate, me temat si në vijim: Implikimet në praktikë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare; ⁶¹ Procedura përbarimorë-lejimi i përbarimit; ⁶² Arbitrazhi; ⁶³ Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare; ⁶⁴ Kontratat për ndërtimin; Zbatimi dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtare, Direktivave dhe Rregulloreve të UE-së mbi çështjet komerciale dhe doganore, ⁶⁵ një me temë: Përmbledhje e specifikave të industrisë së TIK-ut licencimit dhe të drejtave të pronësisë; ⁶⁶ si dhe Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore dhe atyre të arbitrazhit. ⁶⁷
Masa e politikës: Mekanizmat efektiv të ZAK-së që i përshtaten përmasave dhe nevojave të biznesit					50% zbatuar plotësisht
28	Lansimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe avokimit për arbitrazhin për sektorë ose veprimtari të veçanta biznesore	2021 - 2023	Odat Ekonomike, MD, MTI	Fushata ndërgjegjësuese e realizuar	Nuk ka zhvillime
29	Aktivitetet vetëdijësuese për nxitjen e përfshirjes së klauzolave të arbitrazhit në kontratat biznesore që përfshijnë	2021 - 2022	Odat Ekonomike, MD, MTI	Një fushatë vetëdijësuese mediale që shënjestron bizneset brenda vitit; Një fushatë vetëdijësuese që shënjestron	ODA Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës me mbështetje të Programit të USAID 'Drejtesia Komerciale', kanë realizuar gjatë vitit 2021 aktivitetet vetëdijësuese rreth arbitrazhit dhe rëndësisë së klauzolës së arbitrazhit në kontrata dhe këto po vazhdojnë edhe në vitin 2022. Prej periudhës janar 2021 deri qershor 2022 janë mbajtur 13 tryeza për arbitrazh. 7 janë mbajtur gjatë vitit

⁵⁴ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/BulPrr23Sq_.pdf

⁵⁵ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16502>

⁵⁶ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16505>

⁵⁷ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16558>

⁵⁸ https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/Bulshatatshq_.pdf

⁵⁹ https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/bultetor2023shq_.pdf

⁶⁰ <https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/buldhjetor2023.pdf>

⁶¹ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/BulPrr23Sq_.pdf

⁶² <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16502>

⁶³ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16505>

⁶⁴ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16558>

⁶⁵ https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/Bulshatatshq_.pdf

⁶⁶ https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/bultetor2023shq_.pdf

⁶⁷ <https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/buldhjetor2023.pdf>

	ekzekutimin e aktiviteteve me risk të lartë dhe kohë të ndjeshme			avokatët brenda vitit; Një tryezë diskutimi me bizneset brenda vitit.	2021, dhe 6 janë prej janar 2022 deri qershor 2022. Për të matur rezultatin e këtyre aktiviteteve vetëdijësuese janë paraqitur të dhënat në vijim: 1. Sipas studimit të vitit 2021, numri i klauzolave për Mekanizëm Alternativ të Zgjidhjes së kontesteve është rritur nga 21% (2019-studimi bazë) në 35% (studimi i 2021). 2. Ndërgjegjësimi për institucionet e arbitrazhit është rritur nga 17% (2019-studimi bazë) në 35% (studimi 2022). Këto aktivitete do të vazhdojnë të realizohen edhe në 2022 dhe viteve në vijim.
30	Trajnimi i ndërmjetësuesve, edukimi i stafit të gjykatave dhe nëpunësve të ndërmjetësimit për referim të rasteve	2021	AD	Trajnimet e realizuara	Në periudhën raportuese janë realizuar 3 sesione trajnuese ⁶⁸ regionale për ndërmjetësimin, pjesë e të cilave kanë qenë edhe gjyqtarë, staf administrativ nga gjykatat dhe prokuroritë, avokatë, etj. Përveç trajnimeve, në periudhën raportuese janë realizuar edhe dy sesione trajnuese në kuadër të Programit për trajnimin e trajnuesve në fushën e ndërmjetësimit. ⁶⁹
31	Fuqizimi i divizionit të veçantë për mbikëqyrje të profesioneve të lira në MD me burime njerëzore për mbikëqyrje të duhur të profesionit të ndërmjetësimit.	2022	MD	MD ka mbikëqyrës të veçantë për ndërmjetësimin	Është në zhvillim e sipër konkursi për 2 zyrtarë në DMLPPL.
<i>Masa e politikës: E- Drejtësia dhe ndërlidhshmëria e të dhënave</i>					<i>0% zbatuar plotësisht</i>
32	Funksionalizimi i veçorisë së SMIL për të mundësuar thirrjet elektronike nga gjykata drejtuar palëve dhe përfaqësuesve të tyre	2023	KGJK	Veçoria e SMIL është funksionale; Palët ftohen në seanca në mënyrë elektronike	KGJK ka nenshkuar deri tani MoU me Avokaturen shtetërore dhe Komunen e Prishtinës për të derguar në formë elektronike ftesat për seanca gjyqësore. Ky aktivitet është në proces të siper. Do të parashihet në kuadër të Kodit të Procedurës Civil
33	Publikimi i një buletini mujor elektronik të gjykatës për kompanitë që kanë aplikuar për insolvencë ose falimentim.	2022	KGJK	Buletinet mujore elektronike publike	Ne proces të implementimit
34	Krijimi i një platforme të ndërlidhur të shkëmbimit të të dhënave ndërmjet ARBK-së, autoriteteve tatimore dhe doganore, organeve të prokurimit, dhe gjyqësorit.	2023	ARBK, ATK, Organet e prokurimit, gjykatat	Platforma funksionale	Ne proces të implementimit

⁶⁸ Regjioni i Gjiçanit – <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/14970>

Regjioni i Ferizajit – <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/15992>

Regjioni i Pejë – <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/16022>

⁶⁹ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/13779>

<https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/10583>

Kapitulli 1.3 - Rritja e profesionalizmit

	Veprimi	Afati i fundit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Progresi në zbatim
<i>Masa e politikës: Fuqizimi i komizës institucionale dhe legjislativë për zhvillim profesional</i>					0% zbatuar plotësisht
1	Hartimi i Koncept Dokumentit mbi nevojën për një ligj të veçantë për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve i cili përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të gjitha instrumentet dhe mundësitë e zhvillimit në karrierë, dhe qartëson kompetencat në mes të KGJK-së, KPK-së dhe AD-së.	2022	MD,KGJK KPK, AD	Koncept Dokumenti për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve i miratuar.	. Në kuadër të punës së grupeve punuese për reformën në drejtësi, është duke u diksuar lidhur me modalitetet sa l përket regullimit. të statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
<i>Masa e politikës: Harmonizimi i trajnimeve të ofruara për zhvillim profesional me nevojat e sektorit të drejtësisë</i>					80% zbatuar plotësisht
2	Hartimi i Planit Strategjik për Burime Njerëzore (PSBNJ) i cili përfshinë nevojat për rekrutim dhe trajnim.	2021 -	KGJK	Plani Strategjik për Burime Njerëzore i miratuar.	KGJK ka miratuar planin e punesimit dhe ku eshte perfshire nevoja per rekrutim dhe trajnim ⁷⁰
3	Hartimi i Planit për Burime Njerëzore (PSBNJ) i cili përfshinë nevojat për rekrutim dhe trajnim.	2021 -	KPK	Plani Strategjik për Burime Njerëzore i miratuar.	Plani i burimeve njerëzore për vitin 2023 është miratuar në takimin e KPK-së të datës 23 shkurt 2023 me vendimin KPK/nr. 193/2023. me datë 13 tetor 2023 është miratuar plotësim/ndryshimi i Planit të Personelit me vendimin KPK/nr. 775/2023. Ndersa dokumenti i politikave të trajnimit për prokurorët dhe stafin administrativ të sistemit prokurorial per vitin 2024 është miratuar me datë 22 dhjetor 2023 dhe është dërguar në Akademinë e Drejtësisë.
4	Vlerësimi i ndikimit të trajnimeve në sistemin gjyqësor i kryer në 3-5 vitet e fundit.	2022	AD, KGJK	Vlerësimet e realizuara.	Vazhdon të jetë sfiduese edhe më tej meqë nuk është duke u perkrahë plotësisht fillimisht me pyetesorin para dhe pas trajnimit aty per aty. Mbetet për tu adresuar edhe më tej. Nevoitet një angazhim edhe më aktiv I trajnuesit në këtë proces siq edhe e kerkon Doracaku për trajnues.
5	Vlerësimi i ndikimit të trajnimeve në sistemin prokurorial i kryer në 3-5 vitet e fundit.	2022	AD, KPK	Vlerësimet e realizuara.	Vazhdon të jetë sfiduese edhe më tej meqë nuk është duke u perkrahë plotësisht fillimisht me pyetesorin para dhe pas trajnimit aty per aty. Mbetet për tu adresuar edhe më tej. Nevoitet një angazhim edhe më aktiv I trajnuesit në këtë proces siq edhe e kerkon Doracaku për trajnues.
6	Caktimi automatik i lëndëve në bazë të ekspertizës së gjyqtarit kur është e mundshme.	2023	KGJK	Sistemi për caktimin automatik të lëndëve në mënyrë rastësore, përmbanë informata të profilit të gjyqtarit dhe mundëson caktimin e lëndëve duke marrë parasysh këtë ekspertizë.	KGJK ka aprovuar kriteret për shpërndarjen e lëndëve në mënyrë automatike dhe të barabartë te gjyqtarët sipas departamenteve ku punojnë. Në departamentin e përgjithshëm, divizioni civil, rastet e dhunës në familje i caktohen gjyqtarit sipas profilit të tij/saj.
7	Zhvillimi i planeve të trajnimit për fushat që janë identifikuar si mangësi të zakonshme të gjyqtarëve kur kryhen vlerësimet e performancës në sektorin e drejtësisë dhe bazuar në anketat e Vlerësimit të Nevojave të Trajnimit të kryera në online nga Akademia	2021	AD	Planet e trajnimit të hartuara.	Në vitin 2022, Planet e trajnimit janë hartuar bazuar në vlerësimin e nevojave trajnuese të cilat janë identifikuar nga mekanizmat për vlerësim dhe kryesisht me nevojat e identifikuar trajnuese të gjyqtarëve në departamentet përkatëse. ⁷¹ Për çdo vit, AD zhvillon planet e trajnimit të cilat reflektojnë kërkesat nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese. Në këtë proces janë përfshirë gjithë akterët e gjyqësorit. Akademia e ka publikuar në ueb faqe programin vjetor të trajnimit për vitin 2023 më datë 25 nëntor 2022. ⁷² Gjyqtarëve dhe prokurorëve iu janë ndarë planet e trajnimit së paku 3 javë para trajnimit për ti koordinuar trajnimet me proceset e tyre të punës në prokurori dhe me perfaqësimet e tyre. Janë përpiluar listat e aplikuesve dhe janë dërguar ftesat dhe agjendat dhe detajet tjera të trajnimit.

⁷⁰ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/63940_Vendimi_KGJK_se_Nr_553_2023_miratohet_plani_perqijthshem_punesimit_per_vitin_2024.pdf https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/70850_Vendimi_KGJK_se_Nr_554_2023_miratohet_Projekt_plani_punesimit_5_vjecar.pdf https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/21071_KGJK_Plani_veprimi_per_trajnimin_gjyqtareve_2024

⁷¹ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/PT2022____.pdf

⁷² https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/PT1222v2_.pdf. https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/pl2023SQ_.pdf.

8	Zhvillimi i planeve të trajnimit për fushat që janë identifikuar si mangësi të zakonshme të prokurorëve kur kryhen vlerësimet e performancës në sektorin e drejtësisë dhe bazuar në anketat e Vlerësimit të Nevojave të Trajnimit të kryera në online nga Akademia	2021	AD	Planet e trajnimit të hartuara.	Në vitin 2022, Planet e trajnimit janë hartuar bazuar në vlerësimin e nevojave trajnuese të cilat janë identifikuar nga mekanizmat për vlerësim dhe kryesisht me nevojat e identifikuar trajnuese të gjyqtarëve në departamentet përkatëse. ⁷³ Për çdo vit, AD zhvillon planet e trajnimit të cilat reflektojnë kërkesat nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese. Në këtë proces janë përfshirë gjithë akterët e gjyqësorit. Akademia e ka publikuar në ueb faqe programin vjetor të trajnimit për vitin 2023 më datë 25 nëntor 2022. ⁷⁴ Gjyqtarëve dhe prokurorëve iu janë ndarë planet e trajnimit së paku 3 javë para trajnimit për ti koordinuar trajnimet me proceset e tyre të punës në prokurori dhe me perfaqësimet e tyre. Janë përpiluar listat e aplikuesve dhe janë dërguar ftesat dhe agjendat dhe detajet tjera të trajnimit.
9	Hartimi i një analize për nevojat e trajnimit të stafit mbështetës të gjykatave dhe prokurorëve	2022	AD	Analiza e hartuar; Analiza identifikon qartë nevojat e stafit për trajnim.	Në Shtator të vitit 2022, Akademia e Drejtësisë ka realizuar takimet ⁷⁵ me administratorët e gjykatave dhe të prokurorëve me qëllim të vlerësimit të nevojave trajnuese të stafit mbështetës të gjykatave dhe prokurorëve. Përveç takimeve janë marrë në konsideratë edhe propozimet nga formularët e vlerësimit të nevojave trajnuese pas secilit sesion trajnues të mbajtur gjatë vitit 2022. Propozimet nga këto mekanizma kanë shërbyer gjatë hartimit të kurrikulës trajnuese për vitin 2023.
10	Hartimi i planeve të trajnimit për fushat që janë identifikuar si mangësi të zakonshme të stafit mbështetës të gjykatave dhe prokurorëve	2023	AD	Planet e hartuara dhe të parapra në kalendarin e AD	Si rezultat i nevojave trajnuese për stafin mbështetës të gjykatave dhe prokurorëve dhe prioritetëve të KGJK-së dhe KPK-së është hartuar plani i trajnimit për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorëve. Bazuar në kalendarin trajnues, trajnimet kanë filluar së zbatuari që nga muaji prill dhe deri në qershor janë realizuar 21 trajnime në fushën penale nga moduli i trajnimit bazik-aspekti material dhe procedural dhe 8 trajnime nga moduli civil-aspekti material dhe procedural. ⁷⁶ Edhe për muajin qershor kanë vazhduar sesionet e njejtë por me grupe tjera të bashkëpunëtorëve profesiona. Ngjashëm si për gjyqtarë dhe prokurorë planet e trajnimit për bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor dhe stafin tjetër mbështetës të cilat janë miratuar paraprakisht janë ndarë me administratorët e gjykatave dhe prokurorëve dhe me përfituesit varësisht prej modulit/kurrikulës trajnuese. Në gjashtë mujorin e dytë kanë qenë të planifikuara rreth 34 ditë trajnimi për bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor dhe stafin tjetër mbështetës ndërkaj janë shtuar edhe tri trajnime dy ditore veçanërisht për bashkëpunëtorët profesional si rezultat i mbështetjes nga Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI)
11	Hartimi i një kurrikule të re trajnuese të veçantë për Kryetarë të Gjykatave dhe Kryeprokurorë, me fokus në avansimin e aftësive të tyre menaxheriale dhe të tjera të nevojshme për pozitën e tyre udhëheqëse	2022	AD	Kurrikula e miratuar.	Kurrikula trajnuese është hartuar.
12	Ofrimi i trajnimeve të specializuara për gjyqtarë në fushat e identifikuar si mangësi gjatë vlerësimit të performancës.	2021 - 2023	AD	Gjyqtarët e trajnuar.	Nuk ka pasur kërkesa prej KGJK-së për trajnime të detyrueshme që rrjedhin si rezultat i vlerësimit të performancës së gjyqtarëve prandaj edhe nuk ka pasur trajnim të detyrueshëm për gjyqtarë
13	Ofrimi i trajnimeve të specializuara për prokurorë në fushat e identifikuar si mangësi gjatë vlerësimit të performancës.	2021 - 2023	AD	Prokurorët e trajnuar.	Është realizuar një trajnim i detyrueshm për një prokuror sipas vendimit të KPK-së. Trajnim është realizuar në pajtim me Protokollin për trajnime të detyrueshme për prokurorët me performacë të dobët. Akademia ka përcjell në KPK raportin me rezultatet e prokurorit në trajnim. Përveç këtij trajnimi, nuk ka pasur kërkesa tjera nga KPK/

⁷³ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/PT2022____.pdf

⁷⁴ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/PT1222v2_.pdf, https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/pl2023SQ_.pdf

⁷⁵ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/14882>

⁷⁶ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16397>

<https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16428>

<https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16457>

<https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16490>

<https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16495>

14	Avansimi dhe pasurimi i burimeve online për zhvillim profesional për personelin e sektorit të drejtësisë.	2021	AD	Burimet online të pasuruara.	Akademia ka vazhduar abonimin edhe për këtë vit në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike që si rezultat vazhdon ti ketë databazat me burime të ndryshme juridike. Në periudhën raportuese edhe biblioteka elektronike e AD-së është pasuruar me materiale të ndryshme ligjore nga trajnimet e AD-së. ⁷⁷
15	Specializimi i mëtejshëm i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme në fushën e të drejtave të njeriut dhe praktikës së GjEDNJ.	2021 - 2023	Gjykata Supreme, AD	2 trajnime/seminare/vizita studimore të realizuara gjatë vitit.	KEDNJ-së si dhe korniza ligjore nacionale në rastet e diskriminimit dhe raporti me ligjet e tjera me theks në Ligjin e Punës dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore. Këtë trajnim e vijuan 21 gjyqtarë prej tyre 3 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, 2 nga Gjykata e Apelit dhe 16 të tjerë nga niveli themelor i gjykatave nga të gjitha regjionet e Kosovës https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/bultetor2023shq__pd (Faqe-14) Ndërkaq është realizuar edhe një trajnim me temë E drejta për liri dhe siguri-zbatimi i nenit 5 të KEDNJ-së dhe roli i Gjykatës Supreme. Por që nuk kanë marrë pjesë gjyqtarë nga kjo gjykatë por nga instancat më të ulëta.
16	Rishikimi i programeve të AD-së për rastet e dhunës në familje me qëllim të avansimit të tyre	2022	AD	Programi i rishikuar; Rekomandimet për ndryshim të programit të miratuara nga AD	Gjatë vitit 2021 është rishikuar Programi Trajnues sa i përket trajnimeve për Dhunën në Familje. Në kurikulën trajnuese për vitin 2022, trajnimet e dhunës në familje kanë kaluar në program të specializuar. ⁷⁸ Si rezultat i këtij rishikimi, gjatë vitit 2022 ka filluar realizimi i trajnimeve.
Masa e politikës: Akademia e Drejtësisë së Kosovës reaguese ndaj nevojave të sektorit të drejtësisë					73% zbatuar plotësisht
17	Hartimi i Koncept Dokumentit për Akademinë e Drejtësisë i cili, ndër të tjera, parasheh rregulla të qarta për të gjitha llojet e trajnimeve, i jep AD-së mundësi për nxjerrjen e akteve të brendshme rregullative, rregullon kompetencën e organeve drejtuese, komisioneve dhe organizimin e brendshëm	2022	MD, AD	Koncept Dokumenti i miratuar	Koncept Dokumenti është hartuar. ⁷⁹
18	Ndarja e buxhetit më të madh për AD me qëllim të mundësimin të ri-strukturimit dhe angazhimit të numër më të lartë të trajnerëve të përhershëm.	2023	Qeveria, Kuvendi	Buxheti i AD-së i ritruar.	Është trajtuar në kuader të Koncept Dokumentit për Akademinë e Drejtësisë, planifikohet të adresohet edhe gjatë hartimit të Ligjit.
19	Realizimi i një analize mbi nevojën për specializim të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga ana e AD në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në.	2021	AD, KGJK ,KPK	Analiza e realizuar.	Bazuar në legjislacionin në fuqi, për të analizuar burimet njerëzore dhe kapacitetet e gjyqësorit dhe prokurorisë është kompetencë ekskluzive e KGJK-së dhe KPK-së meqë sipas mandatit vendosin për numrin e gjyqtarëve/prokurorëve në secilin juridiksion, për avancimin, transferimin e gjithashtu edhe për trajnimin. Akademia e Drejtësisë bazuar në mandatin e saj zbaton vlerësimin e nevojave trajnuese të

⁷⁷ <http://jus.igjk.rks-gov.net/view/type/teaching=5Fresource.html>

⁷⁸ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/ToT_Tool_ALB_.pdf

⁷⁹ <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/koncept-dokumenti-per-akademinë-e-drejtësisë/>

					gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe mbi bazën e këtij vlerësimi harton programet trajnuese adekuate me funksionet dhe detyrat e tyre të punës me qëllim ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e cilësisë së punës në gjykata dhe prokurori. Këtë proces e bënë bashkë me akteret e gjyqësorit dhe prokurorisë dhe padyshim si gjatë vlerësimit ashtu edhe gjatë zbatimit të trajnimeve është vërejtë nevoja për profilizim të gjyqtarëve dhe prokurorëve por që për këtë bazuar në kompetencat sipas ligjit AD mundet të ketë rolin mbështetës që nëse institucionet përkatëse kanë nevojë për kuadër të specializuar, përkatësisht të profilizuar ta mbështesë me programe veçanërisht për këto kategori.
20	Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit për të përcaktuar standardet e koordinimit dhe ndërlidhja e databazave për të mundësuar shkëmbimin e informatave në mes të AD-së, KGJK-së, dhe KPK-së dhe për të garantuar mekanizmat e koordinimit në trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.	2021	KGJK, KPK AD	Memorandumi i Bashkëpunimit i nënshkruar.	Databaza tashmë është konsoliduar me kërkesat sa i përket ndërlidhjes dhe mundësisë së shkëmbimit të informatave. Pritet të funksionalizohet dhe të lehtësoi shkëmbimin e informatave veçanërisht me Komisionin për verësimin e performancës dhe kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive
21	Përdorimi i pajisjeve moderne (panelevë inteligjente) gjatë dhe pas trajnimit për të vlerësuar njohuritë e të trajnuarve dhe aftësinë e tyre për të marrë pjesë (ose jo) në module më të përparura.	2021	AD	Procesi i trajnimit dhe vlerësimit të trajnimeve i modernizuar.	Në 35 trajnime për të cilat është zbatuar pyetesori para dhe pas trajnimit vetëm në dy prej tyre janë përdorë pajisjet apo panelet inteligjente. Këto janë përdorë në trajnimet e specializuara me temë PST Dhuna në familje 14-15 shkurt 2023 dhe PST Krimi kibernetik dhe Kriptavalutat -Sesioni I.
22	Zgjerimi i programit të trajnimeve për të përfshirë module në TI, gjuhën angleze, juridiksionin e GJEDNJ dhe shkencat shoqërore.	2021	AD	Programi i trajnimeve i zgjeruar.	Programi trajnues për vitin 2023 përfshinë module trajnuese që janë fushëveprim i gjitha departamenteve dhe divizioneve të gjykatave dhe prokurorive. Përveq kësaj përfshinë edhe module trajnuese që kanë të bëjnë me shkathtësitë në komunikim, për përdorim të SMIL-it për sistemet audio-video dhe për sistemet e mbrojtjes së dëshmitarëve, anglishtja ligjore, trajnimet për KEDNJ. Një pjesë e këtyre trajnimeve janë të integruara edhe në platformë. ⁸⁰ Të gjitha trajnimet e planifikuara sipas programit të ofruar janë realizuar
23	Koncepti Dokumenti mbi Akademinë shqyrton çështjen e konfliktit të mundshëm të interesit kur Bordi Menaxhues dhe Këshilli Programor vendosin për programin vjetor të trajnimit, ndërsa më vonë ligjërojnë në të njëjtat module të programit, duke përfituar financiarisht nga ai.	2022	AD	Konfliktet e interesit të mënjanuara.	Këshilli Drejtues i Akademisë, me datë 08 mars 2021 ka marr vendim për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Programor të AD-së që njëkohësisht të mos shërbejnë edhe në ushtrimin e funksionit të trajnuesit të AD-së. ⁸¹ Për më tepër si rezultat i kërkesave të Ligjit për parandalimin e Korrupsionit, AD ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit il cili do të zbatohet dhe monitorohet për të shmang çdo shkelje të integritetit
24	Publikimi i listës së përditësuar rregullisht të trajnerëve të përhershëm, trajnerëve të përkohshëm, dhe mentorëve.	2021	AD	Lista e trajnerëve e përditësuar çdo 6 muaj, e publikuar.	Pas përfundimit të procesit të rekrutimit të trajnuesve, përmes konkursit të hapur publik dhe konkurses, lista e trajnuesve është miratuar nga KD dhe e njejtë është publikuar në faqen e AD-së. ⁸²
25	Sesione të rregullta të Trajnimit të Trajnerëve (TiT).	2021 - 2023	AD	5 sesione të Trajnimit të Trajnerëve të realizuara gjatë vitit.	Gjatë vitit 2023 janë realizuar edhe 7 trajnime të trajnuesve rreth temave si në vijim: 2 sesione të trajnimit nga 3 ditë për Ndërmjetësimin ⁸³ ; Krimi i organizuar dhe korrupsioni; ⁸⁴ Trajnimi për certifikimin e trajnuesve (OPDAT); ⁸⁵

⁸⁰ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/PT1222v2_.pdf

⁸¹ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/VKD08mars21SQ_.pdf

⁸² : <https://ad.rks-gov.net/lista-e-trajnuesve-te-perkohshem>.

⁸³ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16241>; <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16370>

⁸⁴ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16507>

⁸⁵ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16636>.

					Trajnim për gjykimin e rasteve të korrupsionit, një për arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe një për metodologjinë HELP. ⁸⁶ Këto trajnime janë mbështetur nga donatorë si INL, CEELI dhe OPDAT
26	Përcaktimi i kritereve të rrepta dhe të qarta për zgjedhjen e mentorëve dhe trajnerëve.	2021	KGJK, AD, MD	Kriteret për zgjedhjen e mentorëve dhe trajnerëve të përcaktuara ligjrisht.	AD në bashkëpunim me KGJK-në dhe me mbështetje të Projektit 'EUROJUST' kanë hartuar Rregulloren e cila përmbanë kritere të qarta për trajnues dhe mentorë. ⁸⁷
27	Përcaktimi i kritereve të qarta për zgjedhjen e mentorëve dhe trajnerëve.	2021	KPK, AD, MD	Kriteret për zgjedhjen e mentorëve dhe trajnerëve të përcaktuara ligjrisht.	AD në bashkëpunim me KGJK-në dhe me mbështetje të Projektit 'EUROJUST' kanë hartuar Rregulloren e cila përmbanë kritere të qarta për trajnues dhe mentorë. ⁸⁸

⁸⁶ https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/Bulshtatshq__.pdf
https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/Bulnentsorshq__.pdf

⁸⁷ https://ad.rks-gov.net/media/Rregulloret/Rregullore012023trajnuesshq__.pdf

⁸⁸ https://ad.rks-gov.net/media/Rregulloret/Rregullore012023trajnuesshq__.pdf

Kapitulli 1.4 - Rritja e integritetit të gjyqtarëve e prokurorëve

Masa e politikës: Aftësimi i KGJK-së dhe KPK-së për ruajtjen e integritetit gjyqësor						0% zbatuar plotësisht
1	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ashtu që të përcaktohen kritere shtesë specifike kualitative për gjyqtarët me mandat të përhershëm që mund të jenë anëtarë të KGJK-së.	2022	MD	KGJK	Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i miratuar.	Hartimi i Projektligjit është i nderlidhur me "Deklaraten e Perbashket" dhe është i paraapër në agjendën legjislative për vitin 2024
2	Promovimi i aplikacioneve jo gjyqësore për anëtarësim në KGJK.	2021 - 2023		KGJK	Së paku 1 tryezë diskutimi e realizuar gjatë vitit me OAK, fakultetet juridike dhe shoqërinë civile.	Gjate organizimit të konferencës vjetore në takimin e me media, oq është trajtuar edhe kjo qeshtje. Per arsye se nuk ka pasur pozita të hapura, nuk është pare si e nevojshme organizimi i tryezes.
3	Rregullorja e re e KGJK-së për rekrutimin, provimin, emërimin dhe rrimërimin e gjyqtarëve, të bëjë të mundshme përfshirjen e anëtarëve jo gjyqtarë që janë anëtarë të KGJK-së në Komisionin e Rekrutimit të anëtarëve të KGJK.	2022		KGJK	Rregullorja e re përmban këto elemente.	Me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.190/2023 të datës 18.05.2023 është vendosur për përbërjen e Komisionit për rekrutimin e gjyqtarëve të gjykatave themelore në Kosove. Ne këtë përbërje bën pjese një anëtar i KGJK-se i cili nuk është gjyqtar dhe behet fjale për Vilard Bytyqi. KGJK gjate diskutimit lidhur me caktimin e z.Bytyqit ka marre parasysht këtë edhe realizmin e këtij aktiviteti. Anetari jo gjyqtar ka marr pjese gjate gjithë procesit të emrimit të gjyqtarve.
4	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës me qëllim të lehtësimit të kriterëve për emërimin e anëtarëve jo-prokurorë në KPK.	2022		MD,KPK	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës i miratuar.	Projektligji me ndryshimet e bëra është aprovuar në qeveri dhe aktualisht gjendet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. ⁸⁹
5	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës ashtu që vetëm kandidatët që nuk janë politikisht aktiv për tre vitet e fundit të mund të konsiderohen për anëtarësim në KPK.	2022		MD,KPK	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës i miratuar.	Projektligji me ndryshimet e bëra është aprovuar në qeveri dhe aktualisht gjendet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. ⁹⁰
6	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ashtu që vetëm kandidatët që nuk janë politikisht aktiv për tre vitet e fundit të mund të konsiderohen për anëtarësim në KGJK.	2022		MD,KPK	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i miratuar.	Hartimi i Projektligjit është i nderlidhur me "Deklaraten e Perbashket" dhe është i paraapër në agjendën legjislative për vitin 2024.
7	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës ashtu që të përcaktohen kritere shtesë specifike kualitative për prokurorët me mandat të përhershëm që mund të jenë anëtarë të KPK-së.	2022		MD,KPK	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës i miratuar.	Projektligji me ndryshimet e bëra është aprovuar në qeveri dhe aktualisht gjendet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. ⁹¹
8	Promovimi i aplikacioneve jo-prokuroriale për anëtarësim në KPK.	2021		KPK	Së paku 1 tryezë diskutimi e realizuar gjatë vitit me OAK, fakultetet juridike dhe shoqërinë civile.	Nuk ka zhvillim.

⁸⁹ linku:<https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=490>

⁹⁰ linku:<https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=490>

⁹¹ linku:<https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=490>

9	Hartimi i udhëzimit me shkrim për prokurorë për votimin e anëtarëve të ardhshëm të KPK-së sipas meritës dhe kapacitetit.	2022	KPK	Udhëzimi i miratuar.	Aktualisht KPK ka rregulloren për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të KPK-së ku paraqiten në mënyrë të qartë procedurat për votimin dhe përzgjedhjen e anëtarëve prokurorë të KPK-së. ⁹² Duke qenë se ligji për KPK është në proces të plotësisht ndryshimit dhe pikat kryesore që preken janë pikërisht zgjedhja e anëtarëve, KPK nuk mund të fillojë ende hartimin e ndonjë akti lidhur me këto çështje.
Masa e politikës: Rekrutimi, promovimi dhe transferimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës i bazuar në kompetencë					45% zbatuar plotësisht
10	Hartimi i aktit nënligjor i cili përcakton procedurën për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha pjesëve të provimit për përzgjedhjen e gjyqtarëve të rinj.	2021	KGJK	Akti nënligjor i miratuar.	Ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave është e adresuar në kuadër të Rregullores në fuqi për rekrutim dhe kjo çështje është duke u zbatuar me përpikëmeri, çka vërtetohet edhe nga procesi i fundit për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtar të rinj i zhvilluar gjatë vitit 2022. ⁹³
11	Ndryshimi i aktit nënligjor për avancimin e procedurës për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha pjesëve të provimit për përzgjedhjen e prokurorëve të rinj.	2021	KPK	Akti nënligjor i ndryshuar.	Rregullorja e re nr.02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Ri-emërimin e Prokurorëve të Shtetit ka avancuar procedurën për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha pjesëve të provimit për përzgjedhjen e prokurorëve të rinj.
12	Akti nënligjor i cili propozohet të hartohet (më sipër në rekomandimin për KGJK) parasheh ndërtimin e një baze të sigurtë të pyetjeve për testin e kualifikimit dhe testin me shkrim me përzgjedhje automatike të pyetjeve për përzgjedhjen e gjyqtarëve të rinj.	2021	KGJK	Akti nënligjor i miratuar.	Rregullorja Nr.03/2021 për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve e miratuar nga Keshilli gjatë viti 2021 përcakton të gjitha procedurat përfshirë edhe procedurat dhe mënyrën e hartimit të pyetjeve dhe të teksti kualifikues për gjyqtarë e rinj. E gjithë procedura e mbajtur për test kualifikues në pajtim me rregulloren është monitoruar dhe monitorohet nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore duke përfshirë edhe shoqërinë civile. Të njëjtë janë ndarë të kenaqur me këtë procedurë dhe nuk kanë pasur ndonjë vërejtje apo sugjerim. ⁹⁴
13	Avancimi i bazës së sigurtë të pyetjeve për testin e kualifikimit me përzgjedhje automatike të pyetjeve për përzgjedhjen e prokurorëve të rinj.	2021	KPK	Baza e sigurtë e pyetjeve funksionale.	Sipas Rregullores së re të KPK-së për rekrutimin e prokurorëve, ka avancuar siguria e bazës së pyetjeve, ngase testi përpilohet ditën e mbajtjes së provimit. Në kuadër të Sistemit elektronik të menaxhimit të dosjeve të prokurorëve është zhvilluar moduli i testimit i cili mundëson përzgjedhjen automatike të pyetjeve të testi kualifikues dhe pas përfundimit kandidati njoftohet për pikët e fituara. Sistemi është funksional dhe i gatshëm për zbatim. Në konkursin e fundit të rekrutimit Prokuror të Shtetit ky sistem nuk është aplikuar për shkak të numrit të madh të aplikantëve dhe nuk arritëm të sigurojmë pajisje (laptop) të nevojshëm për të gjithë kandidatët.
14	Akti nënligjor i cili propozohet të hartohet (më sipër në rekomandimin për KGJK) përcakton metodologjinë e strukturuar për vlerësimin e testit me shkrim e cila përfshinë përdorimin e përgjigjeve model të mbështetura nga një matricë e rezultateve.	2021	KGJK	Akti nënligjor i miratuar.	Me hyrjen në fuqi të Rregullorja Nr.03/2021 për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve e miratuar nga Keshilli gjatë viti 2021 të gjitha proceset e perfunduara KGJK ka marrë vlerësime pozitive si nga organizatat vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare ⁹⁵
15	Avancimi i metodologjisë së strukturuar për vlerësimin e testit me shkrim e cila përfshinë përdorimin e përgjigjeve model të	2021	KPK	Metodologjia e re funksionale.	Sipas Rregullore së re të KPK-së, përgjigjet model përdoren për testin kualifikues, ndërsa për testin me shkrim është formulari i veçantë unik ku në detaje specifikohet mënyra e vlerësimit të testit dhe ajo çfarë pritet nga përgjigjet e kandidatëve duke qenë se ato janë me shkrim.

⁹² <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/10.pdf>

⁹³ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/66244_Rregullore_Nr_03_2021_per_rekrutimin_provimin_emerimin_dhe_riemerimin_gjyqtareve.pdf

⁹⁴ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/66244_Rregullore_Nr_03_2021_per_rekrutimin_provimin_emerimin_dhe_riemerimin_gjyqtareve.pdf

⁹⁵ Rregullorja Nr.03/2021 për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve

	mbështetura nga një matricë e rezultateve.				
16	Akti nënligjor i cili propozohet të hartohet (më sipër në rekomandimin për KGJK) parasheh metodologji të vlerësimit të bazuar në kompetencë (competency based questioning) dhe ndër të tjera, konceptin e lojës së roleve në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve të rinj, ku një kandidat ballafaqohet me probleme të jetës reale si pjesë e testimit të kriterëve të përzgjedhjes.	2021	KGJK	Akti nënligjor i miratuar.	Rregullorja aktuale nuk e parasheh këtë metodologji. Me hyrjen në fuqi të Rregullorja Nr.03/2021 për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve e miratuar nga Këshilli gjatë viti 2021 të gjitha proceset e perfunduara KGJK ka marrë vlerime pozitive si nga organizatat vendore ashtu edhe ato ndërkombetare ⁹⁶ .
17	Akti nënligjor i cili propozohet të hartohet (më sipër në rekomandimin për KPK) parasheh metodologji të vlerësimit të bazuar në kompetencë (competency based questioning) dhe ndër të tjera, parasheh konceptin e lojës së roleve në procesin e përzgjedhjes së prokurorëve të rinj, ku një kandidat ballafaqohet me probleme të jetës reale si pjesë e testimit të kriterëve të përzgjedhjes.	2021	KPK	Akti nënligjor i miratuar.	Rregullorja e re e KPK-së e ka paraparë vlerësimin e bazuar në kompetencë gjatë intervistës me gojë (Neni 27).
18	Hartimi i një Rregulloreje të re për rekrutimin, provimin, emërimin, riemërimin dhe transferin e gjyqtarëve	2022	KGJK	Rregullorja e re për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve e miratuar.	Rregullorja për rekrutim është miratuar në vitin 2021, ndërsa Rregullorja nr.08/2022 për Transferimin e gjyqtarëve është miratuar nga KGJK me datë 28.07.2022. ⁹⁷
19	Rregullorja e re për rekrutim, promovim, emërimin, riemërim dhe transfer të gjyqtarëve, ndër të tjera, vendos një procedurë të angazhimit për monitorimin e të gjitha fazave të procesit të rekrutimit.	2022	KGJK	Rregullorja e re përmban këto elemente.	Rregullorja e re për rekrutim, promovim, emërimin, riemërim dhe transfer të gjyqtarëve, ndër të tjera, vendos një procedurë të angazhimit për monitorimin e të gjitha fazave të procesit të rekrutimit.
20	Këshilli fton partnerët ndërkombëtar dhe OSHC-të për monitorimin e të gjitha fazave të procesit të rekrutimit.	2021 - 2023	KPK	Ftesa nga Këshilli e bërë publike.	Gjate periudhës raportuese nuk ka pasur proces të rekrutimit. Mirepo, në cdo proces paraprak sic edhe kemi raportuar me heret, Këshilli në cdo proces të rekrutimit fton partnerët ndërkombëtar dhe organizatat e shoqërisë civile për monitorim në të gjitha fazat e procesit të rekrutimit. Kjo është bërë edhe gjatë procesit të fundit të rekrutimit, që mund të dëshmohej me publikimin e raportit vjetor të KPK-së.
21	Hartimi i një Rregulloreje të re për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e prokurorëve	2022	KPK	Rregullorja e re e miratuar	Rregullorja e re nr.02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit është miratuar me datë 27.06.2022. ⁹⁸
22	Rregullorja e re e KPK-së për procesin e rekrutimit, emërimin dhe riemërimin të prokurorëve parasheh mundësinë për përfshirjen e anëtarëve jo-prokurorë në komisionet e emërimit.	2022	KPK	Rregullorja e re përmban këto elemente	Ky aktivitet është adresuar në Rregulloren e re për rekrutim të miratuar në vitin 2022 (Neni 7.3).

⁹⁶ Rregullorja Nr.03/2021 për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve

⁹⁷ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/57309_KGJK_Rregullore_Nr_08_2022_transferimin_brendshem_gjyqtareve.pdf

⁹⁸ [https://www.prokuroria-](https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Rregullore%20p%C3%ABr%20Rekrutimin%2C%20Provimin%2C%20Em%C3%ABrimin%20dhe%20Riem%C3%ABrimin%20e%20Prokuror%C3%ABve%20t%C3%AB%20Shtetit%2C%20nr.02.2022.pdf)

[rks.org/assets/cms/uploads/files/Rregullore%20p%C3%ABr%20Rekrutimin%2C%20Provimin%2C%20Em%C3%ABrimin%20dhe%20Riem%C3%ABrimin%20e%20Prokuror%C3%ABve%20t%C3%AB%20Shtetit%2C%20nr.02.2022.pdf](https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Rregullore%20p%C3%ABr%20Rekrutimin%2C%20Provimin%2C%20Em%C3%ABrimin%20dhe%20Riem%C3%ABrimin%20e%20Prokuror%C3%ABve%20t%C3%AB%20Shtetit%2C%20nr.02.2022.pdf)

23	Zhvillimi i udhëzimeve operacionale për të gjithë anëtarët e rinj dhe të vjetër të KZR-së.	2022	KGJK	Udhëzimet operacionale të miratuara.	Aktualisht aspektet operacionale të anëtarëve të Komisionit të Rekrutimit udhëheqen sipas procedurave të Rregullores për Rekrutim, ndërsa shtojcat/formularët e Rregullores shërbejnë për të udhëzuar Komisionin.
24	Ofrimi i trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për të gjithë anëtarët e rinj dhe të vjetër të KZR-së.	2021 - 2023	AD, KGJK	Trajnimet e mbajtura.	AD: Realizimi i këtij aktiviteti varet krejtësisht nga kërkesa dhe gatishmëria e anëtarëve të KGJK-së. Zbatimi i kësaj mase do të jetë sfiduese për Akademinë pasi që programet trajnuese që janë zhvilluar duke përfshirë akteret e gjyësorit dhe prokurorisë janë ekskluzivisht për të rrit kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit dhe funksioneve tjera ligjore që janë përfutues të trajnimeve sipas Ligjit për AD-në. Duke pas në konsideratë këto rethana dhe mungesën e përvojës praktike për trajnime të këtij lloji AD është e angazhuar në gjetjen e ekspertizës dhe mundësinë e mbështetjes me donatorë.
25	Rregullorja e re e KGJK-së për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve parasheh mandat më të gjatë të anëtarëve të KZR-së.	2022	KGJK	Rregullorja e re përmban këto elemente.	. Me hyrjen në fuqi të Rregullorja Nr.03/2021 për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve e miratuar nga Keshilli gjatë viti 2023ne të gjitha proceset e perfunduara KGJK ka marrë vlerime pozitive si nga organizatat vendore ashtu edhe ato ndërkombetare.
26	Rregullorja e re e KGJK-së për procesin e rekrutimit, emërimin dhe riemërimin të prokurorëve duhet të përcaktojë listë objektive dhe gjithëpërfshirëse të kriterëve për vendim-marrje sipas së cilave KGJK mund të refuzojë të zbatojë rekomandimet e Komisionit për Emërimin dhe detyrimin të KGJK-së për të arsyetuar me shkrim refuzimin e rekomandimeve të Komisionit.	2022	KGJK	KGJK jep arsytetime me shkrim në rastet kur refuzon rekomandimet e Komisionit	Nuk ka zhvillime.
27	Rregullorja e re e KPK-së për procesin e rekrutimit, emërimin dhe riemërimin të prokurorëve duhet të përcaktojë listë objektive dhe gjithëpërfshirëse të kriterëve për vendim-marrje sipas së cilave KPK mund të refuzojë të zbatojë rekomandimet e Komisionit për Emërimin dhe detyrimin të KPK-së për të arsyetuar me shkrim refuzimin e rekomandimeve të Komisionit.	2022	KPK	Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (02/2013) për procesin e rekrutimit, emërimin dhe riemërimin të prokurorëve e miratuar.	Ky aktivitet nuk është adresuar në Rregulloren e re të KPK-së për Rekrutimin.
28	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për KGJK ashtu që të parashihet mundësia për ankesë në Gjykatë Supreme, me procedurë të përshpejtuar, për kandidatët të pakënaqur me vendimin përfundimtar të emërimin nga KGJK.	2022	MD, KGJK	Ligji për KGJK i ndryshuar.	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është paraparë në Programin Legjislativ për vitin 2023.
29	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për KPK ashtu që të parashihet mundësia për ankesë në Gjykatë Supreme, me procedurë të përshpejtuar, për kandidatët të pakënaqur me vendimin përfundimtar të emërimin nga KPK.	2022	MD, KPK	Ligji për KPK i ndryshuar.	Projektligji me ndryshimet e bëra është aprovuar në qeveri dhe aktualisht gjendet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.
30	Hartimi i udhëzimeve operacionale për Komisionin i cili do të menaxhojë procesin e emërimin të prokurorëve.	2021	KPK	Udhëzimet operacionale të miratuara.	Rregullorja e re e miratuar parasheh formularët për secilin hap të procesit të rekrutimit, ndërsa hartimi i udhëzimeve për Komisionin është planifikuar
31	Avancimi i formularëve për Komisionin e Emërimin për vlerësimin e kandidatëve (veçanërisht me fokus për intervista)	2021	KPK	Formularët e përditësuar	Në shtojcat e Rregullores së re të KPK-së për rekrutimin e prokurorëve, janë përcaktuar formularët për vlerësimin e kandidatëve.
32	Trajnime të specializuara për anëtarët e Komisionit.	2021	KPK	Trajnimet e realizuara.	Gjate periudhes raportuese nuk ka pasur proces të rekrutimit dhe sipas rregullores, komisioni themelohet me rastin e shpalljes së konkursit për rekrutim.

33	Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për transferimin dhe caktimin e gjyqtarëve me qëllim të përcaktimit të kriterëve objektive për vlerësimin e kandidatëve, njohurive, aftësi dhe përvojës në ushtrimin e rolit specifik në të cilin ata duan të transferohen.	2022	KGJK	Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transferimin dhe caktimin e gjyqtarëve e miratuar.	Rregullorja nr.08/2022 për Transferimin e gjyqtarëve është miratuar nga KGJK me datë 28.07.2022. ⁹⁹ Kriteret e kërkuara specifike sipas këtij aktiviteti janë përfshirë në Nenin 8 të Rregullores.
34	Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin, pezullimin dhe largimin e kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës me qëllim të përcaktimit të aftësi udhëheqëse dhe menaxheriale të kërkuara për pozitën e Kryetarit të Gjykatës të cilat do të testohen gjatë intervistës.	2022	KGJK	Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin, pezullimin dhe largimin e kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, e miratuar.	Rregullorja nr. 12/2022 për procedurën e zgjedhjes, emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës është miratuar me datë 27.12.2022 nga KGJK. ¹⁰⁰ Kriteri lidhur me aftësitë udhëheqëse dhe menaxheriale përcaktohen në Nenin 8.
35	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Prokurorin e Shtetit me qëllim që procesi për emërimin e ZKPSH të jetë proces i objektiv, i bazuar në kompetencë, i hapur, i drejtë dhe konkurrues.	2022	MD KPK	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit i miratuar.	Eshte zbatuar. Ligji për Prokurorin e Shtetit është Miratuar dhe publikuar në Gazetën Zyrtare. ¹⁰¹
36	Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores (08/2016) për emërimin e Kryeprokurorëve me qëllim të qartësisimit të metodologjisë që do të përdoret për vlerësimin e kandidatëve për pozitën e KP, duke përfshirë ketu arsyetimin për kategoritë poentuese dhe dhënien e pikëve për kriteret e ndryshme të përzgjedhjes.	2022	KPK	Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (08/2016) për emërimin e Kryeprokurorëve e miratuar.	Pas miratimit të Rregullores aktuale për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, është avancuar sistemi i vlerësimit duke krijuar formular të veçantë të vlerësimit, ku përfshihen kategoritë e ndryshme poentuese dhe dhënia e pikëve për kriteret e ndryshme të përzgjedhjes. ¹⁰²
37	Trajnime të specializuara të mbështetjes për Komisionin e Vlerësimit të kandidatëve për pozitën e Kryeprokurorëve (KP).	2022 - 2023	KPK AD	1 trajnim i realizuar gjatë vitit.	Nuk ka pasur trajnime të kesaj fushe
38	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për KPK ashtu që procesi për emërimin e zëvendës kryeprokurorëve dhe udhëheqësëve të departamenteve të trajtohet njëjtë sikurse ngritja në detyrë dhe kandidati i suksesshëm të përzgjedhet përmes një procesi të hapur, konkurrues dhe të bazuar në meritë dhe aftësi.	2022	MD KPK	Ligji për KPK i ndryshuar	Pas rekomandimeve nga Gjykata Kushtetuese. Projektligji me ndryshimet e bëra është aprovuar në qeveri dhe aktualisht gjendet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. ¹⁰³

⁹⁹ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/57309_KGJK_Rregullore_Nr_08_2022_transferimin_brendshem_gjyqtareve.pdf

¹⁰⁰ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/1064_KGJK_Rregullore_nr_12_2022_per_proceduren_zgjedhjes_emerimit_pezullimit_dhe_shkarkim_Kryetareve.pdf

¹⁰¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=74943>

¹⁰² [https://prokuroria-](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Rregullorja%20Nr.06.2019%20p%C3%ABr%20em%C3%ABrimin%20e%20Kryeprokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%20dhe%20kryeprokuror%C3%ABve%20t%C3%AB%20prokuroriv)

[rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Rregullorja%20Nr.06.2019%20p%C3%ABr%20em%C3%ABrimin%20e%20Kryeprokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%20dhe%20kryeprokuror%C3%ABve%20t%C3%AB%20prokuroriv](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Rregullorja%20Nr.06.2019%20p%C3%ABr%20em%C3%ABrimin%20e%20Kryeprokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%20dhe%20kryeprokuror%C3%ABve%20t%C3%AB%20prokuroriv)

¹⁰³ <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji?draftlaw=490>

39	Miratimi i Planit të Integritetit për gjyqtarë.	2022	KGJK	Planet e Integritetit të miratuara.	Duke marre parasysh se sistemi gjyqësor ka struktura dhe shtrirje te gjere edhe me qëllim qe plani te jete gjithëpërfshirëse dhe ti përmbush te gjitha kërkesat, SKGJK pas konsultimeve te nevojshme ka përfunduar draftin qe është ne fazën përfundimtare te miratimit dhe se shpejti do te dërgohet Agjencionin Kundër Korrupsionit.
40	Miratimi i Planit të Integritetit për prokurorë.	2022	KPK	Planet e Integritetit të miratuara.	Në bazë të nenit 11, paragrafi 2, pika 2.3 e Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës si dhe në bazë të nenit 25 të Ligjit nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit më datë 17.01.2024, titullari i institucionit ka nxjerr vendimin për caktimin e Grupi Punues për hartimin e Planit të Integritetit, në përputhje me përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit. Grupi punues është mandatar për të përgatitur hartimin e Planit të Integritetit, përmes së cilit do të vlerësohej gjendja aktuale e funksionimit të institucionit dhe do të analizoheshin me fokus masat ekzistuese për menaxhimin e rrezikut të korrupsionit, do të vlerësohej intensiteti i rrezikut të korrupsionit. Grupi Punues ka realizuar takime në përbërje më të ngushtë dy herë dhe herën e tretë me datë 26.01.2024, në përbërje më të gjerë ka përfunduar draftin e parë të planit të integritetit të cilin e ka përcjellë në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit po të njëjtën datë. Me datë 29 janar 2024 janë pranuar disa komente të Agjencisë dhe së shpejti po planifikohet të realizohet një punëtori për të proceduar sipas rekomandimeve drejt finalizimit të dokumentit.
<i>Masa e politikës: Realizimi i kontrolleve të pavarura dhe të vazhdueshme të integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës</i>					
					0% zbatuar plotësisht
41	Hartimi i Ligjit për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës i cili përcakton themelimin e një njësie të veçantë për kontrollin e integritetit, të aftë për të kryer kontrolle të plota të integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës.	2023	MD,KGJK ,KPK	Ligji për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës i miratuar.	Duke u zbatuar.Hartimi i Projektligjit eshte i nderlidhur me "Deklaraten e Perbashket të zotimit"
42	Ligji për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës përcakton qartazi qëllimin e kontrolleve të integritetit.	2023	MD,KGJK ,KPK	Qëllimi i kontrolleve të integritetit i përcaktuar ligjërisht.	Duke u zbatuar.Hartimi i Projektligjit eshte i nderlidhur me "Deklaraten e Perbashket të zotimit"
43	Ligji për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës parasheh realizimin e kontrolleve të rregullta të integritetit.	2023	MD,KGJK ,KPK	Kontrolle të integritetit të realizuara çdo x vite.	Duke u zbatuar.Hartimi i Projektligjit eshte i nderlidhur me "Deklaraten e Perbashket të zotimit"
44	Ligji për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës ndan vlerësimin dhe procesin e kontrollit të integritetit nga vlerësimet tjera profesionale gjatë procesit të rekrutimit	2023	MD,KGJK ,KPK	Procesi i kontrollit të integritetit dhe procesi i rekrutimit ndahen qartazi me ligj.	Duke u zbatuar.Hartimi i Projektligjit eshte i nderlidhur me "Deklaraten e Perbashket të zotimit"
45	Ligji për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës përcakton qartazi informatat relevante të cilat do të merren parasysh gjatë kontrollit të integritetit.	2023	MD,KGJK ,KPK	Informatat të cilat do të merren parasysh gjatë kontrollit të integritetit të përcaktuara ligjërisht.	Duke u zbatuar.Hartimi i Projektligjit eshte i nderlidhur me "Deklaraten e Perbashket të zotimit"
<i>Masa e politikës: Fuqizimi i kapaciteteve të Njësisve ekzistuese për verifikim në KGJK dhe KPK</i>					
					25% zbatuar plotësisht
46	Rregulloret e reja mbi rekrutimin, promovimin, emërimin dhe rrimërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve përcaktojnë qartazi mandatin e Njësisve të Verifikimit.	2022	KGJK, KPK	Rregullorja e re për rekrutimin, provimin, emërimin dhe rrimërimin e gjyqtarëve e miratuar; Rregullorja e re për procesin e	Keshilli ne takimin e dates 26 qershor 2023 ka miratuar rregulloren per veprimtarinë, organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës ku eshte themeluar nje

				rekurtimit, emërimit dhe riemërimit të prokurorëve e miratuar.	njesi e vecante per verifikim me mandat te qarte dhe gjate ketij viti edhe eshte caktuar u.d. udheheqesi i kesaj njesie. ¹⁰⁴
47	Zhvillimi i aranzhimeve të përbashkëta të punës ndërmjet njësive të verifikimit të KGJK dhe KPK, duke përfshirë këtu ndarjen e informatave dhe praktikave të qëndrueshme të punës në të dy njësitë.	2021	KGJK,KPK	Aktet nënligjore të miratuara.	Nuk ka zhvillime.
48	Trajnime për njësitë ekzistuese të verifikimit të KGJK-së me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në verifikim.	2021 - 2023	KGJK, ADK	1 trajnim i realizuar gjatë vitit.	Eshte duke u pergaditur plani i trajnimit lidhur me këtë aktivitet
49	Trajnime për njësitë ekzistuese të verifikimit të KPK-së me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në verifikim.	2021 - 2023	KPK, ADK	1 trajnim i realizuara gjatë vitit.	Nuk ka zhvillime.

¹⁰⁴ <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Rregullore%20nr.05.2023%20P%C3%ABr%20Organizimin%20e%20Brendsh%C3%ABm%20dhe%20Funksionimin%20e%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%20t%C3%AB%20Kosov%C3%ABs%2C%20nr.209.7.2023.pdf>

Kapitulli 2.1 - Fuqizimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë

	Veprimi	Afati i fundit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Progresi në zbatim
Masa e politikës: Avancim i kuadrit ligjor me qëllim të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë					33% zbatuar plotësisht
1	Ndryshimi i legjislationit për konfiskimin e pasurisë përfituar jashtëligjshëm në mënyrë që një përqindje e caktuar e të hyrave nga konfiskimi t'u ndahet agjencive të sektorit të drejtësisë	2022	MD	Ligji i ndryshuar dhe miratuar; fondi i themeluar	Hartimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit Nr.05/L-049 për Admistrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të konfiskuar i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-034 është paraparë në agjendën legjislative me datën 20.12.2024.
2	Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për konfiskimin e pasurisë	2021 - 2023	AD, KGJK, KPK, AAPSK	4 trajnime të realizuara brenda vitit	<p>Gjatë vitit 2023 janë lzhvilluar 8 trajnime, si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 trajnime eskuzivisht vetëm për sekuestrimin dhe konfiskimin. Trajnimet kanë qenë regjionale. Me 12 maj 2023 ka qenë l dedikuar për regjionin e Prishtinës dhe Mitrovicës. Trajnimi l radhës me 19 maj ishte për regjionin e Prizrenit, Gjakovës dhe Pejësi dhe datë 26 maj 2023 i cili ishte për regjionin e Gjilanit dhe të Ferizajit.¹⁰⁵ - 3 trajnime për risitë e Kodit të Procedurës Penale, në kuadër të cilave është trajtuar sekustrimi dhe konfiskimi bazuar në ndryshimet ligjore. Këto trajnime janë realizuar në datat 13-14 janar 2023, 27-28 janar 2023,¹⁰⁶ 10-11 shkurt 2023,¹⁰⁷ si dhe 23-24 qershor 2023.¹⁰⁸ - 4 trajnime tjera që i përkasin kësaj fushe. Me 6-10 shkurt 2023:¹⁰⁹ Programi i trajnimit për hetime financiare dhe rikuperim të asetëve.¹¹⁰ Trajnimi i radhës me 20-24 mars 2023 Hetimi financiar dhe kthimi i pasurisë.¹¹¹ Me 18-20 prill Programi i Specializuar i trajnimit -Pastrimi i parave dhe hetimi financiar-Sesioni I si dhe me 16-17 maj 2023 vazhdimi i këtij programi me sesionin II¹¹²; <p>Përveq këtyre aktiviteteve trajnuese, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane/OPDAT, në shkurt të vitit 2023 ka realizuar edhe një punëtori për Hartimin e Udhëzuesit për Konfiskim. Grupi punues për hartimin e këtij udhëzuesi ka qenë në përbërje prej 8 prokurorëve që janë njëkohësisht koordinatorë të rrejt të konfiskimit, 1 gjyqtarë 1 zyrtarë i Agjencisë për Konfiskim dhe Sekuestrim si dhe 1 Këshilltar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.¹¹³</p> <p>Në gjashtëmuorin e dytë janë realizuar edhe 5 trajnime per risitë e Kodit të Procedurës Penale në kuadër të cilave janë trajtuar risitë ligjore sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit.¹¹⁴</p>

¹⁰⁵ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16432> ; <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16459> ; <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16481>

¹⁰⁶ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/BiJan23Sq_.pdf

¹⁰⁷ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/BulShk23Sq_.pdf

¹⁰⁸ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16582>

¹⁰⁹ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/BulShk23Sq_.pdf

¹¹⁰ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/BulMrs23Sq_.pdf

¹¹¹ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/BulPrr23Sq_.pdf

¹¹² <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2023/Details/16445>

¹¹³ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/BulShk23Sq_.pdf

¹¹⁴ https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/bul_korrik_gusht_.pdf , https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/bultetor2023shq_.pdf (fq-13)

https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/Bulshtatshq_.pdf (fq-12)

3	Hartimi i Kodit të ri të Procedurës Penale për të zgjatur periudhën e lejuar ligjërisht për hetime të veprave penale të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar	2021	MD	Kodi i ri i Procedurës Penale i miratuar	Kodi i Procedurës Penale është miratuar nga Kuvendi me datë 14.07.2022. ¹¹⁵ Neni 157 i Kodit 'Afatet kohore të hetimit' parasheh një zgjatje prej një (1) viti të hetimit (pas kërkesës së prokurorit dhe autorizimit të gjyqtarit të procedurës paraprake). Ky afat është më i gjatë se ai paraprak në Kodin e shfuqizuar, e që ishte gjashtë (6) muaj.
4	Themelimi i një grupi punues ndërinstytucional për të ofruar interpretim të unifikuar të "dashjes" dhe për t'i paraprirë mendimit juridik të Gjykatës Supreme	2021	KGJK, KPK, Prokurori i Shtetit	Grupi punues i themeluar dhe konkluzionet e ndara me Gjykatën Supreme	Ne proces te implementimit
5	Gjykata Supreme të hartojë dhe miratojë një mendim juridik për të unifikuar interpretimit të "dashjes" siç përkufizohet në nenin 21 të Kodit Penal	2022	Gjykata Supreme	Mendimi juridik i miratuar	Gjykata Supreme nxjerr Mendime Juridike, me qëllim të unifikimit të zbatimit unik të ligjeve, kur dispozitat e caktuara ligjore nuk aplikohen njëjtë nëpër gjykatat e Kosovës. Nga praktika e deritanishme, nuk është hasur në raste të tilla.
6	Ndërveprimi i sistemeve kompjuterike të shumë agjencive për të lehtësuar ndjekjen e veprave penale	2023	MD, KGJK & KPK	Ndërlidhja e sistemeve kompjuterike e përfunduar	Sistemi për Menaxhim Informativ të Lëndëve është i ndërlidhur me: <ul style="list-style-type: none"> □ Agjencioni i Regjistrimit Civil (kjo ndërlidhje do të mundësojë që gjatë regjistrimit të personave në sistem, të dhënat të kopjohen nga regjistri civil përmes numrit personal dhe të vendosen në SMIL) □ Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës(kjo ndërlidhje do të mundësojë që gjatë regjistrimit të bizneseve në sistem, të dhënat të kopjohen nga regjistri i bizneseve përmes numrit të biznesit dhe të vendosen në SMIL) □ Policia e Kosovës (kjo ndërlidhje mundëson që të bëhet dorëzim/pranimi i të gjitha dokumenteve ndërmjet sistemit të prokurorive dhe sistemit të policisë në mënyrë elektronike) □ Gjykatat Themelore (të gjitha aktet dërgohen në gjykatë dhe po ashtu pranohen nga gjykata në mënyrë elektronike përmes SMIL). Në proces të zhvillimit është ndërlidhjes është me sistemin e Doganave të Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës.
<i>Masa e politikës: Rritja e performancës së prokurorëve dhe gjyqtarëve</i>					<i>50% zbatuar plotësisht</i>
7	Ndryshimi i Ligjit për PSRK për të hequr kompetencën ekskluzive të PSRK-së për veprat penale të pastrimit të parave, ashtu që fokusi i PSRK-së të jetë në veprat e pastrimit të parave me vlerë më të madhe	2022	MD	Ligji për PSRK i ndryshuar	Eshte zbatuar. Ligji për Prokurorinë Speciale është miratuar në kuvend me 26.10.2023 dhe është adresuar çështja që fokusi i PSRK-së të jetë në veprat e pastrimit të parave me vlerë më të madhe. ¹¹⁶

¹¹⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>

¹¹⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84236>

8	Rritja e numrit të ekspertëve të specializuar financiar në PSRK dhe perforcimi i kritereve për perzgjedhjen e tyre	2022	KPK & PSRK	Rekrutimi i ekspertëve të specializuar financiar i përfunduar	Aktualisht në PSRK janë 5 ekspertë financiar të punësuar sipas kritereve të caktuara dhe një pozite është e lire. Me ligjin për buxhetin për vitin 2023 na është lejuar edhe pozita e ekspertit ushtarak për të cilën janë përcaktuar kriteret e qarta dhe konkrete për rekrutim.
---	--	------	------------	---	--

Kapitulli 2.2 - Përmirësimi i profesionalizmit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë

Masa e politikës: Vlerësimet efektive të performancës					50% zbatuar plotësisht
1	Ndryshimi i Rregullores së KGJK-së për vlerësimin e performancës në mënyrë që rekrutimi i Komisionit për Shqyrtimin e Performancës të bëhet me një thirrje të hapur, me kritere të qarta dhe të matshme, me mandate të ndryshme kohore që siguron ruajtjen e memories institucionale	2021	KGJK	Rekrutimi i Komisionit për Shqyrtimin e Performancës i përfunduar	Sipas Rregullores nr.02/2021 (Neni 5.3) rekrutimi i Komisionit për Vlerësimin e Performancës është bërë me thirrje të hapur dhe proces konkurrues. Gjithashtu Neni 33 i kësaj Rregullore ka përcaktuar mandatet e ndryshme kohore të anëtarëve të Komisionit, me qëllim ruajtjen e memories institucionale.
2	Ndryshimi i Rregullores së KPK-së për vlerësimin e performancës në mënyrë që rekrutimi i Komisionit për Vlerësimin e Performancës të bëhet me një thirrje të hapur, me kritere të qarta dhe të matshme, me mandate të ndryshme kohore që siguron ruajtjen e memories institucionale	2021	KPK	Rekrutimi i Komisionit për Shqyrtimin e Performancës i përfunduar	Rregullorja aktuale për vlerësimin e prokurorëve ka përcaktuar kriteret e qarta dhe të matshme për Komisionin, si dhe mandate të ndryshme kohore për anëtarët e Komisionit. Kurse, rekrutimi i Komisionit nuk bëhet me thirrje të hapur. Mirepo grupi punues për vlerësim të performancës në kuadër të reformës në drejtësi janë duke punuar dhe pritet të shihen rekomandimet e tyre.
3	Hartimi i Koncept Dokumentit mbi nevojën për një Ligj të veçantë për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, për të përcaktuar arsimimin e vazhdueshëm ligjor të detyrueshëm për prokurorë dhe gjyqtarë	2022	MD, KGJK, KPK, AD	Koncept Dokumenti për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve i miratuar	Në kuadër të punës së grupeve punuese për reformën në drejtësi, është duke u diskutuar lidhur me modalitetet sa i përket rregullimit të statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
4	Zgjerim i Platformës Elektronike të AD, për të pëmbajtur më shumë module të trajnimeve online	2021	Akademia e Drejtësisë, ASHI	Platforma Elektronike e AD më e qasshme	Gjithësej janë 18 kurse që janë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe. Po ashtu, gjatë vitit 2023 platformën e mësimit në distancë MOODLE e ka shfrytëzuar edhe për zhvillimin e një trajnimi në bashkëpunim me UNDP/SAEK me temë: Hetimi financiar dhe rikuperimi i aseteve. Platforma MOODLE ka shërbyer si baza bazë për pjesëmarrësit dhe trajnuesit në vendosjen e materialeve të trajnimit si dhe ushtrimet praktike. Janë zhvilluar dy sesione trajnuese lidhur me këtë. ¹¹⁷ Gjithashtu AD, me qëllim të zhvillimit të kuadrit të trajnuesve, gjatë vitit 2023 ka organizuar edhe një Trajnim të Trajnuesve rreth Metodologjisë HELP, e cila do ju shërbejë në zhvillimin e kurseve trajnuese në të ardhmen në platformën moodle.
5	Rishikimi i kurikulave për arsimim ligjor dhe inkorporimi i aftësive të të menduarit kritik	2021 - 2023	Fakultetet juridike, KPK, KGJK & AD	Kurikulat e rishikuara të miratuara	Nuk ka zhvillime
6	Themelimi i Këshillit të Etikës	2022	KPK, KGJK & AD	Këshilli i Etikës i themeluar	KGJK ka themeluar Këshillin e Etikës dhe është duke funksionuar.
Masa e politikës: Forcimi i pavarësisë së institucioneve gjyqësore					50% zbatuar plotësisht
7	Zhvillim i strukturës së veçantë hierarkike brenda sektorit të prokurorisë ku KPK është organi kryesor administrativ për këtë	2022	MD, KPK	Struktura e veçantë hierarkike brenda sektorit të prokurorisë e zhvilluar	Ndryshimet janë paraparë në Ligjin për Prokurorin e Shtetit. ¹¹⁸

¹¹⁷ <https://ad.rks-gov.net/hetimi-financiar-dhe-rikuperimi-i-aseteve-0>
<https://ad.rks-gov.net/hetimi-financiar-dhe-rikuperimi-i-aseteve>

¹¹⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=74943>

	sektor. Kryeprokurorët duhet t'i raportojnë KPSH-së i cili nga ana tjetër duhet t'i raportojë KPK-së.				
8	Ndryshimi i Ligjit për KPK-në me qëllim të eliminimit të obligimit për përfaqësim nga çdo rajon në KPK.	2022	KPK	Ligji i KPK-se i amendamentuar dhe përbërja e keshillit e ndryshuar	Projektligji me ndryshimet e bëra është aprovuar në qeveri dhe aktualisht gjendet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. ¹¹⁹
9	KPSH dhe KP të nivelit themelor në bashkëpunim me njeri tjetrin krijojnë standarde të shkruara si rekomandime për propozimin e dënimeve, masave alternative dhe negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë	2022	KPSH	Hartimi i standardeve të shkruara si rekomandime për caktimin e dënimeve dhe negociimin e pranimit të fajësisë	Është nxjerrur Udhëzimi për Negocimin e Marrëveshjes për pranimin e fajësisë, i cili po zbatohet nga Prokuroria. ¹²⁰ Si dhe më parë është miratuar edhe Udhëzimi mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit. ¹²¹
18	Të miratohet ligji i posaçëm për procedurat në kontestet civile/komerciale me vlerë të vogël, me qëllim të ofrimit të procedurave më të shpejta dhe më pak të kushtueshme për qytetarët.	2022	MD, KGJK, Kuvendi i Kosovës	Ligji për Procedurat në Kontestet Civile/Komerciale me Vlerë të Vogël i miratuar.	Duke u zbatuar. Koncept Dokumenti është dërguar për miratim në Qeveri.
19	Të realizohet një anketë e përdoruesve të gjykatave dhe prokurorive në lidhje me nevojat e tyre për qasje në drejtësi, në përputhje me Udhëzimet e Rishikuara për Krijimin e Hartave Gjyqësore në Përkrahje të Qasjes në Drejtësi në një Sistem Gjyqësor të CEPEJ	2022	MD, KGJK, KPK	Anketa e realizuar; Rezultatet e anketës të publikura	Nuk ka zhvillime
20	Hartimi dhe vënia në dispozicion për publikun e informacioneve relevante në gjuhët zyrtare përmes një aplikacioni në telefona të mençur, në të cilin vihen në dispozicion informata si vendndodhja e gjykatës(ave) dhe prokurorive, disponueshmëria dhe orari i transportit publik, koha e seancave dëgjimore dhe informacione të ngjashme)	2022	KGJK, KPK	Aplikacioni i përfunduar dhe informatat lehtësisht të qassme për qytetarët	KGJK: KGJK ka të realizuar. Portali i KGJK ka edhe aplikacionin për pajisje mobile. Në portal janë prezente të gjitha të dhenat që duhen. KPK: Në ueb faqen e KPK, megjithatë janë vendosur të gjitha informacionet e vendodhjes së Prokurorive (adresat), si dhe janë publikuar nr. e tel. kujdestarë të prokurorëve sipas departamenteve. Po ashtu janë të vendosur edhe nr. e tel. të kujdestarisë së Zyrtarëve për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave si dhe të gjitha informacionet e nevojshme për publikun.

¹⁴⁶ <https://anjf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,%202,179>

<https://anjf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,%202,183>

<https://anjf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,%202,196>

<https://anjf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,%202,198>

<https://anjf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,%202,205>

<https://anjf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,%202,210>

¹⁴⁷ <https://anjf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,%202,206>

21	Hartimi dhe vënia në dispozicion për publikun e informacioneve relevante në gjuhët zyrtare përmes materialeve promovuese si broshura dhe postera, të cilat përmbajnë informata si vendndodhja e gjykatës(ave) dhe disponueshmëria dhe orari i transportit publik, me qëllim të ofrimit të informacioneve publike dhe lehtësisht të qasshme për qytetarët.	2022	KGJK, KPK	Materialet e publikuara dhe informatat lehtësisht të qasme për qytetarët	KGJK: Me qëllim të ofrimit të informacioneve publike dhe të qasshme për qytetarët, KGJK publikon informata në webfaqen zyrtare të gjyqësorit, rrjetin social Facebook si dhe platformën YouTube. Gjatë vitit 2023, deri më tani janë publikuar këto publikime për qytetarë:1. Video informuese për qytetarët: Rëndësia dhe efikasiteti i Gjykatës Komerciale në trajtimin e kontesteve komerciale linku: https://fb.watch/muYn5YdJ8x/ 2. Video informuese për Platformën online për nxjerrjen e certifikatës së gjendjes penale https://fb.watch/muYmTbv8N/ 3. Publikim infografikë lidhur me Zbatimin e reformave nën përgjegjësinë e KGJK-së sipas Planit Kombëtar për Integrim Evropian gjatë vitit 2022 linku i postimit 4. Publikim infografikë lidhur me përbushjen e Planit Vjetor të Punës për vitin 2023 linku i postimit Po ashtu, lidhur me vendndodhjen e gjyqtarëve, KGJK përditëson informatat e secilit gjyqtar varësisht se në cilën gjykatë ushtron funksionin, në faqen e secilës gjykatë, tek vegëza Për Gjykatën > Gjyqtarët > Në shërbim. KPK: Informatat për vendndodhjen e prokurorive janë të publikuara në web portalin e sistemit prokurorial.
22	Përditësimi i portalit 'Gjykata ime' me informacione thelbësore shtesë dhe të thjeshtëzuara për publikun, përfshirë informacionin juridik, shabllonet e dokumenteve që duhet të dorëzohen në gjykatë dhe udhëzimet tjera për publikun.	2021 - 2023	KGJK	Portali 'Gjykata ime' i përditësuar	Portali gjykata ime nuk është portal i KGJK dhe KGJK nuk merret me përditësimin. Ky portal është i Fakultetit Juridik dhe fakulteti duhet të merret me përditësimin e tij.
23	Përditësimi i faqeve të internetit të KPK me informata thelbësore dhe të thjeshtëzuara për publikun në gjuhët zyrtare, përfshirë informacionin juridik, shabllonet e dokumenteve që duhet të dorëzohen në gjykatë/prokurori dhe udhëzimet tjera për publikun.	2022	KPK	Faqe të internetit të azhuruara me informacione thelbësore për qytetarët; Faqet e internetit përmbajnë shabllone të dokumenteve	KPK-ja, më 27 korrik 2023, ka caktuar me vendim Zyrtarin Përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike të Sistemit Prokurorial, kurse nëpër prokurori këtë detyrë e kanë ushtruar zëdhënësit. KPK-ja është në proces të përgatitjes dhe hartimit të shtojcave për zbatimin e Rregullores nr.06.2023 për Qasje në Dokumente Publike, në kuadër të cilave hyjnë: vendimi për lejimin e qasjes në dokumente publike, vendimi për lejimin pjesërisht të qasjes në dokumente publike, vendimi për refuzimin e qasjes në dokumente publike dhe formularët e kërkesave për qasje në dokumente publike në tërë institucionet e sistemit prokurorial Po ashtu, janë të publikuar emrat e zyrtarëve të caktuar për sinjalizim në të gjitha prokuroritë e Kosovës.
24	Zhvillimi i një programi të trajnimit për përkthyes/interpretë të gjykatave për konceptet ligjore dhe Kodin e Etikës së Përkthyesve/Interpretëve me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve të përkthimit/interpretimit.	2022	AD, KGJK, KPK	Programi i trajnimit për përkthyesit/interpretët gjyqësor i zhvilluar;	Programi i trajnimit është zhvilluar dhe trajnimi është realizuar në muajin tetor 2023. ¹⁴⁸
25	Mbajtja e trajnimeve për përkthyes/interpretë të gjykatave për konceptet ligjore dhe Kodin e Etikës së Përkthyesve/Interpretëve	2022	KGJK	4 trajnime të mbajtura për përkthyesit/interpretët ligjor deri në vitin 2022	Ky aktivitet është perfunduar dhe trajnimet janë mbajtur: ¹⁴⁹
26	Themelimi i Njësie për Përkthyes në Gjykata me qëllim të menaxhimit të përkthyesve dhe prioritizimit të përkthimit të lëndëve	2022 - 2023	KGJK	4 njësi të themeluara gjatë vitit 2022 dhe 5 njësi gjatë vitit 2023	KGJK me datë 20 Qershor 2023 ka aprovuar kërkesat funksionale për zhvillimin e sistemit elektronik për menaxhimin e centralizuar të përkthimit për gjykata. Në vijim, KGJK do të angazhohet në krijimin e zyrës qendrore të përkthimit dhe me zhvillimin dhe implementimin e sistemit. Kurse në gjuhëstëmuojnë detyrë nuk ka pasur asnjë zhvillim në lidhje me këtë çështje.
27	Themelimi i Katedrës për Gjuhët Sllave në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës me qëllim të ofrimit të interpretëve/përkthyesve të kualifikuar dy-gjuhësor	2023	Fakulteti Filologjik, Komisioneri për Gjuhët	Katedra për Gjuhët Sllave në Fakultetin e Filologjisë, e themeluar dhe funksionale.	Nuk ka zhvillime.

¹⁴⁸ <https://ad.rks-gov.net/trajnim-per-perkthyes-dhe-interprete-gjyqesor-mbi-perdorimin-e-koncepteve-ligjore-dhe-doracakun-per-punen-e-perkthyesve-ne-gjykata>

¹⁴⁹ <https://www.gjyqesori-rks.org/2023/10/06/mbahet-trajnim-per-punen-e-perkthyesve-dhe-interpreteve-gjyqesore-ne-gjykata/>

28	Themelimi i një grupi punues për analizimin e kornizës kryesore ligjore në Republikën e Kosovës për të identifikuar mospërputhjet në versionet e ligjeve në gjuhët zyrtare si dhe për të bërë rekomandimet e nevojshme për t'i adresuar ato	2022	MD	Analiza e përfunduar; Rekomandimet e analizës të miratuara nga MD	Analiza është përfunduar me mbështetjen nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Analiza përfshin rekomandimet për ndryshim në verzionin e gjuhës serbe të Projektligjeve si në vijim: - Për Konfliktet Administrative; - Për Ekspertët Gjyqësor; - Për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës.
29	Të miratohet një ligj i veçantë për shpenzimet dhe tarifat gjyqësore me qëllim të ngritjes së transparencës në lidhje me shpenzimet për drejtësi.	2022	MD, KGJK, KPK	Ligji për shpenzimet dhe tarifat gjyqësore i miratuar.	Nuk ka zhvillime
30	Përditësimi i portaleve të institucioneve në mënyrë të ofrohen informacione të qarta dhe transparente në lidhje me llojet e mundësive të zgjidhjes alternative të kontesteve, kur ato janë të përshtatshme, shpenzimet dhe kohëzgjatja e tyre	2022	MD, KGJK, KPK	Faqe të internetit të përditësuara me informacione thelbësore për qytetarët	Webfaqja e Ministrisë së Drejtësisë është përditësuar me informacione për zgjidhjen alternative të kontesteve dhe me detajet specifike rreth tyre. ¹⁵⁰ KGJK-ja ka integruar në web faqen e saj linkun për ndërmjetësimin. ¹⁵¹ Po ashtu, në webfaqen e KPK-së janë të paraqitura mundësitë për ndërmjetësim në fushën penale. PSH ka nxjerrë dhe ka publikuar udhëzimin A.nr.360/16 lidhur me praktikën e ndërmjetësimit si procedurë alternative në rastet e dhunës në familje. ¹⁵² Po ashtu, në raportet gjashtëmujore dhe vjetore të PSH-së publikohen të gjitha statistikat lidhur me trajtimin e rasteve me procedura alternative.
31	Nënshkrimi i një Memorandumi të Mirëkuptimit në mes të ofruesve të ndryshëm të ndihmës juridike dhe sektorëve tjerë siç janë shëndetësia, shërbimet sociale, qendrat e punësimit dhe të tjera, me qëllim të krijimit të rrjetit të bashkëpunimit në ofrimin e ndihmës juridike, këshillave dhe informacioneve për opsionet e zgjidhjes së kontesteve dhe krijimit të rrjeteve të referimit.	2022	MD, KGJK, KPK, OAK, Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës, sektor të tjerë.	Memorandumi i Mirëkuptimit i lidhur; rrjeti funksional i bashkëpunimit në mes të shërbimeve të ndryshme ligjore dhe drejtësisë.	Bashkëpunimi në mes të ANJF dhe institucioneve sociale shëndetësore dhe institucionet tjera relevante është i vazhdueshëm mirëpo duke pasur parasysh që zyrat rajonale janë kompetence e nivelit lokal është duke u shqyrtuar menyrë me e mirë e lidhjes se këtij Memorandumi. Mirëpo gjatë gjashtëmujorit të dytë nuk ka pasur asnjë zhvillim.
32	Hartimi i Strategjisë për Ndërmjetësimin në pajtim me Udhëzuesin e CEPEJ për Ndërmjetësimin nga Avokatët, me qëllim të rritjes së rolit të avokatëve në promovimin e ndërmjetësimin	2022	OAK	Strategjia e miratuar për Ndërmjetësim	Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur ndonjë zhvillim që lidhet me hartimin e një Strategjie për ndërmjetësim.
33	Promovimi i ndërmjetësimin nga avokatët, në përputhje me Strategjinë, përmes takimeve me përfaqësues të gjykatave, shërbimeve të ndërmjetësimin, Odën e Ndërmjetësuesve; komunikimi i koordinuar në mes të OAK dhe gjykatave në lidhje me informacionet e ndërmjetësimin; informacione të gatshme standarde për palët në lidhje me klauzolat e ndërmjetësimin, marrëveshjet model të ndërmjetësimin në mes të palëve dhe ndërmjetësuesve	2022 - 2023	OAK	Të paktën 2 takime të mbajtura në mes të OAK, avokatëve, përfaqësues të gjykatave, shërbimeve të ndërmjetësimin, Odën e Ndërmjetësuesve; komunikimi i koordinuar në mes të OAK dhe gjykatave në lidhje me informacionet e ndërmjetësimin; informacione të gatshme standarde për palët në lidhje me klauzolat e ndërmjetësimin, marrëveshjet model të ndërmjetësimin në mes të palëve dhe ndërmjetësuesve	Ashtu siç është theksuar në raportin 1 vjeçar të OAK-së, miratimi i Plan Programit të Trajnimeve ka bërë të mundur që OAK të mbaj trajnime me avokatë, në fushën e Ndërmjetësimin, me qëllim të arsimimit të vazhdueshëm ligjor të obliguar dhe promovimin e Ndërmjetësimin. Plani programi i trajnimeve për vitin 2023. • Trajnim i realizuar me datë 18.03.2023 • Trajnim i realizuar me datë 25.03.2023 • Trajnim i realizuar me datë 17.06.2023

¹⁵⁰ <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,27>

¹⁵¹ <https://www.gjyqesori-rks.org/ndermjetesimi/>

¹⁵² https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legislacioni/ANudhzAdmn/Nr.780.2016-UDHEZIM-Lidhur_me_rastet_e_dhunes_ne_familje-ZKPSH.pdf

34	Ndryshimi i Kodit të Etikës për Avokatët për të përfshirë obligimin për rekomandimin për avokatët për të marrë parasysh mjetet alternative të zgjidhjes së kontesteve, përfshirë ndërmjetësimin, para se të referohen palët në gjykatë, dhe dhënien e informacioneve dhe këshillave relevante për palët	2022	OAK	Kodi i Etikës për Avokatat i ndryshuar, i miratuar	Ndryshimet në aktet relevante nënligjore janë planifikuar pas procesit të ndryshimit të Ligjit për Avokatinë.
35	OAK të promovojë ndryshimet në Kodin e Etikës për Avokatët, për të nxitur përdorimin e ndërmjetësimit përmes klauzolave të ndërmjetësimit në kontrata dhe në këshillat për palët	2022	OAK	Numri i kontratave të hartuara nga avokatët që parashikojnë klauzola të ndërmjetësimit në kontrata është rritur; Avokatët këshillojnë palët për mundësinë e ndërmjetësimit të kontesteve të tyre	Nuk ka zhvillime specifike, megjithatë 25% të trajnimeve që ofrohen gjatë vitit tek avokatët lidhen me Kodin e Etikës Profesionale të Avokatëve.
36	Krijimi dhe zbatimi i programeve trajnuese individuale dhe të përbashkëta për avokatët mbi aftësitë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (veçanarisht ndërmjetësimin) me qëllim të rritjes së aftësive të avokatëve në fushën e ndërmjetësimin.	2021	OAK, KGJK, KPK, AD	Programi i trajnimit individual dhe të përbashkët në mes të OAK, KGJK, KPK dhe AD i themeluar dhe 1 trajnim/takim i përbashkët për rolin e ndërmjetësimin i mbajtur; ndërmjetësimi si modul i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm ligjor për avokatët, i krijuar.	OAK ka ofruar trajnime për avokatët në fushën e zgjidhjes alternative të kontesteve, ku 3 prej tyre janë organizuar për Ndërmjetësimin, ndërsa 2 janë organizuar për çështjet e Arbitrazhit. Trajnimi për Arbitrazh me datë 27.05.2023; ¹⁵³ Trajnimi për Arbitrazh me datë 24.06.2023; ¹⁵⁴ Këto trajnime bazohen në plan programin e trajnimeve me qëllim të avancimit të mëtejshëm të njohurive të avokatëve mbi këto fusha.
37	Mbajtja e trajnimeve individuale dhe të përbashkëta për avokatët mbi aftësitë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (veçanarisht ndërmjetësimin) me qëllim të rritjes së aftësive të avokatëve në fushën e ndërmjetësimin.	2021	OAK, KGJK, KPK, AD	2 trajnime/takime individuale dhe të përbashkëta për rolin e ndërmjetësimin	Gjatë kësaj periudhe kohore janë organizuar dhe mbajtur 3 trajnime në fushën e Ndërmjetësimin dhe 2 trajnime për Arbitrazhin.
38	Hartimi i Ligjit për Kontestet Administrative	2022	MD, KGJK	Miratimi i Ligjit për Kontestet Administrative	Ligji Nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative është miratuar në Kuvend me datën 14.12.2023. ¹⁵⁵
<i>Masa e Politikës: Përmirësimi i qasjes në drejtësi për personat dhe grupet e cenuara</i>					58% zbatuar plotësisht
39	Miratimi i vendimit për kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së fondeve shtesë për strehimoret për viktimat e dhunës në baza gjinore.	2022	MD, Qeveria e RK	Vendimi i miratuar	Më 23 nëntor 2022 Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 500,000.00Eur (pesëqind mijë euro) për Organizatat joqeveritare të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, përfshirë edhe strehimore për mbrojtjen e viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, zbatimi i të cilit ka filluar në periudhën Janar-Prill 2023. Në maj 2023, MD ka hapur thirrjen publike për mbështetje financiare për subjektet juridike dhe organizatat jo-qeveritare të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare për periudhën maj-dhjetor 23-Shkurt 24. Krahas thirrjes publike të MD-së, më 15/03/23 është themeluar komisioni për vlerësim e projekteve për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara nga në fushën e shërbimeve sociale, ku pas aplikimit të 49 subjekteve juridike (strehimore, OJQ) kanë përfituar 41 nga të cilat 10 strehimore. Nga buxheti i MD-së periudha maj - dhjetor 2023/ shkurt 2024 vlera e financimit të strehimoreve është 692,000 Euro (gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy mijë euro). Në kuadër të vendimit të Qeverisë, vlera e buxhetit për subjektet juridike/OJQ është rritur nga 1,000,000 Eur (një milion euro), në 1,500,000 Eur (një milion e pesëqind mijë euro).
40	Zgjerimi i mandatit të mekanizmit koordinues në mes të institucioneve gjyqësore dhe jo-gjyqësore për të luftuar	2021	MD	Vendimi i Qeverisë për zgjerim të kompetencave të mekanizmit koordinues për dhunë në familje, i miratuar	Ministria e Drejtësisë ka formuar grupin punues për hartimin e Projekt Rregulloren për mekanizmat lokal për Mbrojtje nga Dhuna ne Familje, Dhuna ndaj grave dhe Dhuna ne baza gjinore Programit për procedurat

¹⁵³ <https://oak-ks.org/lajmi/3843>

¹⁵⁴ <https://oak-ks.org/lajmi/3874>

¹⁵⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2707>

	dhunën me bazë gjinoren, në kuadër të MD-së				standard të veprimit, që rrjedhin nga Ligji nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj grave dhe Dhuna në baza gjinore.
41	Krijimi i mekanizmit për mbështetje të Zyres së Koordinatorit Nacional	2022	MD	Mekanizmi i krijuar	Ministria e Drejtësisë ka filluar procedurat e rekrutimit për Mekanizmin mbështetës të Zyres së Koordinatorit.
42	Harmonizimi dhe përditësimi i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) që adresojnë forma të ndryshme të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore me qëllim të reagimit dhe ndërhyrjes së përmirësuar	2022	MD	PSV të përditësuara, të harmonizuara dhe të miratuara.	Ministria e Drejtësisë ka formuar grupin punues për hartimin e Programit për procedurat standarde të veprimit, që rrjedhin nga Ligji nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj grave dhe Dhuna në baza gjinore.
43	Të miratohet vendimi për analizim vjetor të vendimeve gjyqësore në lidhje me rastet e dhunës në familje dhe me bazë gjinore për të vlerësuar nëse vendimet janë në përputhje me Udhëzimeve për Dënime në Kosovë.	2021 - 2023	KGJK	Vendimi i miratuar i KGJK-së; Numër i konsiderueshem i vendimeve gjyqësore të rishikuara gjyqësore në baza vjetore; Diskutimi i raportit të vlerësimit në KGJK	Nuk ka zhvillime.
44	Të miratohet vendimi për analizim vjetor të aktakuzave në lidhje me rastet e dhunës në familje dhe me bazë gjinore për të vlerësuar nëse propozimet e dënimeve dhe masave marrin në konsideratë Udhëzimet për Dënime në Kosovë.	2021 - 2023	KPK	Vendimi i miratuar i KPK-së; Numër i konsiderueshem i aktakuzave të rishikuara gjyqësore në baza vjetore; Diskutimi i raportit të vlerësimit në KPK	Nuk ka zhvillime.
45	Analizimi i SMIL për të parë nëse përfshihen të dhënat e nevojshme për të monitoruar dhe raportuar lëndët e krimeve kundër komunitetit LGBTIQ+ dhe reflektimi i rekomandimeve të kësaj analize në SMIL për të mundësuar monitorimin e hetimit, ndjekjes penale dhe dënimit të krimeve kundër komunitetit LGBTIQ+.	2022	ZQM, PK, KPK, KGJK, OAK	SMIL përmbanë dhe gjeneron të dhëna specifike për lëndët që kanë të bëjnë me krimet kundër komunitetit LGBTIQ+.	KPK-ja në SMIL regjistron të gjitha lëndët me të dhënat e detajuara përfshirë edhe veprimet e prokurorëve. I kryer, Në SMIL është bërë obligative plotësimi i fushës që cakton motivin e veprës penale. Në sistem tash është e mundur të grumbullohen të dhënat për LGBTIQ+ dhe motivet e tjera dhe keto të dhëna mund të nxjerren nga sistemi për qëllime statistikore.
46	Hartimi i programeve të specializuara të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë në lidhje me natyrën gjinore të akteve të dhunshme ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, dhe zbatimin e Udhëzimeve për Dënime në Kosovë	2021 - 2023	AD, KGJK, KPK	Programi i trajnimit të specializuar hartuar	Në gjashtëmujorin e dytë kjo kurrikulë trajnuese edhe njëherë iu ka nënshtruar rishikimit dhe e njëjta në mbështetje të ekspertëve të Këshillit të Evropës është ridizajnuar dhe përmbanë 4 module trajnimi të cilat kanë për bazë standardet e Konventës së Stambollit si për aspektin civil të dhunës në familje ashtu edhe në aspektin penal. Kjo kurrikulë trajnuese pritet të zbatohet gjatë vitit 2024.
47	Zbatimi i programeve të specializuara të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë në lidhje me natyrën gjinore të akteve të dhunshme ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, dhe zbatimin e Udhëzimeve për Dënime në Kosovë	2022 - 2023	AD, KGJK, KPK	4 trajnime të specializuara për gjyqtarët dhe prokurorët dhe avokatët	Edhe në gjashtëmujorin e dytë janë realizuar trajnime në fushën e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Me 31 gusht ka qenë Vlerësimi i rrezikshmërisë së rasteve të dhunës në familje. Me 5 shtator-1. Akuzimi dhe dënimi i rasteve të dhunës në familje. Me 26 tetor viktimat e dhunës seksuale. Me 24 nëntor 2023 trajnimi me temë: Trajnimi për Dhunën në Familje dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. ¹⁵⁶

¹⁵⁶ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet?month=8&year=2023> dhe në buletin informativ sipas muajve dhe datave të trajnimit: <https://ad.rks-gov.net/sq/buletini-informativ>

48	Zhvillimi i programeve të specializuara të trajnimeve sistematike për stafin e institucioneve përkatëse që kanë kompetenca për luftimin e dhunës në baza gjinore	2022	Koordinatori Kombëtar për Dhunën në Familje	Programi i trajnimit sistematik hartuar	Me organizim të Akademisë së Drejtësisë, Programi i Trajnimit është hartuar. ¹⁵⁷ Gjithashtu janë organizuar dy sesione të trajnimit 'Luftimi dhe parandalimi i dhunës ndaj grave/dhunës në familje', i zhvilluar në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Evropës. ¹⁵⁸ Për më shumë janë organizuar edhe trajnime të tjera për profesionistët e përfshirë, saktësisht me 29.11, 30.11 dhe 01.12.2023, tema 'Konventa e Stambollit: Forcimi i zbatimit në përfundimin i dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore'. ¹⁵⁹
49	Zbatimi i programeve të specializuara të trajnimeve sistematike për stafin e institucioneve përkatëse që kanë kompetenca për luftimin e dhunës në baza gjinore	2023	Koordinatori Kombëtar për Dhunën në Familje	4 trajnime të veçanta dhe të përbashkëta për stafin e institucioneve përkatëse që kanë kompetenca në fushën e luftës kundër dhunës në baza gjinore	Në kuadër të trajnimeve të specializuara, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe partnerët strategjike kanë organizuar trajnime të specializuara me institucionet përgjegjëse. Temë e këtyre trajnimeve është adresimi i ngacmimeve seksuale, trajtimi i rasteve të dhunimeve seksuale sipas Protokollit Shtetëror, trajnime për metodologjinë e raportimit për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe trajnime me Mekanizmin Koordinues Lokal dhe Strehimoret për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Po ashtu në kuadër të trajnimeve të specializuara, në bashkëpunim me EULEX-in, janë organizuar trajnime në nivel vendi me akterë përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunimeve seksuale. Këto trajnime janë organizuar me prokuroritë, gjykatat, mbrojtësit e viktimave, Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe Institutin e Psikiatrisë Forenzike. Trajnimet e veçanta janë: 1. Protokollin Shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunimeve seksuale 2. Trajnime për adresimin e ngacmimeve seksuale në institucionet shtetërore 3. Konventa e Stambollit dhe roli i Mekanizmit Koordinues Lokal. 4. Raportimi në monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Gruas. Trajnimet e organizuara mbulojnë periudhën janar-qershor 2023.
50	Raportimi i vazhdueshëm dhe konsistent i të dhënave në Databazën e Integruar për Dhunën në Familje	2021 - 2023	MD, institucionet tjera	Databaza e përditësuar me të dhëna dhe publikimi i raporteve vjetore	Databazën për evidentimin e rasteve të dhunës në familje e përditësojnë me të dhëna gjithsejtë 497 përdorues, prej tyre: <ul style="list-style-type: none">● Gjykata – 216● Prokuroria – 30● Policia – 114● MV – 24● QPS – 101● Strehimoret – 12 Mirëpo me KGJK jemi në proces të ndërlidhjes së databazave, ku Ministria e Drejtësisë do të ketë mundësi të gjenerimit të të dhënave për rastet e dhunës në familje nga sistemi i Gjyqësorit (SMIL).

¹⁵⁷ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/ToT_Manual_ALB_.pdf

https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/ToT_Tool_ALB_.pdf

¹⁵⁸ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/10556>

<https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/16061>

¹⁵⁹ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/16036>

<https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/16049>

<https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/16053>

				<p>Ministria e Drejtësisë ne dhjetor të vitit 2023 ka publikuar në veb faqe të dhënat për rastet e dhunës në familje, si në vijim;</p> <p>Të dhënat e publikuara për vitet 2019-2023 janë të kategorizuara, si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Numri rasteve të dhunës në familje të raportuara në Polici, 2. Numri viktimave të dhunës në familje të kategorizuar sipas gjinisë, 3. Viktimat e dhunës në familje të kategorizuara sipas nacionalitetit, 4. Viktimat e dhunës në familje të kategorizuar sipas grupmoshave, 5. Numri kryesve të dhunës në familje të kategorizuar sipas gjinisë, 6. Kryesit e dhunës në familje të kategorizuara sipas nacionalitetit, 7. Kryesit e dhunës në familje të kategorizuar sipas grupmoshave, 8. Numri grave dhe fëmijëve të strehuar, 9. Viktimat e vrara të dhunës në familje, 10. Shqiptimi urdhërave për mbrojtje të përkohshme emergjente. <p>Databaza për trajtimin e kryesve të dhunës në familje, është zhvilluar në kuadër të databazës aktuale për evidentimin e rasteve të dhunës në familje me mbështetjen e UNDP, ndërsa lansimi i tij është bërë me 08.12.2023 nga Ministria e Drejtësisë.</p> <p>Në kuadër të databazës për evidentimin e rasteve të dhunës në familje tashmë janë të inkuadruara edhe Institucionet që mirren me trajtimin e kryesve të dhunës në familje, të cilat janë: Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës.</p> <p>Poashtu në kuadër të kësaj databaze aktuale është zhvilluar edhe moduli i Agjencionit për ndihmë juridike falas, që ka të bëjë direkt me shërbimet që ofrojnë për viktimat e dhunës.</p>
--	--	--	--	--

<i>Masa e Politikës: Bashkëpunim efektiv në mes të organeve jo gjyqësore dhe gjykatave dhe prokurorive</i>					<i>0% zbatuar plotësisht</i>
--	--	--	--	--	------------------------------

51	Kuvendi i Kosovës të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm procedural për të siguruar raportimin e MD, MPB, KGJK-së, KPK-së para Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Kosovës në lidhje me adresimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe veprimet e ndërmarra në përputhje me këto rekomandime, me qëllim	2022	Kuvendi i Kosovës, MD, MPB, KGJK, KPK	Të paktën një raportim nga secili institucion publikë në lidhje me adresimin e rekomandimeve të Institutit të Avokatit të Popullit	Nuk ka zhvillime.
----	---	------	---------------------------------------	--	-------------------

	të riçes së përgjegjësishë në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut.				
52	Themelimi dhe funksionalizimi i një mekanizmi koordinues në mes të IAP dhe organeve tjera jo-gjyqësore, administrative dhe të barazisë, me qëllim të përmirësimit të koordinimit ndër-institucional për mbrojtje më të mirë të të drejtave të njeriut, dhe ofrimin e shërbimeve më të mira ligjore për qytetarët.	2022	IAP, ABGj, organet tjera jo-gjyqësore, administrative, dhe organeve tjera të barazisë.	Mekanizmi koordinues i themeluar dhe funksional; 2 takime koordinuese në mes të akterëve	Nuk ka zhvillime.

Kapitulli 3.2 - Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit të mjeteve juridike

	Veprimi	Afati i fundit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Progresi në zbatim
Masa e politikës: Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për të siguruar mjete juridike efektive me shikim në shërbimet ligjore dhe të drejtësisë të orientuara kah qytetari					72% zbatuar plotësisht
1	Hartimi i analizës për format për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme për të përcaktuar mjete juridike efektive për çështjet që përfshijnë vonesa në procedurat gjyqësore, ku do të analizohen mundësi si ankesa në Gjykatën Kushtetuese, ankesa në gjykatën e shkallës më të lartë, mjetet juridike përshpejtuese dhe kompensuese dhe mjetet juridike specifike në fushën e gjyqësisë penale, si dhe kompetencat ligjore të Avokatit të Popullit për të filluar procedurë gjyqësore në rastet kur mjetet juridike janë joefektive, drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese	2022	MD, KGJK, KPK	Koncept Dokumenti për Mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme i miratuar.	Ky Koncept dokument është miratuar nga Qeveria me datën 29 .06.2023
2	Miratimi i Kodit të Procedurës Penale, në mënyrë që të avancohen të drejtat për informim dhe interpretim në fushën e gjyqësisë penale, në përputhje me standardet e BE-së, si dhe të bëhet mitja e numrit të mjeteve juridike në dispozicion dhe efektivitetit të shtuar të mjeteve juridike për mosfunksionimet e sistemit të drejtësisë lidhur me të drejtat e të pandehurve në procedurë penale	2021	MD	Kodi i ri i Procedurës Penale i miratuar	Kodi i Procedurës Penale është miratuar nga Kuvendi me datë 14.07.2022. ¹⁶⁰ Harmonizimi është bërë deri në masë të caktuar me Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për të drejtën në informim në procedurë penale. Gjithashtu, Neni 14(10) parasheh të drejtën e të pandehurit për ushtrimin e ankesës kundër vendimit me të cilin i mohohet përkthimi.
3	Ndryshimi i Kodit të Etikës për prokurorët për të sanksionuar si shkelje të rëndë disiplinore kufizimin e të drejtës për përfaqësim ligjor në çështjet penale	2022	KPK	Kodi i ndryshuar i Etikës për prokurorë i miratuar	Nuk ka zhvillime.
4	Miratimi i plotësim-ndryshimit të Kodit Penal për të adresuar specifikiisht kriminalizimin e keqtrajtimeve në stacionet e policisë, në qendra korrektuese dhe në qendrat e ndalimit	2023	MD	Ndryshim-plotësimi i Kodit Penal i miratuar	Ligji Nr. 08/L -188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës është miratuar në Kuvend me datë 26.10.2023 ¹⁶¹ dhe nuk është adresuar specifikiisht kriminalizimi i keqtrajtimeve në stacionet e policisë, në qendra korrektuese dhe në qendrat e ndalimit.

¹⁶⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>

¹⁶¹ (linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84232>)

5	Krijimi i mekanizmit të pavarur, të qasshëm dhe efektiv të ankesave lidhur me pretendimet e torturës dhe keqtrajtimin në stacione policore	2022	MPB	Mekanizmi i ankesave në stacione policore funksional	Pretendimet e torturës dhe keqtrajtimin në stacione policore hetohen nga Drejtoria për Standarde Profesionale dhe Inspektorati Policor, në bazë të ankesës. Policia ofron në çdo stacion formularët e ankesave. Gjithashtu në çdo stacion janë të vendosura kutitë e ankesave, në të cilat ka qasje vetëm Institucioni i Avokatit të Popullit, si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.
6	Krijimi i mekanizmit të pavarur, të qasshëm dhe efektiv të ankesave lidhur me pretendimet e torturës dhe keqtrajtimin në qendra të paraburgimit dhe qendra korrektuese	2022	SHKK	Mekanizmi i ankesave në qendra të paraburgimit dhe qendra korrektuese funksional	Udhëzuesi për trajtimin e ankesave është në fuqi. Gjithashtu në çdo qendër të paraburgimit dhe qendra korrektuese ka kuti të ankesave, në të cilat ka qasje vetëm Institucioni i Avokatit të Popullit, si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese. Mekanizmi i ankesave pra është funksional, të gjitha ankesat trajtohen dhe regjistrohen në regjistrat përkatës.
7	Prokurorët e shtetit dhe policia ofrojnë informata të detyrueshme për individët në lidhje me të drejtën e tyre për përfaqësim ligjor dhe pasojat e heqjes dorë nga kjo e drejtë	2021 - 2023	KPK, PSH, MPB, PK	Raportet dhe procesverbalet e Policisë dhe Prokurorisë theksojnë ofrimin e informatave	Prokurori i Shtetit është i obliguar që çdo herë t'i njofton palët lidhur me të drejtat e tyre në procedurë penale. Kjo zbatohet në mënyrë të rregullt.
8	Hartimi i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për përcaktimin e dispozitave ligjore që garantojnë : a) të drejtën për mjekë, vizita të rregullta dhe të shpeshta të monitorimit mjekësor në të gjitha qendrat korrektuese dhe të ndalimit; b) përmirësimin e mekanizmit të ankesave të personave në ndalim pas shpalljes së dënimit (në aspektin ligjor dhe praktik); c) sigurojnë një sistem të qasshëm, tërësisht të pavarur, ekspeditiv dhe efektiv të ankesave	2021	MD	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale i miratuar	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale është miratuar nga Kuvendi me datë 14.07.2022. ¹⁶² Neni 46 i rregullon vizitat dhe kontrollimet mjekësore. Nenet 12, 24, 28, 57(7), 90, 93, 96, 107, 108, 117 dhe 135 rregullojnë të drejtën e ankesës për çështje të ndryshme, gjegjësisht procedurën për trajtimin e tyre.
9	Hartimi dhe detajimi i Letrës së të Drejtave, me informacionet përkatëse për personat e dyshuar dhe të akuzuar në përputhje me standardet evropiane	2021	Policia e Kosovës	Letra me informacionet mbi të drejtat e personave të miratuar dhe shpërndarë në të gjitha stacionet policore, si dhe e qasshme për çdo të dyshuar dhe akuzuar	Është hartuar Formulari i të Drejtave të Njeriut, me informacionet përkatëse për personat e dyshuar dhe të akuzuar në përputhje me standardet evropiane. Gjatë periudhës Korrik -Dhjetor u është shpërndarë 2913 personave.
10	Ngritja e transparencës së operacioneve të SHKK-së në lidhje me trajtimin e shkeljeve nga personeli në qendrat korrektuese dhe të ndalimit.	2021 - 2023	MD, SHKK	Raporti vjetor i SHKK përmban informacion lidhur me trajtimin e shkeljeve	Raporti i vitit 2023 ka përfshirë numrin e shkeljeve disiplinore nga ana e stafit dhe masat e ndërmarrura. ¹⁶³
11	Përmirësimi i sistemit të ruajtjes dhe azhurmimit të regjistrave në SHKK lidhur me personat e paraburgosur.	2022	MD, SHKK	Sistemi i ruajtjes dhe azhurmimit të regjistrave në SHKK funksional.	Problemet me regjistrat e të paraburgosurve janë tejkaluar dhe tani sistemi aktual është funksional dhe efikas.
12	Funksionalizimi i regjistrimeve elektronike (audio dhe / apo video, preferencialisht) të intervistave policore në të gjitha stacionet e policisë	2022	MPB, Policia e Kosovës	Të gjitha intervistat dhe marrjet në pyetje në stacionet policore në Kosovë, të regjistruara si audio dhe video.	Ky është proces gradual dhe Policia e Kosovës është vazhdimisht duke funksionalizuar kamera të reja në vendet e ndalimit. Gjendja aktuale është si në vijim: Stacioni Policor Vushtrri Po-Funksionale - Stacioni Policor Skenderaj Po-Funksionale - Rajoni i Mitrovicë së Veriut Stacioni Policor Mitrovicë e Veriut Po-Funksionale - Stacioni Policor Leposaviq Po-Funksionale

¹⁶² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61303>

¹⁶³ [https://shkk.rks-gov.net/raporte/ \(faqe 18\)](https://shkk.rks-gov.net/raporte/(faqe%2018))

				<ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor Zveçan Po-Jo Funksionale (Qendra ndalimit - jo funksionale) Rajoni i Pejës: <ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor Pejë Po-Funksionale - Stacioni Policor Istog Po-Funksionale - Stacioni Policor Klinë Po-Funksionale - Stacioni Policor Deçan Po-Funksionale Rajoni i Prizrenit: <ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor Prizren Po-Funksionale - Stacioni Policor Suharekë Po-Funksionale - Stacioni Policor Dragash Po-Funksionale Rajoni i Ferizajt: <ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor Ferizaj Po-Funksionale - Stacioni Policor Kaçanik Po-Funksionale Rajoni i Gjilanit: <ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor Gjilan Po-Funksionale - Stacioni Policor Viti Po-Funksionale - Stacioni Policor Ranillug Po-Funksionale - Stacioni Policor Partesh Po-Funksionale Rajoni i Gjakovës: <ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor Gjakovë Po-Funksionale - Stacioni Policor Rahovec Po-Funksionale - Stacioni Policor Malishevë Po-Funksionale Policia Kufitare <ul style="list-style-type: none"> - PKK Gllloboqicë ka dhomë ndalim – kamera funksionale. - DRPK Perendimi: PKK Qafa e Prushi ka dhomë ndalimi – kamera funksionale; - PKK Qafa e Morinës ka dhomë ndalimi – kamera funksionale; - PKK Merdare ka dhomë ndalimi - kamera funksionale; - PKK Mutivodë ka dhomë ndalimi – kamera funksionale; - DRPKV (Lluzhan)ka dhoma ndalimi – kamera funksionale
13	Funksionalizimi i kamerave në të gjitha vendet e ndalimit në menaxhim të Policisë së Kosovës	2022	Policia e Kosovës	<p>Në të gjitha vendet e ndalimit kamerat e instaluar dhe funksionale.</p> <p>Ky është proces gradual dhe Policia e Kosovës është vazhdimisht duke funksionalizuar kamera të reja në vendet e ndalimit. Gjendja aktuale është si në vijim: Rajonet /Stacionet- kamera të vendosura: Rajoni i Prishtinës: <ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor Prishtinë Qendër Po - Funksionale - Stacioni Policor Podujevë Po - Funksionale - Stacioni Policor Lipjan Po - Funksionale - Stacioni Policor Obiliq Po - Funksionale - Stacioni Policor Graçanicë Po - Funksionale - Stacioni Policor Drenas Po - Funksionale Rajoni i Mitrovicës së Jugut: <ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor Mit. e Jugut Po-Funksionale - Stacioni Policor Vushtrri Po-Funksionale - Stacioni Policor Skenderaj Po-Funksionale - Rajoni i Mitrovicë së Veriut Stacioni Policor Mitrovicë e Veriut Po-Funksionale - Stacioni Policor Leposaviq Po-Funksionale - Stacioni Policor Zveçan Po-Jo Funksionale (Qendra ndalimit - jo funksionale) Rajoni i Pejës: <ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor Pejë Po-Funksionale - Stacioni Policor Istog Po-Funksionale - Stacioni Policor Klinë Po-Funksionale - Stacioni Policor Deçan Po-Funksionale Rajoni i Prizrenit: <ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor Prizren Po-Funksionale - Stacioni Policor Suharekë Po-Funksionale </p>

					<ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor Dragash Po-Funksionale Rajoni i Ferizajt: - Stacioni Policor Ferizaj Po-Funksionale - Stacioni Policor Kaçanik Po-Funksionale Rajoni i Gjilanit: - Stacioni Policor Gjilan Po-Funksionale - Stacioni Policor Viti Po-Funksionale - Stacioni Policor Ranillug Po-Funksionale - Stacioni Policor Partesh Po-Funksionale Rajoni i Gjakovës: - Stacioni Policor Gjakovë Po-Funksionale - Stacioni Policor Rahovec Po-Funksionale - Stacioni Policor Malishevë Po-Funksionale Policia Kufitare - PKK Gilloboqicë ka dhomë ndalim – kamera funksionale. - DRPK Perendimi: PKK Qafa e Prushi ka dhomë ndalimi – kamera funksionale; - PKK Qafa e Morinës ka dhomë ndalimi – kamera funksionale; - PKK Merdare ka dhomë ndalimi - kamera funksionale; - PKK Mutivodë ka dhomë ndalimi – kamera funksionale; - DRPKV (Lluzhan)ka dhoma ndalimi – kamera funksionale
14	Instalimi i vazhdueshëm i kamerave në qendrat nën menaxhim të SHKK.	2021 - 2023	SHKK	Numri i rritur i kamerave të instaluar dhe funksionale.	Nga kontrata servisim dhe mirëmbajtja e sistemit të kamerave janë instaluar dhe riparuar: QK- Dubravë: 02, QK-Lipjan:10, QP –Prishtinë: 3, QP-Prizren:05, QK-Smrekonice:02, QP-Gjilan: 21, QP-Mitrovicë:7. Është nënshkruar kontrata për aktivitetin Instalimi i kamerave të sigurisë në QK Dubravë (numri i kamerave që do instalohen është 176 copë).
15	Përkthimi në mënyrë sistematike i praktikës të përzgjedhur gjyqësore të GJEDNJ-së	2021 - 2023	ADK	Praktika gjyqësore e përzgjedhur e KEDNJ-së e botuar, e publikuar dhe e shpërndarë në të gjitha gjykatat dhe zyrat e prokurorisë.	Ashtu siç edhe është potencuar në raportimet paraprake, AD vazhdon të ofrojë qasjen në vendimet e GJEDNJ-së përmes HUDOC. Përveq kësaj përmes trajnimeve të realizuara për praktikën gjyqësore të KEDNJ vazhdon të promovojë standardet e të drejtave të njeriut për të gjithë përfutuesit e saj sipas ligjit.
16	Krijimi i listës së pavarur institucionale për zgjedhjen dhe emërimin e avokatëve të certifikuar të mbrojtjes "ex officio", për t'i siguruar standardet minimale të ekspertizës, të përvojës dhe të sjelljes për avokatët mbrojtjes në çështjet penale	2022	MD dhe OAK	Lista me avokatët mbrojtës në përfaqësim ligjor e publikuar.	Ekziston lista e avokatëve të cilët ofrojnë shërbime juridike në rastet sipas detyrës zyrtare 24/7, lista është e pavarur dhe menaxhohet nga i gjithë ky proces nga Zyra Koordinuese e cila është funksionale në 24 orë në çdo ditë të vitit, për nevoja të Policisë, Prokurorisë, Gjykatës dhe institucioneve relevante për këto çështje.
17	Ndryshimi i kornizës legislative për vendosjen e kriterëve të kualifikimit për avokatët mbrojtës të caktuar "ex officio" në çështje të ndërlikuara dhe të rënda penale	2022	OAK	Miratimi i kriterëve të kualifikimit dhe publikimi i tyre	Sa i përket kësaj çështje, lënda është në gjykatën e Apelit dhe jemi në pritje të vendimit, për sa i përket pezullimit të Rregullores e cila i kishte paraparë kriteret e tilla.
18	Përditësimi i listës së avokatëve mbrojtës që caktohen "ex officio" në raste të ndërlikuara dhe të rënda penale, me informacione lidhur me pajtueshmërinë individuale të secilit me kriteret e paracaktuara të kualifikimit.	2022	OAK, MD	Lista e avokatëve mbrojtës e publikuar	Lista e avokatëve është publike dhe kanë qasje secili në webfaqen e OAK-së. Po ashtu edhe avokatët e angazhuar publikohen në kohë reale, por edhe në formë të përmbljedhjes së raportit në baza javore në webfaqen e OAK-së.

Kapitulli 3.3 - Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve nga profesionet e lira

	Veprimi	Afati i fundit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Progresi në zbatim
<i>Masa e politikës: Zhvillimi i mëtejshëm dhe konsolidimi i ndërmjetësimit dhe procedurave të falimentimit</i>					62% zbatuar plotësisht
1	Miratimi i aktit nënligjor për tarifën e ndërmjetësuesve	2021	MD	Akti nënligjor për tarifën e ndërmjetësuesve i miratuar	Udhëzim Administrativ MD-Nr. 4/2021 për tarifën e ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës, është nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë, më datë 07.12.2021.
2	Miratimi i aktit nënligjor për vetë-inicimin e procedurës së ndërmjetësimit	2021	MD	Akti nënligjor për vetë-inicimin e procedurës së ndërmjetësimit i miratuar	Udhëzimi Administrativ 04/2021 për Tarifën e ndërmjetësuesve është miratuar nga Ministria dhe publikuar në Gazetën Zyrtare në Dhjetor 2021. ¹⁶⁴
3	Pajisja e Odës së Ndërmjetësuesve me mjetet e nevojshme (përfshirë infrastrukturën) me qëllim të funksionalizimit të saj.	2022	MD	Zyra, stafi dhe e tërë infrastruktura përcjellëse e Odës së Ndërmjetësuesve e kompletuar dhe funksionale	Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2022 ka mbështetur Odën e Ndërmjetësuesve me infrastrukturë dhe materiale përcjellëse të zyrës së Odës. Gjithashtu me mbështetje të Projektit të Drejtësisë Komerciale (USAID) është siguruar angazhimi i një praktikanti për mbështetje të funksionimit të zyrës së Odës, në drejtim të fuqizimit dhe krijimit të stafit permanent në të ardhmen.
4	Themelimi dhe funksionalizimi i një mekanizmi koordinues, i zbatueshëm dhe fleksibil, ndërmjet autoriteteve përkatëse shtetërore me qëllim të diskutimit të mundësive të funksionalizimit të hapësirave të ndërmjetësimit në gjykata dhe prokurori.	2022	MD, KGJK, KPK, ONK	Mekanizmi koordinues i themeluar dhe funksional: 2 takime të mbajtura; zyre funksionale të ndërmjetësimit në gjykata dhe prokurori	Në nivel të gjykatave themelore janë krijuar gjithsej 16 hapësira të ndërmjetësimit. Të gjitha gjykatat kryesore kanë hapësira për ndërmjetësim dhe pothuajse të gjithë degët (përveç Kamenicës, Vushtrisë, Suharekës, Dragashit dhe Graçanicës. Gjithashtu në të gjitha prokuroritë themelore janë krijuar hapësirat për ndërmjetësim.
5	Ndërmarrja e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes për rolin e ndërmjetësimit në mesin e profesionistëve dhe publikut të gjerë me qëllim të rritjes së përdorimit të ndërmjetësimit.	2021 - 2023	MD, ONK, KGJK, KPK	1 video produksion dhe transmetimi i tij në kanale televizive, si dhe tabela reklamuese dhe reklama në portale, uebfaqe të MD-së dhe rrjetet sociale të realizuara, për çdo vit.	Gjatë vitit 2021 dhe 2022 MD ka promovuar rolin e ndërmjetësimit. Në mënyrë specifike është organizuar Java e Ndërmjetësimit me aktivitete të ndryshme në vitin 2021 si dhe janë shfaqur spote televizive (RTK) për ndërmjetësimin, por edhe është bërë promovimi i ndërmjetësimit në faqen e facebook të Ministrisë dhe Odës së Ndërmjetësuesve. Poashtu, me mbështetjen e Programit të Drejtësisë Komerciale janë angazhuar 10 trajnerë për organizimin e aktiviteteve vetëdijësuese, ku gjithsej janë mbajtur 24 sosh për profesionistët gjyqësorë, organizatat jo-qeveritare dhe publikun në përgjithësi. Poashtu është mbajtur java e ndërmjetësimit, ku janë shpërndarë broshura nëpër komuna, janë mbajtur takime me qytetarë me qëllim të informimit lidhur me shfrytëzimin e ndërmjetësimit. Poashtu në web-faqen e MD-së dhe rrjetet sociale të saj, vazhdimisht është promovuar ndërmjetësimi. ¹⁶⁵
6	Themelimi i një grupi koordinues në mes të MD dhe MTI për analizimin e legjislacionit në fushën e falimentimit.	2021	MD, MTI	Koncept Dokumenti për fushën e falimentimit i miratuar	Koncept Dokumenti për Falimentimin është miratuar nga Qeveria me Vendimin nr. 16/99 të datës 30.09.2022. ¹⁶⁶
7	Hartimi i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Falimentimin me qëllim të largimit të pengesave aktuale të zbatimit të tij në	2022	MD, MTI	Ndryshimi i Ligjit për Falimentimin i miratuar	Projektligji për Falimentimin është shqyrtuar në parim me datën 19.10.2023. Ky aktivitet planifikohet të zbatohet pas miratimit të Ligjit të ri për Falimentimin.

¹⁶⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51213>

¹⁶⁵ <https://www.facebook.com/MinistriaeDrejtësisë/posts/pfbid0NXprL295PXodC7aGzCCdXk8NUsv7PihjhVR5LaGnU7h46zyMs4EnZD2UQeKsVWPVlhttps://fb.watch/jiAGDB0RVg/>

¹⁶⁶ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/11-Koncept-Dokumenti-per-Fushen-e-Falimentimit.pdf>

	praktikë, mbrojtës më të mirë të interesave të kreditorëve, mundësive të shtuara për debitorët (bizneset) që të rikthehen në treg përmes ri-organizimit, dhe ofrimin e bazës ligjore për themelimin e Odës së Administratorëve të Falimentimit.				
8	Miratimi i Statutit të ri të Odës së Administratorëve Falimentues, në bazë të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Falimentimin.	2022	OAF	Statuti i ri i Odës së Administratorëve të Falimentimit i miratuar	Projektligji për Falimentimin është shqyrtuar në parim me datën 19.10.2023. Ky aktivitet planifikohet të zbatohet pas miratimit të Ligjit të ri për Falimentimin.
9	Pajisja e Odës së Administratorëve të Falimentimit me mjetet e nevojshme (përfshirë infrastrukturën) me qëllim të funksionalizimit të saj.	2022	MD	Zyra së bashku me tërë infrastrukturën përcjellëse e Odës së Administratorëve të Falimentimit e kompletuar dhe funksionale	Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme ka siguruar zyrat për Odën e Administratorëve Falimentues, si dhe inventarin dhe pajisjet e nevojshme për funksionalizimin e zyrës së OAFK.
10	Përgatitja dhe zbatimi i aktiviteteve të rregullta për ngritjen e vetëdijes për procedurat e falimentimit dhe rolin e administratorëve të falimentimit në këto procedura, brenda sistemit të drejtësisë dhe për publikun.	2021 - 2023	MD, OAFK, Odat afariste	1 video produksion dhe transmetimi i tij në kanale televizive, si dhe tabela reklamuese dhe reklama në portale, uebfaqe të MD-së dhe rrjete sociale të realizuara, për çdo vit.	Ky aktivitet planifikohet të zbatohet pas miratimit të Ligjit të ri për Falimentimin. Projektligji për Falimentimin është miratuar në lexim të parë nga Kuvendi me datën 19.10.2023
11	Krijimi dhe zbatimi i një sistemi të përshtatshëm dhe uniform i mbledhjes së të dhënave për performancën e sistemit të përbarimit, me qëllim të krijimit të një pasqyre më të mirë dhe më të qartë për performancën e sistemit dhe trendet e përgjithshme të regjistruara, që lejojnë vendimarrjen më mirë të informuar.	2021	MD, OPPK, KGJK	Sistemi uniform i mbledhjes së të dhënave për performancën e sistemit të përbarimit i krijuar dhe i zbatueshëm.	Ky sistem është lansuar zyrtarisht por nuk ka filluar të zbatohet, sepse Oda e Përbaruesve për perdorimin e këtij sistemi ka kërkuar të ketë ndryshime ligjore.
12	Marrja e vendimit për rekrutimin e 20 përbaruesve privat shtesë me qëllim të një shpërndarje më të mirë gjeografike të shërbimeve të përbarimit.	2022	MD	20 përbarues privat të ri të rekrutuar.	Shpallja publike për dhënien e provimit për përbaruesve privat është bërë nga Ministria e Drejtësisë me datë 27 prill 2022. Me datën 23.07.2022 e kanë dhënë provimin për përbarues privat 13 kandidatë, prej të cilëve 4 kanë filluar ushtrimin e veprimtarisë së përbaruesit në Dhjetor 2022. 2 të tjerë pritet të fillojnë veprimtarinë në vitin 2023. Gjatë vitit 2023 planifikohet shpallje e re për emërim.
13	Marrja e vendimit për rekrutimin e 10 përbaruesve privat shtesë me qëllim të një shpërndarje më të mirë gjeografike të shërbimeve të përbarimit.	2023	MD	10 përbarues privat të ri të rekrutuar.	Në janar dhe shkurt të vitin 2023 - 2 përbarues privat kanë filluar veprimtarinë përbarimore. Në dhjetor të 2023, janë betuar 3 përbarues privatë.
<i>Masa e politikës: Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve për të gjitha profesionet e lira ligjore</i>					21% zbatuar plotësisht
14	Hartimi i Koncept Dokumentit për Procedurën Përbarimore	2022	MD	Koncept Dokumenti i miratuar	Lidhur me këtë Koncept Dokument, pas diskutimeve dhe analizave nga Grupi punues kanë ardhur në perfundim që fusha e përbarimit të trajtohet në kuadër të Koncept Dokumentit për Procedurën Civile (KPC), pasi që kjo fushë është një segment i saj. Prandaj, ky KD është shkruar në KD për KPC, i cili aktualisht është në fazën e finalizimit.
15	Ndërmarrja e një analize gjithëpërfshirëse të nevojave të trajnimit, duke marrë parasysh vlerësimet e mëhershme të ngjashme në lidhje me shkathësitë ligjore, administrative dhe teknike të profesioneve të lira.	2021	MD, OPPK, ONK, Oda e Ndërmjetësuesve, OAFK	Lista e nevojave të trajnimit, e miratuar	Nuk ka zhvillime.

16	Hartimi i kurrikulave të trajnimit fillestar, të vazhdueshëm dhe të specializuar për ndërmjetësuesit, me qëllim të rritjes së nivelit të njohurive dhe shkathhtësive dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve të tyre.	2021	MD, Oda e Ndërmjetësuesve	Kurrikulat e trajnimit fillestar, të vazhdueshëm dhe të specializuar të miratuara.	Drafti i kurrikulave ka kaluar fazën e konsultimeve dhe ndodhet në Departamentin Ligjor të MD
17	Organizimi i trajnimeve fillestare, të vazhdueshme dhe të specializuara për ndërmjetësuesit, në bazë të kurrikulave të miratuara	2022 - 2023	MD, Oda e Ndërmjetësuesve	2 trajnime të mbajtura gjatë vitit.	Trajnimet e vazhdueshme janë planifikuar që të fillohen në Shtator-Tetor të vitit 2023, atëherë kur pritet që ekspertet nga Sh.B.A. të jenë në Kosovë, ndërsa trajnimet fillestare do të fillojnë nëse vec konsiderohet që ka nevojë që të hapet konkurs për certifikim të ndërmjetësuesve të rinjë. Mirepo nuk ka pasur asnjë zhvillim.
18	Hartimi i kurrikulave të trajnimit fillestar, të vazhdueshëm dhe të specializuar për administratorët e falimentimit, me qëllim të rritjes së nivelit të njohurive dhe shkathhtësive dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve të tyre.	2021	MD, OAFK	Kurrikulat e trajnimit fillestar, të vazhdueshëm dhe të specializuar të miratuara.	Ky aktivitet planifikohet të zbatohet pas miratimit të Ligjit të ri për Falimentimin. Projektligji për Falimentimin është miratuar në lexim të parë nga Kuvendi me datën 19.10.2023
19	Organizimi i trajnimeve fillestare, të vazhdueshme dhe të specializuara për administratorët e falimentimit, në bazë të kurrikulave të miratuara	2022 - 2023	MD, OAFK	2 trajnime të mbajtura gjatë vitit.	Ky aktivitet planifikohet të zbatohet pas miratimit të Ligjit të ri për Falimentimin. Projektligji për Falimentimin është miratuar në lexim të parë nga Kuvendi me datën 19.10.2023
20	Hartimi i kurrikulave të reja trajnuese fillestare, të vazhdueshme dhe të specializuar për noterët pajtim me standardet e pranuar dhe praktikën më të mira, me qëllim të rritjes së nivelit të cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.	2021	MD, ONK	Kurrikulat e reja të trajnimit fillestar, të vazhdueshëm dhe të specializuar, të miratuara	Oda e Noterëve ka hartuar dhe kompletuar kurrikulat e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për noter. ¹⁶⁷
21	Organizimi i trajnimeve fillestare, të vazhdueshme dhe të specializuara për noterët, në bazë të kurrikulave të reja të miratuara	2022 - 2023	MD, ONK	4 trajnime të mbajtura	ONK gjatë kësaj periudhe të raportimit ka mbajtur 2 trajnime për Noter: 03 Qershor 2023 Oda e Noterëve në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) mbajti trajnimin për noter në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) mbajti trajnimin për noter dhe bashkëpunëtor të zyrave noteriale, me temë "Shënimi nga ana e noterëve në SIKT-K", aplikacioni i zhvilluar nga ky agjencion për shënimin e LRP dhe REF tek rubrika e vërejtjes në certifikatën pronësore nga ana e noterëve. Qëllimi i këtij trajnimi ishte njoftimi nga afër me hapat që noterët duhet të ndjekin në Sistemin e shërbimeve digjitale të AKK-së, për regjistrimin e shënimin për njësitë kadastrale që do të jenë objekt i akteve noteriale. Mbajtur në Hotel Emerald, Prishtinë. *25-26 Shkurt 2023, Oda e Noterëve në bashkëpunim me GIZ dhe NJIF-K, ka mbajtur trajnim të avansuar mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, me ligjerues z. Dritan Vakaj. Grupi 1: Prizren, 25 Shkurt 2023, "Lakeside" Hotel. Grupi 2: Prishtinë, 26 Shkurt 2023, Hotel "Sirius".
22	Hartimi i kurrikulave të reja trajnuese fillestare, të vazhdueshme dhe të specializuara për përmbuesit privat në pajtim me standardet e pranuar dhe praktikën më të mira, me qëllim të rritjes së nivelit të cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.	2021	MD, OPP	Kurrikulat e reja të trajnimit fillestar, të vazhdueshëm dhe të specializuar, të miratuara	Nuk ka zhvillime.
23	Organizimi i trajnimeve fillestare, të vazhdueshme dhe të specializuara për	2022 -	MD, ONK	4 trajnime të mbajtura	OPP gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 3 trajnime :1.Trajnim për Udhëzimin Administrativ për tarifën e Përmbimit, me dt.27.01.2023.

¹⁶⁷ <https://www.noteria-ks.org/download/raporti-vjetor-2022/#>, Faqe 8

	përmbartuesit privat, në bazë të kurrikulave të reja të miratuara	2023			2.Trajnimi për Procedura përmbartimore-lejimi i përmbartimit, me dt.31.05.2023. Ndersa ne pjesen e dyte te vitit nuk ka pasur zhvillime.
24	Forcimi i kapaciteteve të odave përkatëse të profesioneve të lira në lidhje me ofrimin e trajnimeve (tranimet fillestare dhe trajnimeve të vazhdueshme të detyrueshme) me qëllim të rritjes së nivelit të cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.	2022	MD, ONK, OPP, OAFK, Oda e Ndërmjetësuesve	4 trajnime për trajner të realizuara, 1 për çdo profesion të lirë: noterë, përmbartues privat, administratorë falimentues dhe ndërmjetësues.	Ne lidhje me ngritjen e kapaciteteve te brendshme te ONK-sw, IHN(Unioni Nderkombetar i Notereve) ka trajnuar TOT (Trajnuesit per trajner).
25	Të parashihet në Ligjin për Falimentimin, obligimi i vijimit të trajnimeve vjetore të vazhdueshme për administratorët falimentues, me qëllim të rritjes së njohurive dhe shkathhtësive, cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe shtimit të besimit të publikut në shërbimet e ofruara nga profesionet e lira.	2022	MD, MTI	Ndryshimi i Ligjit për Falimentim që parasheh trajnimin e vazhdueshëm për administratorë falimentues, i miratuar.	Projektligji për Falimentimin është miratuar në lexim të parë nga Kuvendi me datën 19.10.2023 dhe kjo pjesë është inkuadruar. ¹⁶⁸
26	Miratimi i aktit të brendshëm të OAFK që rregullon trajnimin e vazhdueshëm për administratorët falimentues	2022	OAFK	Akti i OAFK për trajnimin e vazhdueshëm të administratorëve falimentues, i miratuar.	Ky aktivitet planifikohet të zbatohet pas miratimit të Ligjit të ri për Falimentimin. Projektligji për Falimentimin është miratuar në lexim të parë nga Kuvendi me datën 19.10.2023
27	Krijimi i programit të trajnimit gjatë shërbimit për punonjësit e noterëve, me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe bizneset.	2021	MD, ONK	Programit i trajnimit gjatë shërbimit për punonjësit e noterëve i miratuar	Oda e Noterëve ka hartuar dhe kompletuar kurrikulat e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për noter, ndërsa programi i trajnimit për punonjësit e noterëve planifikohet gjatë vitit 2023.
28	Organizimi i trajnimeve për punonjësit e noterëve, në bazë të programit të trajnimit të miratuar	2022 - 2023	MD, ONK	4 trajnime të mbajtura për punonjësit e noterëve	Nuk ka zhvillime.
29	Krijimi i programit të trajnimit gjatë shërbimit për punonjësit e përmbartuesve privat, me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe bizneset.	2021	MD, ONK, OPP	Programit i trajnimit gjatë shërbimit për punonjësit e përmbartuesve privat, i miratuar	Nuk ka zhvillime.
30	Organizimi i trajnimeve për punonjësit e përmbartuesve privat, në bazë të programit të trajnimit të miratuar	2022 - 2023	MD, ONK	4 trajnime të mbajtura për punonjësit e përmbartuesve privat	Nuk ka zhvillime.
31	Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Akademinë e Drejtësisë për krijimin e mekanizmave për ofrimin e trajnimeve të përbashkëta tematike për profesionet e lira me gjykatësit, prokurorët, stafin mbështetës nga gjykatat dhe zyrat prokuroriale, me qëllim të bashkërendimit dhe bashkëpunimit të përmirësuar ndër-institucional në mes të MD, AD dhe odave përkatëse.	2021	MD, KGjK, KPK, Odat e profesioneve të lira, ADK	Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar	Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë është angazhuar në arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me odat e profesioneve të lira për të cilat ende nuk ka pasur marrëveshje. Në muajin shtator, përkatësisht me 8 shtator i është drejtuar Odës së Ndërmjetësimit përmes përfaqësueses së saj dhe në platformën 'info@noteria-ks.org'. Në emailin drejtuar odave përkatëse ju është rikujtuar masa që parasheh Strategjia për sundimin e Ligjit në raport me institucionet tona, që përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të krijujmë mundësitë e trajnimeve të përbashkëta tematike bashkë me gjyqtarët dhe prokurorët dhe në këtë mënyrë ti kontribuojmë rritjes së kapaciteteve të profesionistëve ligjor dhe zbatimit të strategjisë. Kësaj kërkesë dhe nisme të AD-së i është përgjigjur Oda e Ndërmjetësimit për çka edhe jemi dakorduar dhe kemi arritur marrëveshje të bashkëpunimit e cila është nënshkruar në ditët e ndërmjetësimit, përkatësisht me 26 shtator 2023. Si rezultat i kësaj marrëveshjeje zyrtarët e ndërmjetësimit kanë mundësinë dhe kanë marrë pjesë në trajnimet e AD-së qoftë të përbashkëta me gjyqtarë e prokurorë ashtu edhe trajnime dedikuara veç zyrtarëve të ndërmjetësimit.

¹⁶⁸ <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=497>

					Përkundër tentativës dhe rikujtimit të AD-së me Oden e noterëve nuk kemi arritur meqë nuk kemi pasur përgjigje.
32	Krijimi i kurrikulës nga Akademia e Drejtësisë për trajnime të përbashkëta tematike në mes të gjykatësve, prokurorëve dhe profesioneve të lira.	2021	AD, KGJK, KPK	Kurrikula e AD-së për trajnime të përbashkëta e miratuar.	Programi trajnues i AD-së është i përbashkët dhe varësisht prej temave që përmbanë programi janë të përcaktuar edhe përfituesit. Prandaj në një pjesë të konsiderueshme të trajnimeve që ofron ky program janë edhe profesionistët e tjerë ligjor si, avokatët shtetëror, ndërmjetësuesit, zyrtarët e ndihmës juridike falas dhe jo vetëm. Në vijim të këtij dokumenti janë të prezantuara aktivitetet trajnuese ku kanë marrë pjesë subjektet përkatëse.
33	Organizimi i trajnimeve të përbashkëta tematike për profesionet e lira me gjykatësit, prokurorët, stafin mbështetës nga gjykatat dhe zyrat prokuroriale, me qëllim të bashkërendimit dhe bashkëpunimit të përmirësuar ndër-institucional në mes të MD, AD dhe odave përkatëse.	2022 - 2023	AD, MD, KGJK, KPK, odat e profesioneve të lira	4 trajnime të përbashkëta të realizuara me profesionet e lira, gjyqtarët dhe prokurorët.	Në periudhën raportuese, profesionistët nga radhët e profesioneve të lira iu është mundësuar të marrin pjesë në trajnimet që janë me interes sipas programit të trajnimit të vazhdueshëm. Si rezultat i kësaj kanë marrë pjesë edhe në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë por edhe në trajnime të veçanta dedikuara kategorive përkatëse. Në këto trajnime kanë marrë pjesë avokatë shtetëror, ndërmjetësues, zyrtarë të ndihmës juridike falas, mbrojtës të viktimave, zyrtarë nga QPS dhe profesionistë tjerë ligjor varësisht prej çështjeve ligjore që ishin objekt i trajtimit dhe ndërlidhjes së punës së tyre me çështjet përkatëse. ¹⁶⁹
34	Rishikimi i Kodit të Etikës të Noterëve, për të reflektuar ndryshimet e fundit të Ligjit të Noterisë	2022	MD, ONK	Kodi i ri i Etikës të Noterëve, i miratuar.	Kodi i Etikës është adaptuar nga Unioni nderkombetar i noterisë, dhe Odat anetare të Unionit Nderkombetar të Noterisë duhet ta kenë kodin e unifikuar.
35	Hartimi i Kodit të Etikës të Administratorëve Falimentues	2022	MD, OAFK	Kodi i Etikës i Administratorëve Falimentues, i miratuar.	Ky aktivitet planifikohet të zbatohet pas miratimit të Ligjit të ri për Falimentimin. Projektligji për Falimentimin është miratuar në lexim të parë nga Kuvendi më datën 19.10.2023
36	Rishikimi i statutit të OPP me qëllim të qartësisimit më të madh të rolit të organeve të OPP dhe hierarkisë së akteve të brendshme normative të OPP	2021	MD, OPP	Statuti i rishikuar i OPP i miratuar	Drafti i Statutit është përgatitur, por nuk është miratuar ende, është në DL, sipas diskutimit me DL do të përfshihen në vendimin i cili do të përfshijë disa akte të cilat duhet të ndryshohen.
37	Rishikimi i draftit të Kodit të Etikës së PP përmes koordinimit të ngushtë në mes të OPP dhe MD me qëllim të zhvillimit më të mirë të rregullave bazë të etikës dhe sjelljes së përmbauesve privat.	2021	MD, OPP	Kodi i ri i Etikës të Përmbaues Privat i miratuar.	Drafti i Kodit është përgatitur, por nuk është miratuar ende, është në DL, sipas diskutimit me DL do të përfshihen në vendimin i cili do të përfshijë disa akte të cilat duhet të ndryshohen.
38	Të ndërmerret analiza e kompetencave përkatëse të Divizionit për Mbikqyrje Administrative të Ligjshmërisë së Aktiviteteve të Profesioneve të Lira dhe Departamentit të Profesioneve të Lira (përfshirë dy divizionet ekzistuese) në kuadër të MD-së	2021	MD	Analiza e kompetencave përkatëse e realizuar.	Me mbështetje të Projektit të BE-së 'EUKOJUST' është zhvilluar një analizë për kompetencat në mes të Departamentit për Profesionet e Lira dhe Divizionit për Mbikqyrje dhe janë dhënë rekomandimet, që do të shqyrtohen gjatë finalizimit të Rregullores së re për organizimin e Ministrisë së Drejtësisë.
39	Ndërmarrja e masave për harmonizimin e kompetencave përkatëse të Divizionit për Mbikqyrje Administrative të Ligjshmërisë së Aktiviteteve të PL dhe Departamentit të PL	2022	MD	Masat për harmonizimin e operacioneve të miratuara.	Ky aktivitet është në proces dhe është trajtuar përmes Projekt Rregullore së Brendshme të MD e cila është në fazën e miratimit nga MPB.

¹⁶⁹ https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/bul_korrik_gusht_.pdf (fq-13, 15)
https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/buletinor2023shq_.pdf (fq-9, 22)
https://ad.rks-gov.net/media/Buletini%20Informativ/2023/Bulnentorshq_.pdf (fq-9, 13,15, 24

40	Krijimi i udhëzimeve të detajuara për performancën, monitorimin dhe kontrollimin e noterëve, ndërmjetësuesve dhe administratorëve falimentues, me qëllim të monitorimit dhe kontrollit më të mirë ndaj profesioneve të lira.	2021	MD, ONK, Oda e Ndërmjetësuesve, OAFK	Udhëzimet për performancën, monitorimin dhe kontrollimin e profesioneve të lira të miratuara.	Përveç udhëzimit për mbikëqyrje të përmbuarve privat që është miratuar para hyrjes në fuqi të kësaj Strategjie, sa i përket profesioneve tjera të lira nuk janë nxjerrur udhëzime specifike të mbikëqyrjes.
41	Koordinimi i ngushtë në mes të MD-së dhe Ministrisë së Financave (MF) për të identifikuar nxitjet financiare për personelin e Divizionit për Mbikëqyrje Administrative të Ligjshmërisë së Aktiviteteve të PLL-ve	2022	MD, MF	Nxitjet financiare të siguruara	Nuk ka zhvillime.
42	Krijimi dhe funksionalizimi i Komisionit Profesional për vlerësimin e përbarimit me qëllim të ofrimit të një mundësie të rishikimit të pavarur mbi sistemin e përbarimit, i cili lejon një llogaridhënie të shtuar, dhe kontribuon në identifikimin e mënyrave për përmirësimin e mëtejshëm të tij.	2021	MD	Komisioni Profesional i themeluar dhe funksional.	Kjo çështje është duke u analizuar në kuadër të Koncept Dokumentit për Kodin e Procedurës Civile.
43	Krijimi i programit të trajnimit për MD-në dhe Odën përkatëse në zbatimin e udhëzimeve të monitorimit dhe kontrollimit ndaj profesioneve të lira.	2022	MD, ONK, OPP, OAFK, Oda e Ndërmjetësuesve	Programi i trajnimit i miratuar.	Oda e Noterëve e ka aprovuar programin për trajnime fillestare dhe të vazhdueshme.
44	Organizimi i trajnimeve për MD-në dhe Odën përkatëse në zbatimin e udhëzimeve të monitorimit dhe kontrollimit të profesioneve të lira.	2023	MD, ONK, OPP, OAFK, Oda e Ndërmjetësuesve	2 trajnime të mbajtura.	ONK gjatë kësaj periudhe të raportimit ka mbajtur 2 trajnime për Noter: 03 Qershor 2023 Oda e Noterëve në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) mbajti trajnimin për noter në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) mbajti trajnimin për noter dhe bashkëpunëtor të zyrave noteriale, me temë "Shënimi nga ana e noterëve në SIKT-K", aplikacion i zhvilluar nga ky agjencion për shënimin e LRP dhe REF tek rubrika e vërejtjes në certifikatën pronësore nga ana e noterëve. Qëllimi i këtij trajnimi ishte njoftimi nga afër me hapat që noterët duhet të ndjekin në Sistemin e shërbimeve digjitale të AKK-së, për regjistrimin e shënimit për njësitë kadastrale që do të jenë objekt i akteve noteriale. Mbajtur në Hotel Emerald, Prishtinë. •25-26 Shkurt 2023, Oda e Noterëve në bashkëpunim me GIZ dhe NJIF-K, ka mbajtur trajnim të avansuar mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, me ligjerues z. Dritan Vakaj. Grupi 1: Prizren, 25 Shkurt 2023, "Lakeside" Hotel. Grupi 2: Prishtina, 26 Shkurt 2023, Hotel "Sirius". OPP gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 3 trajnime :1.Trajnim për Udhëzim Administrativ për tarifën e Përbarimit, me dt.27.01.2023. 2.Trajnimi për Procedura përbarimore-lejimi i përbarimit, me dt.31.05.2023 3.Trajnimi për GJYKATA KOMERCIALE – KOMPETENCAT, PROCEDURA, PRAKTIKA, me dt.02.06.2023,
45	Krijimi i standardeve, përfshirë afatet kohore standarde, gjatë të cilës duhet të merren masat nga përmbuarësit drejt përfundimit të lëndës së përbarimit.	2021	MD, OPP	Standardet e krijuara të miratuara	Trajnimi për Procedura përbarimore-lejimi i përbarimit, me dt.31.05.2023, nuk ka pasur zhvillime të tjera.
46	Miratimi i akteve nën-ligjore për kontrollimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të falimentimit pas ndryshim/plotësimit të Ligjit për Falimentimin dhe themelimit të Odës së Administratorëve të Falimentimit	2022	MD, OAFK	Aktet nënligjore të miratuara.	Ky aktivitet planifikohet të zbatohet pas miratimit të Ligjit të ri për Falimentimin. Projektligji për Falimentimin është miratuar në lexim të parë nga Kuvendi me datën 19.10.2023
<i>Masa e politikës: Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-profesional</i>					<i>50% zbatuar plotësisht</i>
47	Krijimi dhe zbatimi i një mekanizmi të realizueshëm për bashkërendim të ngushtë në mes të MD dhe odave përkatëse të PLL-ve.	2021	MD, ONK, OPP, OAFK, Oda e Ndërmjetësuesve	Mekanizëm funksional dhe fleksibil i komunikimit.	Mekanizmi koordinues për profesionet e lira është krijuar dhe takimi i parë është mbajtur me 29 qershor 2022. Për më shumë, me mbështetje të Programit të USAID 'Drejtësia Komerciale' është mbajtur një Punëtori tre ditore në shkurt 2022, me eksperte nga SHBA mbi fuqizimin e partneritetit në mes të Ministrisë

					së Drejtësisë dhe Odës së Përmbauesve Privat, me qëllim të krijimit të planeve afatgjate si dhe listës së qëllimeve të përbashkëta mes Ministrisë dhe OPP si dhe adresimin e problemeve.
48	Krijimi i një mekanizmi të realizueshëm, funksional dhe fleksibil të komunikimit në mes të profesioneve të lira në një anë, dhe KGJK dhe KPK në anën tjetër, me qëllim të bashkërendimit dhe bashkëpunimit më të mirë ndërinstitucional dhe ndër-profesional në mes të profesioneve të lira dhe akterëve tjerë të drejtësisë.	2021	MD, ONK, OPP, OAFK, Oda e Ndërmjetësuesve, KGJK, KPK	Mekanizëm funksional dhe fleksibil i komunikimit, i krijuar.	Gjate kesaj periudhe nuk ka ndonje takim te mbajtur por kemi komunikime te vazhdueshme
49	Përgatitja e kurrikulës së Akademisë së Drejtësisë për trajnime për gjykatësit dhe prokurorët mbi rolin e secilit profesion ligjor, me qëllim të të kuptuarit më të mirë nga ana e secilit aktor në fushën e drejtësisë për nevojat specifike të secilit profesion të lirë.	2022	AD, KGJK, KPK	Kurrikula e trajnimit e miratuar	Ashtu siq është raportuar programi trajnues përmban të gjitha kompetencat sipas ligjit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor nga secili departament dhe divizion i gjykatës/prokurorisë për të cilat është vlerësuar se ka nevojë për përmirësim të praktikës gjyqësore. Prandaj edhe secili nga këto funksione ka pasur mundësinë e aplikimit dhe pjesëmarrjes për të rritë kapacitetet profesionale në çështjet që janë me interes në punën e tyre. ¹⁷⁰
50	Organizimi i trajnimeve për gjyqtarët dhe prokurorët mbi rolin e secilit profesion ligjor, me qëllim të të kuptuarit më të mirë nga ana e secilit aktor në fushën e drejtësisë për nevojat specifike të secilit profesion të lirë.	2023	AD, KGJK, KPK,	2 trajnime të mbajtura për gjyqtarët dhe prokurorët.	Nuk ka zhvillime.
51	Përfshirja e përfaqësuesve të profesioneve të lira në grupet punuese kur ligjet dhe politikat të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë ndikojnë në punën e tyre, hartohen apo diskutohen në nivelin e politikbërjes.	2021 - 2023	MD, KGJK, KPK	Profesionet e lira marrin pjesë në të gjitha aktet relevante të politikave dhe ligjore që hartohen.	Në çdo grup punues relevant marrin pjesë përfaqësuesit nga profesionet e lira. Në grupin punues për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit për falimentimin janë të përfshirë përfaqësuesit e OAFK, gjithashtu në grupin punues për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Noterinë janë përfshirë përfaqësuesit e ONK.
52	Miratimi i ndryshimeve/plotësimeve ligjore, ose nënshkrimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit për të siguruar qasjen e PP-ve dhe noterëve në regjistrat publik me qëllim të përmirësimit të cilësisë të shërbimeve të ofruara nga PP dhe noterët për qytetarët dhe bizneset.	2022	MD, OPP, ONK, MIA/Agjencia Kadastrale, MTI/Regjistri i Pengut	PP-të dhe noterët kanë qasje në regjistrat publik	Noterët aktualisht kanë qasje në regjistrin e pengut, hipotekës dhe kadastrit. Me sistemin e ri elektronik të përbarimit, përbaruesit privat do të kenë qasje në të gjitha regjistrat publik. Problematike mbetet se kjo qasje për përbaruesit në Regjistrin e Llogarive Bankare, si dhe për përbaruesit dhe noterët në Regjistrin Kadastral, ofrohet vetëm me pagesë.

¹⁷⁰ https://rksgov-my.sharepoint.com/:b:/g/personal/xhevdet_pllana_rks-gov_net/EeW1dqDX7qMILFACJWjGu4Bebb0I9waMCd-00pUP7WB9w?e=MmcPxJ

Kapitulli 3.4 - Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile

	Veprimi	Afati i fundit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Progresi në zbatim
<i>Masa e politikës: Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për të përmirësuar qasjen në informata</i>					44% zbatuar plotësisht
1	Miratimi i Rregullores për klasifikimin e dokumenteve në kuadër të sistemit gjyqësor.	2022	KGJK	Rregullorja për klasifikimin e dokumenteve gjyqësore e miratuar.	Fillimisht KGJK ka hartuar dy draft rregullore, draft Rregullore për klasifikimi e dokumenteve në kuadër të Sistemit gjyqësor dhe Draft Rregullore për Qasje në Dokumente Publike. Gjatë procedurës së finalizimit, më kuadër të KGJK është bërë një analizë e insitucioneve vendore sa i përket klasifikimit të dokumenteve vendore. Pas analizës së bërë KGJK nuk e ka parë të nevojshme miratimin e një rregullore për klasifikim të dokumenteve dhe e ka bërë shkrijën e dy drafteve në një draft. Me datë 23 mars 2023 ka miratuar Rregullore Nr.02/2023 për qasje në Dokumente Publike e cila përcakton procedurën dhe mënyrën e lejimit të qasjes në dokumente publike të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe gjykatave të Republikës së Kosovës.
2	Miratimi i Strategjisë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	2022	MD	Strategjia për Komunikim me Publikun miratuar.	MD ka planifikuar grupin punues dhe pritet hartimi dhe miratimi i kësaj Strategjie gjatë vitit 2023.
3	Miratimi i Strategjisë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	2022	MPB	Strategjia për Komunikim me Publikun miratuar.	Strategjia sektoriale për Komunikim me Publikun është hartuar dhe në pritje të miratimit.
4	Miratimi i Strategjisë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	2022	Policia e Kosovës	Strategjia për Komunikim me Publikun miratuar.	Strategjia sektoriale për Komunikim me Publikun është hartuar dhe në pritje të miratimit.
5	Hartimi i Strategjisë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	2022	KGJK	Strategjia për Komunikim me Publikun e miratuar	Strategjia për Komunikim me Publikun 2022-2024 është miratuar nga KGJK. ¹⁷¹
6	Hartimi i Strategjisë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	2021	KPK	Strategjia për Komunikim me Publikun e miratuar	KPK ka miratuar Strategjinë për Komunikim me Publikun të Sistemit Prokurorial. ¹⁷²
7	Krijimi i ueb faqeve më miqësore për përdoruesit, të cilat ofrojnë informata përmbajtësore për publikun, duke përfshirë ato ligjore.	2022	MD	Ueb faqja e MD-së e qasshme dhe e azhmuar me informata përmbajtësore për publikun.	Duke u zbatuar. MD e ka përfunduar raportin ndërsa GIZ është në proces të prokurimit për përgjdhjen e Kompanisë për dizajnimin dhe krijimin e Ueb faqes së re të MD.
8	Krijimi i ueb faqeve më miqësore për përdoruesit, të cilat ofrojnë informata përmbajtësore për publikun, duke përfshirë ato ligjore.	2022	MPB	Ueb faqja e MPB-së e qasshme dhe e azhmuar me informata përmbajtësore për publikun.	MPB vazhdimisht është duke e përditësuar Webfaqen, me qëllim të lehtësimit të përdorimit të saj.
9	Krijimi i ueb faqeve më miqësore për përdoruesit, të cilat ofrojnë informata përmbajtësore për publikun, duke përfshirë ato ligjore.	2022	Policia e Kosovës	Ueb faqja e Policisë e qasshme dhe e azhmuar me informata përmbajtësore për publikun.	Webfaqja e policisë së Kosovës është ridizajnuar me përkrahje të OSBE-së dhe ky proces ka përfunduar në vitin 2021 me qëllim të qasjes më të lehtë të informacioneve për palët e ndryshme të interesit. Për DIMP që administrojnë uebfaqen ky aktivitet është i përfunduar. Policia e Kosovës me qëllim të ofrimit të informacioneve dhe lehtësimit të qasjes për të gjitha palët e interesit përpos uebfaqes ka edhe platforma tjera të komunikimit me publikun si: faqen zyrtare në FB, Twitter, Kanalin Youtube. Policia e Kosovës njoftimin i brendshëm për të gjithë zyrtarët policorë lidhur me ngjarjet, nisitë ligjore dhe publikimi i shkresave

¹⁷¹ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/03/KGJK_Strategjia_Komunikimit_2022-2024.pdf

¹⁷² [https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Dokumente%20Strategjike/Strategjia%20p%C3%ABr%20komunikim%20e%20sistemit%20prokurorial%202021-2023\(1\).pdf](https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Dokumente%20Strategjike/Strategjia%20p%C3%ABr%20komunikim%20e%20sistemit%20prokurorial%202021-2023(1).pdf)

				<p>të ndryshme realizohet përmes Intranetit ndërsa komunikimin me publikun e jashtëm e bën përmes Webfaqes.. Webfaqja e PK-së e ridizajnuar poashtu ofron edhe qasje në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacione për numrat e Policisë së Kosovës duke përfshirë edhe numrin për thirrjet anonime dhe konfidenciale. • Funksionin e drejtpërdrejt nga Webfaqe ku qytetarët mund të dërgojnë informatat e kërkesat e tyre në adresën elektronike info@kosovopolice.com(adresë që menaxhohet nga QOKK). • Qasje për aplikacionin dhe Instalimin e aplikacionit dixhital për telefona mobil "Lajmëro Policinë". • Vegëzën për në Platformën E-Kosova për kontrollim të Gjobjave <p>AKTIVITETET E DERITASHME QË JANË REALIZUAR GJATË VITIT 2023 E QË JANË PUBLIKUAR NË PLATFROMAT E INFORMIMIT TË PK-SE PËRFSHIRË EDHE WEBFAQEN:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. KOMUNIKATA- Gjatë vitit 2023, Policia e Kosovës ka lëshuar 2130 komunikata me shkrim për media, në të gjitha platformat e informimit të PK-së. Komunikata të lëshuara nga Zyrat per Media dhe Marrëdhënie me Publikun ne nivel qendror dhe lokal të cilat janë publikuar në Intranet, web faqe dhe në rrjetin sociale të PK-së publikohen në 3 gjuhët dhe këtë vit kemi rritje për 11% më shumë publikime në vitin 2023 2. RAPORTI 24 ORËSH -Gjatë gjithë vitit 2023, 365 herë, (d.m.th. për çdo ditë) është publikuar raporti 24 orësh, statistika të përgjithshme të të cilit publikohen në webfaqen e PK-së dhe Facebook në baza ditore. 3. QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE- Si detyrë e Drejtorisë për Informim është edhe menaxhimi dhe trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike dhe brenda këtij viti ne i kemi pranuar 154 kërkesa për qasje në dokumente publike. 4. KONFERENCA PER MEDIA - DIMP-i përgjatë këtij viti ka organizuar 14 konferenca për media të cilat zakonisht mbahen me rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme për të qenë më transparentë para opinionit të gjerë. 5. FOTOLAJME- Në kuadër të informacioneve që paraqiten në formë komunikatash, poashtu e publikojmë edhe informacione të shpejta e më të shkurtra në formë fotolajmesh e gjatë vitit 2023 kemi publikuar 30 të tilla. 6. KONKURSE TË NDRYSHME – 31 postime për konkurse të jashtme në web faqe te PK-së (postime për të gjitha fazat e konkurseve për rekrutim të punonjësve në polici. 7. Janë publikuar 2233 aktivitete të ndryshe policore në rrjetet sociale të PK-së në Facebook dhe Twitter, duke përfshirë komunikata për media nga DIMP dhe rajonet, publikime për kundërvajtje, videospote si dhe aktivitete të tjera policore që ndërliiden me vizita të drejtorit të PK-së etj. 8. Publikime të ndryshme në web faqe dhe në Intranet: janë 203, ku përfshihen(ligje, dokumente strategjike, raporte, fushata vetëdijësuese, rregullore, udhëzime administrative, forma të ndryshme, PSO. 9.. REVISTA MBROJTËSI- Angazhime shtesë në fushën e marrëdhënieve me publikun si dhe nxjerrja e revistës policore "Mbrojtësi", nga stafi i DIMP. 10. DIZAJNIME TË PRODUKTEVE TË NDRYSHME- janë dizajnuar 70 dokumente si: plane, fushata vetëdijësuese, postere të gjitha të dizajnuara në shqip, serbisht dhe anglisht.. Me qëllim të ngritjes së transparencën, avancimin e bashkëpunimit si dhe parandalimin e dukurive negative të fushave të ndryshme poashtu janë kryer edhe aktivitet si në vijim: 11. PJESEMARRJA TELEVIZIVE – Për të ngritur transparencën dhe avancuar bashkëpunim me mediueme të ndryshme janë realizuar paraqitje në emisione dhe kronika televizive rreth sigurisë së përgjithshme apo tema të veçanta, aktiviteteve dhe operacioneve policore. 12. TAKIME- Mbajtja e raporteve të mira bashkëpunuese me gazetarë reporterë, organizata joqeveritare, produksione filmike etj.
--	--	--	--	---

					<p>13. FUSHATAT VETËDIJËSUESE- Realizimi i disa fushatave sensibilizuese e video-spoteve televizive kryesisht është bërë me ndihmën e KFOR-it dhe me ndihmën e OSBE-së</p> <p>Info Shtesë</p> <p>:</p> <p>Platformat miqësore për qasje më të lehtë; në informacione e të cilat administrohen dhe që funksionon në kuadër të DIMP-it. Në vijim gjeni Linqet zyrtare të PK-së,</p> <p>Web faqja zyrtare:</p> <p>http://www.kosovopolic.com</p> <p>Faqja zyrtare e PK-së ne rrjetin social Facebook:</p> <p>http://www.facebook.com/KosovoPolice</p> <p>Faqja zyrtare e PK-së ne rrjetin social Twitter (X) :</p> <p>https://x.com/kosovo_police?s=11&t=sO-rZxMD95UdleVFYExr4A</p> <p>Faqja zyrtare PK-së në kanal in Youtube :</p> <p>http://www.youtube.com/@kosovopolic6138</p>
Masa e politikës: Avancimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile					100% zbatuar plotësisht
10	Nënshkrimi i Memorandimit të Bashkëpunimit i cili parasheh shfrytëzimin e përvojës dhe kapaciteteve të organizatava joqeveritare në promovimin e praktikave të mira për gjyqtarët, prokurorët, dhe stafin mbështetës në çështjet që lidhen me korrupsionin, krimin e organizuar, qasjen në drejtësi, instrumentet, masat e zbatimit, përmirësimin e standardeve dhe forcimin e mbikëqyrjes së masave kundër korrupsionit, dhe të tjera.	2022	ADK, OJQ	Memorandumi i Bashkëpunimit i nënshkruar.	Memorandumi i Bashkëpunimit është nënshkruar me datë 31 maj 2022 për krijimin e grupit 'Miq të Akademisë'. ¹⁷³

¹⁷³ <https://ad.rks-gov.net/sq/aktivitetet-dhe-lajmet-2022/Details/10550>

Kapitulli 3.5 - Fuqizimi i rolit të Ministrisë së Drejtësisë

	Veprimi	Afati i fundit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Progresi në zbatim
<i>Masa e politikës: Rritja e kapacitetit të gjyqësorit të Kosovës për integrim në BE</i>					25% zbatuar plotësisht
1	Vendosja e atasheut të drejtësisë në përfaqësimin e Kosovës në Bruksel.	2023	MD MPJD	Atasheu i drejtësisë i vendosur në Bruksel.	Nuk është zbatuar. Kjo çështje nuk është vendosur në Projekt Rregulloren e Brendshme të MD
2	Fuqizimi i rolit të MD në nën-komitetin e DLS-së përmes trajnimit të stafit të Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave lidhur me aftësitë raportuese, <i>acquis</i> të BE-së në fushën e DLS, komunikimin diplomatik, dhe aftësitë analitike.	2022 - 2023	MD	1 trajnim i realizuar.	Nuk është zbatuar. Kjo çështje nuk është vendosur në Projekt Rregulloren e Brendshme të MD
3	Fuqizimi i rolit të MPB në nën-komitetin e DLS-së përmes trajnimit të stafit të Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave lidhur me aftësitë raportuese, <i>acquis</i> të BE-së në fushën e DLS, komunikimin diplomatik, dhe aftësitë analitike.	2022 - 2023	MPB	1 trajnim i realizuar.	Gjatë vitit 2023 dy zyrtare te MPB-se kane ndjekur dy tajnime lidhur me integrimin evropian dhe <i>acquis</i> te BE-se
4	Organizimi i punëtorive tematike lidhur me aspekte të ndryshme të ndërveprimit me BE-në, përfshirë këtu leximin e duhur të raporteve të BE-së, komunikimin, lobimin, dhe raportimin në BE.	2021	MD	1 punëtori i realizuar.	Nuk ka pasur ndonje zhvillim ne kete drejtim.
<i>Masa e politikës: Forcimi i kapacitetit të MD-së për të udhëhequr reformën gjyqësore</i>					57% zbatuar plotësisht
5	Ndryshimi i Rregullores Nr.31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë ashtu që të parashihet themelimi i Departamentit për Politikë legjislativë (të legjislacionit primar) të gjyqësorit	2022	MD, Qeveria e Kosovës	Rregullorja për organizimin e brendshëm të MD-së e ndryshuar dhe departamenti i themeluar.	Rregullorja Nr.010/2023 për Organizimin e Brendshem dhe Sistematizimin e vendeve të punës në MD është miratuar me datën 07.12.2023 ¹⁷⁴
6	Takime të rregullta të mekanizmit të koordinimit me të gjithë akterët e drejtësisë për qëllim të bashkërendimit rreth zbatimit të Strategjisë dhe çështje të tjera të ndëlidhura me kompetencat e tyre	2022	MD, Qeveria e Kosovës, KGJK, KPK, AD	Mekanizmi i koordinimit me të gjithë akterët e drejtësisë është funksional; 2 takime të mekanizmit mbahen brenda vitit.	Ne kuader te pergatitjes se raportit 1 vjeçar janë mbajtur takime me të gjitha institucionet raportuese, si dhe do te mbahet takimi i Komiteti Drejtues.
7	Themelimi i mekanizmit për koordinimin e donatorëve në sektorin e drejtësisë.	2022	MD, Qeveria e Kosovës, KGJK, KPK, AD	Mekanizmi i koordinimit me të gjithë akterët e drejtësisë i themeluar.	Mekanizm koordinues për koordinimin e donatorëve në sektorin e drejtësisë në mes të MD-së dhe donatorëve është themeluar dhe gjatë vitit 2022 ka mbajtur takime me datë 27.6.2022 dhe 2.11.2022.

¹⁷⁴ linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8971>

Masa e politikës: "Forcimi i kapaciteteve administrative të MD-së, në veçanti departamentit të BE-së, si dhe atyre departamenteve që janë përgjegjëse për zbatimin e reformave të drejtësisë"						25% zbatuar plotësisht
8	Rekrutimi i zyrtarëve të rinj me njohuri të avancuara të gjuhës angleze në Departamentin për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.	2022	MD	Katër zyrtarë të rinj të rekrutuar në Departamentin për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.	Nuk ka zhvillime	
9	Rekrutimi i zyrtarëve të rinj me njohuri të avancuara të gjuhës angleze në Departamentin Ligjor.	2022	MD	Gjashtë zyrtarë të rinj të rekrutuar në Departamentin Ligjor.	Nuk ka zhvillime konkrete. Kjo çështje është duke u analizuar në Projekt Rregulloren për organizimin e brendshëm të Ministrisë. Në vitin 2023 është transferuar nga ZKM një Zyrtar me njohuri të avancuara të gjuhës Angleze por i njejti në muajin shkurt të vitit 2024 ka dhënë dorëheqje	
10	Trajnimi i zyrtarëve të rinj të Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të politikave lidhur me kriteret e BE-së për aderim.	2022	MD	X trajnime të realizuara.	Nuk ka pasur ndonjë zhvillim në këtë drejtim.	
11	Ofrimi i kurseve të gjuhëve të huaja për zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë.	2022	MD, MPB, ZKM	Kurset e ofruara në gjuhën angleze, frenge dhe gjermane.	Me mbështetjen e projektit EUKOJUST, stafi i departamentit ligjor, stafi i departamentit për profesione të lira, stafi i departamentit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, kanë vijuar kursin e gjuhës angleze gjatë vitit 2023.	
Masa e politikës: Forcimi i kapacitetit të planifikimit strategjik në sektorin e drejtësisë						33% zbatuar plotësisht
12	Ndryshimi i Rregullores Nr.31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë ashtu që të parashihet themelimi i Divizionit për Planifikim Strategjik.	2022	MD	Rregullorja për organizimin e brendshëm të MD-së e ndryshuar dhe divizioni për planifikim strategjik i themeluar.	Rregullorja Nr.010/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në MD është miratuar me datën 07.12.2023 ¹⁷⁵	
13	Rekrutimi i katër zyrtarëve në Divizionin për Planifikim Strategjik.	2022	MD	4 zyrtarë të rekrutuar në Divizionin për Planifikim Strategjik.	Nuk ka pasur ndonjë zhvillim në këtë drejtim.	
14	Trajnimi i zyrtarëve të Divizionit për Planifikim Strategjik lidhur me planifikimin strategjik.	2022	MD	X trajnime të realizuara.	Nuk ka zhvillime.	
Masa e politikës: Përdorimi i teknologjive moderne në sektorin e drejtësisë						60% zbatuar plotësisht
15	Aftësimi i Divizionit të TI-së, me qëllim të përfshirjes së tyre për çështje të caktuara në implementimin e sistemeve të TI në gjyqësor, duke respektuar pavarësinë e gjyqësorit dhe prokurorisë.	2022	MD	2 trajnime të realizuara.	Nuk ka zhvillime	
